

GRATIS

# Prishtina *art*

JANAR 2024



600  
mijë vargjet e  
atdheut shpirtëror

GUIDË

Prishtina  
një qytet frymëzimi!



*Artistic*  
i trazuar  
Armend Rexhepagiqi

Identiteti kulturor  
dhe rritja e një  
**kryeqyteti!**  
Përparim Rama



# Optika Moda





**Përcaktimi i dioptrisë**

**Përzgjedhja e syzeve**

**Përpunimi i syzeve**

049 320 583  
[www.optikamoda.com](http://www.optikamoda.com)

Optika Moda   
optikamoda 

# Gjithçka për sytë e ballit



Optika Moda është lider në industrinë e optikës në Kosovë dhe një nga më të njohurat në rajon. Kjo optikë komunikon një histori të tërë që nga dita e parë e daljes në treg në vitin 2010. Ajo që nisi si një ëndërr u bë një histori në botën e optikës.

Sot Optika Moda me një rrjet të gjerë prej 18 pikash në mbarë Kosovën ndjek trendet më të fundit teknologjike dhe ofron shërbime moderne.

Optika Moda ofron kontrolle dhe përcaktim të dioptrisë me metoda dixhitale nga okulistë dhe ekspertë të optometrisë. Syzet e kësaj optike frymëzohen nga natyra dhe energjia e bukur që ajo na përcjell, ato komunikojnë ndjenja të bukura që prekin shpirtin, dhe presin që ju të krijoni historitë tuaja.

Optika Moda në kuadër të politikave të saj promovuese ka ofruar shërbime falas dhe 50% zbritje në produkte, si dhe lehtësira të tjera të veçanta në shoqërinë tonë, si për: Forcat e Sigurisë së KOSOVËS (FSK), Policinë e Kosovës, Zjarrfikësit dhe për studentët e pensionistët e vendit tonë.

**18 pika** në  
mbarë Kosovën





Nr. 1 Janar 2024

**Themeluese dhe drejtoreshë kreative**  
Arta BALAJ

**Kryeredaktore**  
Brunilda MERKO

**Redaktorë**  
Shadan RAMADANI  
Elisa NIKOLLA

**Gazetarë**  
Shpend MALIQI  
Bleona HAJDARI  
Erisa SARAQI  
Daniela CANA

**Përkthyesë**  
Elisa NIKOLLA

**Bashkëpunorë/editorialist**  
Baki Hoti  
Blerta Zeqiri  
Yll Rugova  
Zeni Ballazhi  
Fitnete Tuda  
Greta Guci

Alban Ramadani

**Fotografë**  
Shenoll Zehri  
Norik Uka  
Shpend Maliqi  
Iliria Neziri

**Kopertina**  
Taulant Qerkini (Tak Qrk)

**Layout & Dizajn**  
Enis VIDISHIQI

**Marketing**  
prishtinaculture@gmail.com

**Shtypshkronja**  
Blendi

**Drejtorja për Kulturë,  
Kryeqyteti**  
Në bashkëpunim me Unionin  
e Turizmit për Kosovë

## SHQIP

### Reportazh

Prishtina, një qytet frymëzimi!

### Labirinth

Armend Rexhepagiqi  
Artisti i trazuar



Eposi i Kreshnikëve, 600 mijë  
vargjet e atdheut shpirtëror

Flatrat e artistit Petrit Halilaj

Rilindja, abetare kulturore e  
shqiptarëve

“403” vlerë e rokut shqiptar

Baleti i Kosovës mes sukseseve  
dhe sfidave!

Bukuroshja e Prishtinës!

Rikthimi i Jehona Sopit  
Jeta është një poezi e shkruar!

Lundrim nëpër valët e zhvillimit  
kulturor të Prishtinës

## ENGLISH

**12** Prishtina, a city of inspiration!

**22** Armand Rexhepagic  
The troubled artist



**32** The Epic of the Kreshniks, 600  
thousand verses of the spiritual  
homeland

**34** The Wings of the Artist Petrit  
Halilaj

**40** Rilindja, a cultural primer of  
Albanians

**44** “403” remains a rock value!

**48** Kosovo Ballet between successes  
and challenges

**56** “The Beauty of Prishtina!”

**62** The return of Jehona Sopi

**65** Surfing the waves of Pristina's  
cultural development

**Këtu do të marrin jetë histori e rrëfime, imazhe dhe ide, ku arti, letërsia, muzika dhe të gjitha shprehjet e krijimtarisë do të ndërthuren për të krijuar një tërësi harmonike të kreativitetit kulturor të qytetarëve.**

**Here stories and narratives, images and ideas will come to life, where art, literature, music and all expressions of creativity will be combined to create a harmonious whole of cultural creativity of citizens.**



Gruaja në artin e Shqipe Kamberit

**81** The woman in the art of Shqipe Kamber

Portreti i një aktoreje

**90** The Portrait of an Actress

Dodona, teatri i kryeqytetit!

**106** Dodona, the theater of the capital!

Magjia e kapelave  
Aromë franceze në Prishtinë

**144** The magic of hats  
French flavor in Pristina

10 vende që duhet të vizitoni  
në Prishtinë

**158** 10 places you should visit in  
Pristina





*Trashëgimia kulturore përfaqëson një burim strategjik për industrinë krijuese dhe turistike. Përbën bagazhin kulturor që secili prej nesh mban me vete, si përkatësi dhe vlerë estetike, traditat, muzika, veprat materiale dhe jomateriale. Një bagazh që trashëgojmë nga e kaluara dhe që përpiqemi ta ruajmë për të ardhmen, për vlerën e të cilit ndonjëherë ndërgjegjësohemi vetëm kur rrezikojmë ta humbasim.*

*Cultural heritage represents a strategic resource for the creative and tourism industry. It comprises the cultural baggage that each of us carries with us, such as belonging and aesthetic value, traditions, music, material and immaterial works. A baggage that we inherit from the past and that we try to preserve for the future, the value of which we sometimes become aware of only when we risk losing it.*







Nga Arta BALAJ  
DREJTORESHË KREATIVE

# Një revistë frymëzuese për shpirtin krijues!

## An inspiring magazine for the creativespirit!

**F**illimi i një reviste kulturore, shtyp dhe digjital, më dha po të njëjtin emocion, përgjegjësi dhe sfidë si nëperiudhën kur e pranova pozitën e drejtoreshës për Kulturë në Kryeqytet. Për mua personalisht çdo projekt që ka kulturën si fillim dhe mbarim është projekt zemre dhe përpiqem të jap maksimumin. PrishtinArt do të jetë porta kryesore e kulturës, artit dhe trashëgimisë kulturore e Kryeqytetit tonë, revista e parë institucionale për kulturë, por që të marrë jetë duhet të bëhet pjesë e secilit prej jush.

Qëllimi i kësaj reviste është të ofrojë një platformë ku artistët mund të ndajnë punën dhe pasionin e tyre të palodhur drejt pasurimit të jetës kulturore dhe diversitetit në kryeqytet. Njëkohësisht do të shërbejë si një kalendar kulturor, për të gjithë ardashësit, vendor dhe të huaj, për atë e kemi konceptuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Gjithashtu PrishtinArt, përballë sfidave teknologjike, do të jetë një arkiv kombëtar, ku do të ruajmë gjatë dhe për breza të tjerë, profile personalitetesh, që i kanë dhënë dhe vazhdojnë t'i japin shpirtin kulturës shqiptare. Nga ana tjetër, shpresoj që ky botim, jo vetëm të angazhojë dhe promovoj artistë dhe personalitete të njohura, por edhe talentete reja dhe krijues të ardhshëm.

PrishtinArt nuk është konceptuar thjeshtë si një revistë, por edhe si njëguidë e vërtetë, e cila shpalos kryeqytetin në të gjithë dimensionet e tij, qoftë turistik dhe gastronomik, falë edhe bashkëpunimit të mirë me Unionin e Turizmit të Kosovës. Pra, mendojeni PrishtinArt si një udhërrëfyes për vendet dhe objektet ikonike të trashëgimisë sonë kulturore,

të cilat pasqyrojnë pasurinë dhe karakterin unik të Prishtinës.

Ndaj le të jenë këto faqe një strehë për ata që kërkojnë frymëzim dhe një testament për mundësitë e pafundme të krijuara kur shprehjet e ndryshme artistike bashkohen.

Faleminderit që nisët këtë rrugëtim me PrishtinArt, një revistë frymëzuese për shpirtin krijues!

**S**tarting a printanddigitalcultural magazine gave me the sameexcitement, responsibility, andchallenge as the period in which I accepted the positionofdirectorofculture in the capital. For me, everyprojectwithculture as itsbeginningand end is a projectof the heart, and I try to givemybest. PrishtinArtwill be the maingateway to ourcapital'sculture, art, andculturalheritage, the firstinstitutional magazine forculture, but to come to life it mustbecomepartofeachofyou.

This magazine aims to provide a platformwhereartistscan share theirtirelessworkandpassionforenrichingcultural lifeanddiversity in the capital. At the same time, it willserve as a culturalcalendarfor all localandforeign art lovers, whichiswhyweconceived it in twolanguages, Albanian andEnglish. Furthermore, PrishtinArt, in the faceoftechnologicalchallenges, will be a nationalarchive, thatwewillpreservefor a long time andfor generations to come,

profiles of personalities who have given and continue to give spirit to Albanian culture. On the other hand, I hope that this publication not only involve and promotes well-known artists and personalities but also new talents and future creators.

PrishtinArt is not conceived simply as a magazine, but also as a real guide, that reveals the capital in all its dimensions, both tourist and gastronomic, thanks to the collaboration with the Kosovo Tourism Union. So, think of PrishtinArt as a guide to the iconic sites and objects of our cultural heritage, which reflect the richness and unique character of Pristina.

So, let these pages serve as a refuge for those seeking inspiration and a testament to the infinite possibilities created when different artistic expressions come together.

Thank you for starting this journey with PrishtinArt, an inspiring magazine for the creativespirit!



KOSOVA AIRLINES eurokoha

[flyksa.com](http://flyksa.com) | [eurokoha.eu](http://eurokoha.eu)







Nga Brunilda MERKO  
KRYEREDAKTORE

# PrishtinArt, dëshmi e kulturës sonë!

## PrishtinArt, proof of our culture!

**Ç**ka e bën të veçantë një revistë? Shkrimi. Ideja. Fotografia. Dizajni. Sigurisht të gjitha këto përbëjnë elementet kyçe, që lexuesi të ketë arsye të fortë për të pasur në duar një revistë. Megjithatë ajo që ka më shumë rëndësi, është se vlera e një reviste varet në atë se si të “joshë” fillimisht shikimin e lexuesit, pastaj edhe zemrën e tij. Dëshira për të lexuar, me gjithë venitjen që ka pësuar, mbetet katalizatori i vetëm i ndryshimeve pozitive dhe arratisjes nga kotësia. Në tërë këtë “vorbull”, përpjekjesh një shkëndijë drejt stimulimit të vetëdijes dhe kërkesës për më shumë informacion, PrishtinArt tenton të sjellë pozitivitet, cilësi dhe mbi të gjitha një kënd më shumë për të gjithë ata, që ende janë kureshtarë të dinë më shumë... PrishtinArt do të jetë një kalendar kulturor që do të përfshijë të gjitha ngjarjet kulturore dhe artistët e saj. Një platformë e larmishme e artit dhe kulturës në kryeqytetin tonë, një guidë që do të na dërgojë në vendet më interesante dhe joshëse. Në numrin e saj të parë kemi përzgjedhur me kujdes personalitete dhe ngjarje që kanë shënjuar kulturën tonë, dhe ende vazhdojnë ta bëjnë... Kemi përzgjedhur

të gjitha format shprehëse të artit, po kaq edhe një përshkrim panoramik të Prishtinës. Një fokus të veçantë për trashëgiminë tonë kulturore, rëndësinë e saj, por edhe projektet që po e rivitalizojnë atë. Personazhe të larmishme, të cilët shpalosen në PrishtinArt si pjesë e sistemit tonë

kulturor. Kjo revistë u nisë me synimin për të qenë një adresë dhe arkiv i kulturës sonë, në kuptimin e plotë të fjalës, një gjurmë në Prishtinën tonë, e aksesueshme për njerëzit që jetojnë në këtë qytet të jashtëzakonshëm, me të cilin dashurohemi të gjithë.

**W**hat makes a magazine special? Writing. The idea. Photography. The design.

Of course, all these constitute the key elements, so that the reader has a strong reason to have a magazine in his hands. However, what is more important is that the value of a magazine depends on how to first “attract” the reader’s eyes, then his heart. The desire to read, with all the fading it has suffered, remains the only catalyst for positive change and escape from vanity. In all this “whirlwind”, efforts a spark towards stimulating awareness and the demand for more information, PrishtinArt tries to bring positivity, quality and above all one more angle to all those who are still curious to know more. .. PrishtinArt will be a cultural calendar that will include all cultural events and its artists. A

diverse platform of art and culture in our capital, a guide that will send us to the most interesting and tempting places. In its first issue, we have carefully selected personalities and events that have marked our culture, and still continue to do so... We have selected all expressive forms of art, as well as a panoramic description of Pristina. A special focus on our cultural heritage, its importance, but also the projects that are revitalizing it. Diverse characters, which unfold in PrishtinArt as part of our cultural system.

This magazine was launched with the aim of being an address and archive of our culture, in the full sense of the word, a footprint in our Pristina, accessible to people who live in this extraordinary city that we all fall in love with.

# PRISHTINA, NJË QYTET FRYMËZIMI!

Prishtina është një varg i gdhendur i Ali Podrimjes, është varg i lirë, i shkruar me guxim, por është edhe një poezi avangarde, e shpesh herë edhe ironike, shkruhet vazhdimisht dhe përgjithmonë.

## PRISHTINA, A CITY OF INSPIRATION!

Prishtina is an engraved verse by Ali Podrimje, it is a free verse, written with courage, but it is also an avant-garde poem, often ironic, written constantly and forever.

NGA BRUNILDA MERKO | FOTO: ILIRIA NEZIRI












**P**rishtina na fton në çdo cep të saj ta lexojmë, të shkuarën dhe të sotmen e saj, madje edhe atë pjesë që nuk u ndriçua kurrë. Prishtina e vjetër gdhendur nga duart e artizanëve tanë që përçojnë brez pas brezi një copëz trashëgimi kulturore, por edhe Prishtina e re, ajo e mendimeve, ëndrrave dhe emocioneve të rinjve tanë. Prishtina e djeshme, dhe ajo e sotme, fshehur në vizionet e qytetarëve të saj ndër dekada për të qenë shtëpia e të gjithëve. Është reflektim një i hapësire urbane, historike, moderne e jona. Nëpërmjet PrishtinArt kemi zgjedhur të sjellim këtë anë të vendit tonë, jo sepse, nuk ka gjëra për të përmirësuar, punuar edhe më shumë, apo kontribuar si shoqëri, por sepse është momenti që ne qytetarët e saj të bëhemi ambasadorët më të mirë të vendit tonë. Sepse duhet të përcjellim dhe zgjojmë kërshtërinë për kulturën dhe traditat tona, identitetin tonë, të joshim turistët modern me kullat shekullore, me një Ulpianë të jashtëzakonshme, me kostumografi si një mozaik ngjyrash, me një kulinari që buron nga toka jonë. Këtë numër ia dedikojmë Prishtinës tonë të bukur, pjesës së saj më autentike.





**P**rishtina in every corner invites us to read it, its past and present, even that part that was never illuminated. The old Prishtina carved by the hands of our artisans who pass down a piece of cultural heritage from generation to generation, but also the new Prishtina, that of the thoughts, dreams and emotions of our young people. The Prishtina of yesterday, and that of today, hidden in the visions of its citizens over the decades to be the home of all. It is a reflection of our urban, historical, modern space. Through PrishtinArt we have chosen to bring this side of our country, not because there are things to improve, work even more, or contribute as a society, but because it is the moment for us, its citizens, to become the best ambassadors of our country. Because we must convey and awaken the desire for our culture and traditions, our identity, to attract modern tourists with centuries-old towers, with an extraordinary Ulpiana, with costumes like a mosaic of colors, with a cuisine that originates from our land. We dedicate this issue to our beautiful Prishtina, its most authentic part.





**P**ër të zbuluar Prishtinën e sotme, duhet të flasësh për të kaluarën e saj, ta marrim dhe ta kultivojmë si pjesë të përkatësisë së përbashkët. Ta prezantosh do të thotë ta bësh në një kuptim më të plotë, të zbulosh thelbin e saj të vërtetë, përzierjen e saj unike midis traditës dhe modernitetit, pikërisht këtu qëndron aftësia e një shoqërie për të ecur përpara, në ekuilibrin që gjen mes trashëgimisë kulturore dhe modernizimit, sepse të dyja së bashku pasqyrojnë identitetin e shqiptarëve.





To discover today's Prishtina, you must talk about its past, to take it and cultivate it as part of our sense of common belonging. To present it means to do it in a more complete sense, to reveal its true essence, its unique mix between tradition and modernity, because this is precisely where the ability of a society to move forward lies, in the balance that finds between cultural heritage and modernization, because both together reflect the identity of Albanians.

Prishtina është një varg i gdhendur i AliPodrimjes, është varg i lirë, i shkruar me guxim, por është edhe një poezi avangarde, e shpesh herë edhe ironike, shkruhet vazhdimisht dhe përgjithmonë për të. Prishtina janë kafet e rakisë dhe jeta e natës, ku fytyrat urbane të kryeqytetit në vazhdimësi mbetën bohemët e vërtetë të këtij vendi. Prishtina është rini e bukur, e talentuar në çdo cep.... Prishtina është kryeqyteti i muzikës dhe artit pamor. Është gjithmonë një ndërthurje e mendimeve, artit dhe emocioneve, Prishtina është një qytet që të frymëzon. Këdo, madje edhe ata që vijnë dhe shkojnë. Sepse është një qytet autentik, ku bie në dashuri me shpirtin e tij, madje edhe me zërin e sorrave në muzgë, që shpesh herë sfidojnë edhe qiellin e kaltërt të kryeqytetit. Është një qytet dinamik, i cili të rrëmben me shpejtësinë e ngjarjeve që ndodhin edhe në këtë vend të vogël, i cili nuk ndalet, por frymon me gjuhën e artit, teknologjisë, ekonomisë dhe politikës (këtë do ta lëmë anash). Në kujtimet e dikurshme, tënjerëzve që kam njohur dhe njoh çdo ditë nëPrishtinë, ka një emërues të përbashkët, dashurinë e madhe, për të shkuarën, por edhe ndjesitëe reja për të sotmen. Duke lexuar qytetin, në të gjitha format e tij, në trashëgimi kulturore, muzikore, modë, arte pamore apo çkado tjetër, e kupton se Prishtina nuk ështëthjeshtë një atraksion simbolesh apo objekte, por është ndjenjë, emocion dhe shpirt krijues.

Prishtina sot është skenë e koncerteve dhe festivaleve të mëdha, shprehje e festës dhe gëzimit, ndjenja e vërtetë e një komuniteti njerëzish, të cilët lirinë, atë të vërtetën e kanë përjetuar përmes muzikës, po përmes saj kanë thyer tabu dhe kanë krijuar modele në jetë.

Por Prishtina është edhe një ambient ideal i kinemasë. Ky vend i vogël ka dërguar në festivalendërkombëtare, përfshirë dhe çmimet Oscar, filma të frymëzuar nga historia jonë, luftërat, personazhe të mrekullueshme, përditshmëria jonë. Janë faqe të historisë sonë, që nuk duhen kthyer me shpejtësinë e një klikimi, por të gdhenden edhe në të ardhmen tonë, sepse ne jemi përgjegjës si shoqëri, kujtesën, të shprehur në gjithë gjitha format në mënyrë që të jetojë gjatë. Sepse çfarë do të ishte Prishtina dhe njerëzit e saj pa të shkuarën!

Kryeqyteti i Kosovës është sikur një varkë, ndoshta pak e vjetër, me shenja të lodhjes, e konsumuar, e arnuar me copa druri nga gjetkë dhe pjesërisht e riparuar, por pavarësisht gjithçkaje arrin të mbajë të gjitha ëndrrat, idetë dhe projektet e një populli që lundron ditë e natë në kërkim të ekuilibrit, harmonisë, horizonteve të reja, të ndjesisë si pjesë përbërëse e kësaj bote.

Prishtina është kryeqyteti i muzikës dhe artit pamor. Është gjithmonë një ndërthurje e mendimeve, artit dhe emocioneve, Prishtina është një qytet që të frymëzon. Këdo, madje edhe ata që vijnë dhe shkojnë. Sepse është një qytet autentik, ku bie në dashuri me shpirtin e tij, madje edhe me zërin e sorrave në muzgë

Prishtina is an engraved verse of AliPodrimje, it is a free verse, boldly written, but it is also an avant-garde poem, often ironic, it is written constantly and forever about her. Prishtina is the brandy coffees and the night life, where the urban faces of the capital continuously remained the true bohemians of this country. Prishtina is beautiful youth, talented in every corner. Prishtina is the capital of music and visual art. It is always a combination of thoughts, art and emotions; Prishtina is a city that inspires you. Everyone, even those who come and go. Because it is an authentic city, where you fall in love with its spirit, even with the voice of crows at dusk, which often challenge the blue sky of the capital. It is a dynamic city, which grabs you with the speed of events that happen even in this small country, which does not stop, but breathes with the language of art, technology, economy and politics (we will leave this aside). In the memories of the past, of the people I knew and know every day in Prishtina, there is a common denominator, the great love for the past, but also new feelings for today. Reading the city, in all its forms, in cultural heritage, music, fashion, visual arts or anything else, you understand that Prishtina is not just an attraction of symbols or objects, but it is feeling, emotion and creative spirit.

Today, Prishtina is the scene of big concerts and festivals, an expression of celebration and joy, the true feeling of a community of people who have experienced freedom, that truth through music and through it they have broken taboos and created models in life.

But Prishtina is also an ideal cinema environment. This small country has sent to international festivals, including the Oscars, films inspired by our history, wars, wonderful characters, our everyday life. They are pages of our history, which should not be returned with the speed of a click, but also engraved in our future, because we are responsible as a society, the memory, expressed in all forms so that it lives long. Because what would Prishtina and its people be without the past!

The capital of Kosovo is like a boat, maybe a little old, with signs of fatigue, worn out, patched with pieces of wood from elsewhere and partially repaired, but despite everything it manages to hold all the dreams, ideas and projects of a people who sails day and night in search of balance, harmony, new horizons, feeling like an integral part of this world.

Prishtina is the capital of music and visual art. It is always a combination of thoughts, art and emotions; Prishtina is a city that inspires you. Everyone, even those who come and go. Because it is an authentic city, where you fall in love with its soul, even with the crows' voice at dusk.







Prishtina është vendi i xhamisë dhe kishës, vendi i tolerancës fetare, shqiptarët kudo ku janë e kanë të shenjtë bashkëjetesën mes vete, pavarësisht besimit fetar. Shtëpia e Zotit, është shtëpia edhe e shqiptarit.



Prishtina is the place of the mosque and the church, the place of religious tolerance, albanians wherever they are have sacred coexistence among themselves, regardless of religious belief. The house of God is also the house of the Albanian.

Rruga Model, e gjendur në pjesën e vjetër të kryeqytetit, po i rikthehet identiteti i saj, duke u rivitalizuar e gjitha. Kjo rrugë përmban 18 ndërtesa, tre prej të cilave janë monumente arkitekturore, pjesë e Listës së Trashëgimisë Kulturore.



Model Street, located in the old part of the capital city, is regaining its identity, all being revitalized. This street contains 18 buildings, three of which are architectural monuments, part of the Cultural Heritage List.

“Në kohët që po rrijmë është normalizuar mosbesimi e gjykimi i ashpër ndaj njerëzve. Nëse kishim mujtë krejt me e bo ma të mirën tonë që me mbjellë besim e mirëkuptim për natyrën njerëzore, krejt kjo përvojë e çmendur e jetës ish bo shumë ma e lehtë. Frymimi jem' në këtë botë qarkullon përreth dëshirës së madhe për me i pa njerëzit tu jetu me ma pak gjykim, e me ma shumë mëshirë. La fazani/ Arber Salihu



“In the times we live in, mistrust and harsh judgment towards others have become normalized. If we had done our best to instill faith and understanding in human nature, all this crazy experience of life would have been much better. The breath I am in this world revolves around the great desire to see people live with less judgment and more mercy. La phazani/ Arber Salihu

Është adresa e parë për të rinjtë, por dhe bohemët e këtij qyteti, rruga 2 Korriku, në zemër të Prishtinës, e njohur si “Kafet e rakisë”, ngërthen në vete me mijëra net të bukura, muzikë dhe dashni, gëzime dhe trisitime.



It is the first address for the young people, but also the bohemians of this city, “2 Korriku” street, in the heart of Prishtina, known as “Brandy Coffees”, holds thousands of beautiful nights, music and love, joys and sorrows.

Le të triumfojë dashuria, kudo dhe kurdo, ku njerëzit japin edhe marrin, ndaj ta shohim Prishtinën të “pushtuar” nga dashuria, le të mbizotërojë kudo në zemrat tona.



Let love triumph, wherever and whenever, where people give and receive, so we see Prishtina “occupied” by love, let it prevail everywhere in our hearts.

Në zemër të Prishtinës, lartëson emrin e shenjtores shqiptare, Nënë Terezës, Katedralja, është simbol e dashurisë, bashkëjetesës dhe mirënjohjes së përfjetshme.



In the heart of Prishtina, the Cathedral honors the name of the Albanian saint, Mother Teresa; it is a symbol of love, coexistence and eternal gratitude.

# Identiteti kulturor dhe rritja e një kryeqyteti!

Një qytet duhet të krijojë identitet kulturor, të shfrytëzojë potencialin transformues të kulturës për të frymëzuar, nxitur dhe bashkuar njerëz. Ruajtja dhe zhvillimi i kulturës duhet të jetë qëllim i përhershëm dhe primar, ndaj besoj se kjo ishte njëra ndër arsyt kryesore pse qytetarët mbështetën ardhjen në krye të Komunës së Prishtinës, të një arkitekti si Përparim Rama, larg kostumit të politikës. Një intervistë kryekëput veç për artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore në kryeqytet, synimet dhe projektet kapitale si i pari i Prishtinës.

INTERVISTOI: BRUNILDA MERKO

## Cultural identity and the growth of a capital!

*A city must create a cultural identity, and harness the transformative potential of culture to inspire, provoke, and unite people. The preservation and development of culture should be a permanent and primary goal, so I believe that it was one of the main reasons that the citizens supported the arrival at the head of the **Municipality of Pristina, an architect, like Përparim Rama**, away from the suit of politics. An interview that focuses exclusively on art, culture, and cultural heritage in the capital, goals, and capital projects as Pristina's first.*



←

Jam i bindur se në vitet në vijim Prishtina do të udhëheqë si qytet i kulturës.

I am confident that in the years to come Prishtina will lead as a city of culture.

Kultura zë një vend të rëndësishëm në axhendën e qytetit në kuptimin strategjik. Ne kemi disa projekte që po i shtyjmë përpara si Muzeu i Artit Bashkëkohor në Prishtinë, Salla e Koncerteve dhe Galeria e Arteve, qendrat e teknologjisë dhe artit, restaurimi i Pallatit ikonik të Rinisë së qytetit tonë dhe krijimi i një roli të ri në administratën komunale të Prishtinës, i pari “Kuratori i Qytetit”.

“

Culture takes on an important place in the city's agenda in the strategic sense. We have several projects that we are pushing forward such as The Museum of Contemporary Art in Prishtina, The Concert Hall and Art Gallery, Technology and Art hubs, The restoration of our City's iconic Palace of Youth, and the creation of a new role in Prishtina's municipal administration the first ever “City Curator.”



## Shpesh kultura mbetet në fund të prioritetëve të politikanëve, në rastin tuaj si Kryetar komune, çfarë vendi zënë në agjendën tuaj arti, kultura dhe trashëgimia kulturore?

**N**e jetojmë në një qytet të pashoqndokund në botë për nga aftësitë e krijuesve tanë dhe cilësinë e artit tonë. Skena kulturore në Prishtinë është e pasur, por ka nevojë të vazhdueshme për shqyrtim dhe mbështetje serioze. Unë, si kryetar i organit më të lartë publik të Kryeqytetit, e kam përgjegjësi të sigurohem se po mbështesim qindra profesionistë kreativë të avancuar që e quajnë Prishtinën shtëpi, si dhe se po identifikojmë nevojat e tëshkëlqyeshmit brez të ardhshëm. Shumë prej krijuesve në Prishtinë janë liderë botërorë në fushat e tyre, që nga moda deri te teknologjia, muzika e filmi. Kjo është dëshmi e aftësive të qytetarëve të Prishtinës, veçmas e rinisë, për t'i arritur majat e kulturës botërore dhe ne duhet t'i mbështesim në këtë përpjekje. Unë jam mirënjohës dhe dëshiroj të falënderoj ekipin tim të palodhshëm të kulturës, të udhëhequr nga Drejtoresha e Kulturës Arta Balaj, e cila punon shumë për të ndihmuar qytetin të realizojë potencialin e tij si një qytet gjithëpërfshirës, emocionues, i ndërlikur – një qytet pra për të gjithë njerëzit në çdo moshë, duke bërë një ndryshim për cilësinë e jetës që përjetohet këtu. Drejtoresha Arta sigurohet

### Culture often remains at the bottom of politicians' priorities, in your case as mayor, what place does art, culture, and cultural heritage occupy in your agenda?

**W**e live in a city unrivaled anywhere in the world for the capabilities of our creatives and the quality of our art. The cultural scene in Prishtina is rich but is in continuous need of serious consideration and support. As the Mayor of the highest public body of the Capital, it is my responsibility to ensure we are supporting the hundreds of cutting-edge creative professionals who call Prishtina home as well as identify the needs of our brilliant up-and-coming future generation. Many of the creatives in Prishtina are world leaders in their fields, from fashion to tech, music, and film. This is evidence of the capabilities of citizens of Prishtina, in particular youth, to reach the peaks of world culture, and we need to support them in this endeavor. I am grateful and wish to thank my tireless culture team led by Director of Culture Arta Balaj, who work hard at helping the city realize its potential as an inclusive, exciting, connected city - a city for all people at every age, making a difference to the quality of life experienced here. Director Arta ensures our program and cultural mission

që programi dhe misioni ynë kulturor të transmetohet dhe të vendoset gjatë gjithë vitit. Festalet, koncertet, ekspozitat dhe festat tona në rrugë, të ofrojnë hapësirë për të mbledhur lagjet, duke ndihmuar në krijimin e lidhjeve të forta të komunitetit dhe mundësitë që banorët të pushojnë, të shprehen, të mësojnë dhe të shoqërohen. Çdo ditë ne po punojmë së bashku drejt nxitjes së përparimeve në njohuri për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve tanë përmes përdorimit të zgjidhjeve kreative, si dhe kultivimit të mëtejshëm të sektorit të artit dhe kulturës së Prishtinës, pasi do të luajë një rol jetik në tërheqjen globale dhe suksesin e kryeqytetit tonë.

### Cilat janë disa projekte kapitale të cilave keni planifikuar t'u jepni "jetë" deri në fund të këtij mandati?

**K**ultura zë një vend të rëndësishëm në agjendën e qytetit në kuptimin strategjik. E thashë që në fillim të fushatës se kultura do të jetë një prioritet i lartë, dhe kështu mbetet. Ne kemi disa projekte që po i shtyjmë përpara, si Muzeu i Artit Bashkëkohor në Prishtinë, Salla e Koncerteve dhe Galeria e Arteve, të dizajnuara nga arkitekti i njohur japonez Kengo Kuma, qendrat e teknologjisë dhe artit, restaurimi i Pallatit ikonik të Rinisë së qytetit tonë dhe krijimi i një roli të ri në administratën komunale të Prishtinës – i pari "Kurator i Qytetit".

is transmitted and deployed throughout the year. Our festivals, concerts, exhibitions, and street parties, provide space for neighborhoods to gather, helping to create strong community bonds, and for residents to relax, express themselves, learn, and socialize. Every day we are working together towards fostering advances in knowledge to improve the quality of life of our residents through the use of creative solutions, as well as further cultivate Prishtina's arts and cultural sector as it will play a vital role in our capital's global appeal and success.

### What are some capital projects that you have planned to give "life" until you finish this mandate?

**C**ulture takes on an important place in the city's agenda in the strategic sense. I said early in my campaign that Culture will be a high

Në nivel personal, është pjesë e domosdoshme e të bërit të një jete të shëndetshme dhe përmbushëse, nga rëndësia e saj për përkatësinë dhe identitetin, e deri te rritja e vetëdijes. Duke e pasur këtë parasysh, ne mendojmë dhe i japim përparësi zërave të grupeve të marginalizuara, duke përfshirë të rinjtë, të paaftët dhe komunitetin e ylberit. Duke i përfshirë në mënyrë aktive këto komunitete në diskutime, ne i konsiderojmë nevojat e çdo prishtinasi dhe sigurojmë që ata të kenë mundësinë të angazhohen dhe të përfitojnë nga kultura. Në nivelin shoqëror – kjo do të jetë forca lëvizëse e ardhshme e vetësigurimit dhe prosperitetit të Prishtinës.

Për sa u përket projekteve madhore në kryeqytet, ky vit i ri 2024 po nis me finalizimin e projektimit të Sallës së Koncerteve dhe Galerisë së Arteve aq të shumëpritur. Shndërrimi i objektit të Gërmisë në galeri dhe sallë koncertesh është me prioritet të madh. Ky transformim do të bëhet duke i kushtuar vëmendje të veçantë ruajtjes së identitetit të Gërmisë. Faza tjetër do të jetë ofertimi për ndërtim dhe më pas do të kalojmë në rikonstrukcionin e brendshëm, i cili do të jetë unik për vendin dhe në mbarë botën. Gjeometria komplekse e sallës bashkon rrjedhën organike me linja prerëse që ta kujtojnë pohimin e kompozitorit Johann Wolfgang von Goethe se "arkitektura është muzikë e ngrirë". Nëpërmjet projektimit të Kengo Kuma, ne do ta përjetojmë arkitekturën jo si muzikë të ngrirë, por si muzikë të gjallë, që u flet zemrave dhe shpirtave tanë. Do të jetë një entitet madhështor arkitekturor, një sallë përfshirëse e performancës/qendër mësimi që do të frymëzojë talentin vendas dhe global.

Muzeu i Artit Bashkëkohor po përfundon gjithashtu ciklin e fundit të bisedimeve përpara se të hyjë në fazën e projektimit. Aktualisht është në proces rivitalizimi i Pallatit të Rinisë. Ne po i japim kësaj hapësire të dashur një frymë të re, duke kombinuar respektin për vlerën artistike me koncepte të tilla si efikasiteti dhe qëndrueshmëria.

**Ne po i japim kësaj hapësire të dashur një frymë të re, duke kombinuar respektin për vlerën artistike me koncepte të tilla si efikasiteti dhe qëndrueshmëria. Është një sipërmarrje masive që ne po ia kthejmë Rinisë së kryeqytetit dhe po krijojmë një hapësirë të vërtetë me emrin e saj - Pallati i Rinisë.**

**We are giving this beloved space a new lease on life, combining respect for artistic value with concepts such as efficiency and sustainability. It's a massive undertaking that we are giving back to the Youth of the capital, and creating a space true to its name - the Palace of Youth.**

priority, and it remains so. We have several projects that we are pushing forward such as The Museum of Contemporary Art in Prishtina, The Concert Hall and Art Gallery designed by renowned Japanese architect Kengo Kuma, Technology and Art hubs, The restoration of our City's iconic Palace of Youth, and the creation of a new role in Prishtina's municipal administration -- the first ever "City Curator."

On a personal level, it is a necessary part of leading a healthy and fulfilling life, from its importance on belonging and identity to the growth of self-awareness. Bearing this in mind, we think and prioritize the voices of marginalized groups, including youth, the disabled, and the rainbow community. By actively involving these communities in discussions, we consider the needs of every Prishtina citizen and ensure they have the chance to engage and benefit from culture. On a societal level -- this will be the future driving force of Prishtina's self-assurance and prosperity.

In terms of major projects in the Capital, this new year 2024 begins with finalizing the design of our long-awaited Concert Hall and Art Gallery. The transformation of the Gërmia building into a gallery and concert hall is of utmost priority. This transformation will be conducted by paying special attention to the preservation of Gërmia's identity. The next phase will be bidding for construction, and then we will move on to reconstructing the interior, which will be unique for the country and worldwide. The complex geometry of the hall unites organic flow with incisive lines reminiscent of composer Johann Wolfgang von Goethe's observation that "architecture is frozen music". Through Kengo Kuma's design, we will experience architecture not as frozen music, but as living music, speaking to our hearts and souls. It will be a grand architectural entity, an immersive performance hall/ learning center that will inspire local and global talent.

The Museum of Contemporary Art is also completing its final cycle of talks before entering the design stage. The revitalization of the Palace of Youth is currently



Kultura do të luajë një rol jetik në tërheqjen globale dhe suksesin e kryeqytetit tonë.

Është një sipërmarrje masive që ne po ia kthejmë Rinisë së kryeqytetit dhe po krijojmë një hapësirë të vërtetë me emrin e saj - Pallati i Rinisë. Me të njëjtin intensitet, Drejtoria jonë e Planifikimit Strategjik dhe Ekipet e Arkitekturës së Qytetit kanë caktuar zona për një ekosistem inovativ për krijimin dhe zgjerimin e qendrave të teknologjisë dhe artit. Ne po e transformojmë edhe hapësirën e Tulltores, e cila ishte e papërdorur dhe e braktisur për dekada të tëra, në një qendër Arti dhe Teknologjie, për t'u përdorur nga artistët dhe komunitetet eTIK-ut si dhe qytetarët në përgjithësi. Kjo është një tjetër dëshmi e përkushtimit tim ndaj kulturës.

### **A mendoni se Prishtina ka kapacitet për t'u bërë një adresë e ngjarjeve të mëdha kulturore?**

**N**e patëm një ngjarje të jashtëzakonshme botërore Biennale, e cila i ngriti artistët tanë dhe idetë e tyre në nivele më të larta. Katër vjet më parë Manifesta që zhvilluar në Marsejë, pastaj në Palermo, e pas dy vjetësh Manifesta do të zhvillohet në Barcelonë, prandaj pozicionimi ndër këto qytete mbresëlënëse evropiane është një ngadhënjim i madh për ne. Prishtina po mbushet me energji dhe po shpërthen me talentet vendore, të cilët janë në një ligë të tyren në botën e arteve bashkëkohore dhe të mendimit bashkëkohor. Jam i bindur se në vitet në vijim Prishtina do të udhëheqë si qytet i kulturës.

underway. We are giving this beloved space a new lease on life, combining respect for artistic value with concepts such as efficiency and sustainability. It's a massive undertaking that we are giving back to the Youth of the capital, and creating a space true to its name - the Palace of Youth. With the same intensity, our Strategic Planning Directorate and City Architecture Teams have designated areas for an innovation ecosystem for the creation and expansion of technology and art hubs. We are also transforming the Tulltore space, which was unused and abandoned for decades, into an Arts' and Tech center to be used by the artist and IT communities as well as citizens in general. This is yet another testimony of my dedication to culture.

### **Do you think that Prishtina can become an address for major cultural events?**

**W**e had an outstanding world event that took place here last year, Manifesta Biennale, which raised our artists and their ideas to higher ground. Four years ago Manifesta took place in Marseille, then Palermo, in two years' time Manifesta will take place in Barcelona, to be positioned among these impressive European cities is a great triumph for us. Prishtina is brimming with energy and bursting with local talent who are in a league of their own in the world of contemporary arts and contemporary thought. I am confident that in the years to come Prishtina will lead as a city of culture.



# Kryeqyteti i festivaleve



**K**ryeqyteti i festivaleve. Prishtina ka qenë gjithmonë hapësira ideale dhe e vazhdueshme për festivalet, pavarësisht zhanrit të tyre. Prej vitesh kryeqyteti është kthyer në një skenë të madhe të muzikës, gjuhës së përbashkët të botës. Chopin Piano Fest, Sunny Hill Festival, Prishtina Jazz Festival, Dam Festival, ReMusica janë disa prej festivaleve më të mëdhenj që mbahen çdo vit në vendin tonë. Megjithatë duket se viti 2024 nisë me një lajm të bukur në këtë drejtim. Atje tej ne horizont na shfaqet një iniciativë tejet e rëndësishme dhe njëkohësisht interesante nën emrin "EFFE Seal", e cila dëshmon suksesin e radhës për Prishtinën kryeqytet. "EFFE Seal" është një projekt i zhvilluar në kuadër të FestivalFinder.eu (a)Live Noë nga EFA(European Festival Association), marrëveshje të cilën Drejtoria për Kulturë në Komunën e Prishtinës do ta nënshkruajë në Arts Festival

Summit 2024, në Usedom, Gjermani dhe shtatë qytete - Beogradi, Bergeni, Edinburgu, Genti, Krakovi, Leeuëarden dhe Ljubljana - dhe palët e tyre të interesit. Qytetet dhe festivalet duhet të lidhen me njëri-tjetrin. Komuniteti do të fitojë një shpirt, përvojë të pashembullt ose të kuptuarit e diçkaje më të madhe se vetja. Përpos EFFE Seal, EFA zhvillon një mori aktivitete duke qenë, para së gjithash, rrjet i festivaleve evropiane, e cila ekziston që nga viti 1952 në Bruksel, ndërsa disa nga iniciativat e saja janë: Festivalfinder.eu, EFFE Seal, Eye to Eye deri tek EFFEA - European Festivals Fund for Emerging Artists - projekt të cilin do ta koordinojë Donika Rudina. Thirrja e tretë do të dalë në janar 2024 dhe të gjitha festivalet e të gjitha disiplinave kanë të drejtë aplikimi, përfshi Kosovën, një angazhim konkret i nënshkruar nga qytetet për bashkëpunim të ngushtë me festivalet e tyre.

# The capital of festivals

**P**rishtina has always been the ideal and continuous space for festivals, regardless of their genre. For years, Prishtina has turned into a big scene of music, the common language of the world. Chopin Piano Fest, Sunny Hill Festival, Prishtina Jazz Festival, Dam Festival, ReMusica are some of the biggest festivals held every year in our country. However, it seems that the year 2024 starts with good news in this direction. Over there on the horizon appears a very important and at the same time interesting initiative under the name "EFFE Seal", which proves the next success for Prishtina, the capital city. "EFFE Seal" is a project developed within the framework of FestivalFinder.eu Live Now by EFA (European Festival Association), an agreement which the Directorate for Culture in the Municipality of Prishtina will sign at the Arts Festival Summit 2024, in Usedom, Germany and seven cities - Belgrade, Bergen, Edinburgh, Ghent, Krakow, Leeuwarden and Ljubljana - and their stakeholders. Cities and festivals should be connected to each other. The community will gain a soul, unparalleled experience or understanding of something greater than itself. Besides the EFFE Seal, EFA carries out a multitude of activities, being, first of all, a network of European festivals, which has existed since 1952 in Brussels, while some of its initiatives are: Festivalfinder.eu, EFFE Seal, Eye to Eye to EFFEA - European Festivals Fund for Emerging Artists - project which will be coordinated by Donika Rudina. The third call will be issued in January 2024 and all festivals of all disciplines have the right to apply, including Kosovo. It is a concrete commitment signed by the cities for close cooperation with their festivals.

A photograph of two young women laughing joyfully in a city square. The woman on the left has dark hair and is wearing a green polka-dot top. The woman on the right has long blonde hair and is wearing a white top. They are both looking upwards and laughing. The background shows a blurred city square with buildings.

Blej  
ONLINE  
dhe në çdo  
zyrë  
të Sigal-it

## Sigurim i domosdoshëm!

Për të gjithë qytetarët  
që udhëtojnë jashtë Kosovës.  
Të sigurt me **SIGAL UNIQA**

[uniqa-ks.com](http://uniqa-ks.com)



Armend Rexhepagiqi

# Artisti i trazuar

# The troubled artist

Në një intervistë labirinth, nëpër skutat e mendjes dhe zemrës së tij, vjen në një rrëfim të plotë artisti ynë, ikonë e Prishtinës, por edhe Kosovës, **Armend Rexhepagiqi**.

In a labyrinthine interview, through the recesses of his mind and heart, our artist, an icon of Pristina, but also of Kosovo, comes to a full confession **Armend Rexhepagiqi**.

INTERVISTOI: BRUNILDA MERKO

## Cili është kujtimi juaj i parë si artist?

Isha i vogël, pesë vjeç, nëna shikonte në TV operën "Rigoletto" të Verdit, unë e "duroja" si zhurmë në prapavijë, duke luajtur me lodrat e mia. Papritur njëherazi fillon pjesa në 4 zëra, 4 këngëtarë këndojnë njëkohësisht. Në fakt, dy duete ishin, këndojnë, një nga pjesët muzikore më të bukura që kam dëgjuar ndonjëherë në jetë, secili çift vazhdon me dialogun e vet në të njëjtën kohë. Pos tingujve ndërlihen edhe vargjet, që janë të ndryshme, por që prapë, nuk e di si, kuptoheshin, në gjuhën për mua të panjohur, mbaj mend si sot, e ngrita kokën, i shokuar... gati i paralizuar nga gjithë ajo bukuri. Atëherë nuk e dija si e di tani, se tërë jeta ime nga ai moment, do të jetë ngarendja pas magjisë dhe vërtetësisë së tillë artistike, që kurrë nuk e arrita.

## What is your first memory as an artist?

I was little, five years old, my mother was watching the opera "Rigoletto" by Verdi on TV, I "endured" it as noise in the background, playing with my toys. Suddenly, the part in 4 voices starts simultaneously, 4 singers sing simultaneously. The two duets were, they sang, one of the most beautiful pieces of music I've ever heard in my life, each couple continuing their dialogue at the same time. Besides the sounds, the verses were also connected, which are different, but still, I don't know how, they were understood, in a language unknown to me, I remember like today, I raised my head, shocked... almost paralyzed by all that beauty. I didn't know then, as I know now, that my whole life from that moment on, would be the pursuit of such artistic magic and authenticity, which I never achieved.

## Are your songs lived experiences or more of a state of mind?

That cold, rational attitude of mine, which will not mystify unnecessarily, would immediately answer: - "These are roles that must be acted well!". Then comes my real plane: They are pain, which must be suffered and overcome somehow! They are states of mind, which sleep snuggled up, somewhere in me and I bring them out as needed, as an interested party in front of the public to bring them back to where they live. Not daring to tease them too much that they might hurt me... they might rebel and refuse to go back to their prison, they might start the crazy dance of independence from me that no one controls anymore! To be an artist means to feel, to understand without words, to understand without interest, to know how to extract from yourself the feeling that we all



FOTO: HAZIR REKA



## Këngët tuaja, janë përvoja të jetuara apo më shumë gjendje shpirtërore?

Ai qëndrimi im i ftohtë, racional, që s'do të mistifikojë pa nevojë, do të përgjigjej menjëherë: - "Janë role që duhen aktruar mirë!". Pastaj vjen rrafshi im i vërtetë: Janë dhimbje, që duhet vuajtur dhe tejkaluar disi! Janë gjendje shpirtërore, të cilat flenë të strukura, diku në mua dhe unë i nxjerr sipas nevojës, si një interesaxhi para publikut që t'i kthej përsëri aty ku ato jetojnë. Duke mos guxuar t'i ngacmoj shumë se mund të më lëndojnë... mund të rebelohen e të refuzojnë të kthehen në burgun e tyre, mund të fillojnë vallëzimin e çmendur të pavarësisë nga unë, që askush më nuk i kontrollon! Të jesh artist do të thotë të ndjesh, të kuptosh pa fjalë, të mirëkuptosh pa interes, të dish të nxjerrësh nga vetja ndjenjën që të gjithë e kemi dhe ta përcjellësh me artin tënd tek të tjerët, nëse do, është një gjendje shumë fragile, e lodhshme, e çuditshme. Rras-kapitësë! Të paktën te unë...e bukur më vonë ndoshta... Këngët e mia (tona, se aq sa janë të miat, janë edhe të Aidës), janë edhe përvojë e jetuar, ndonjëherë do të doja mos të ishte, pastaj prapë mundohem të kuptoj shkollën e jetës. Të besoj se ka arsye pse leksionet e jetës janë të domosdoshme, ato ndodhin për të na bërë njerëz më të mirë.

## Ndër vite keni zhvilluar një stil të veçantë, në skenë dhe jetë, mbi të gjitha këngë që i mbijetojnë kohës, sipas jush, çfarë e karakterizon një artist të mirëfilltë?

Kopjimi, haha. E sa i rëndësishëm është, në fakt, se në fillim të gjithë kopjojmë, deshëm apo jo, sepse s'kemi zgjidhje profesionale ose të përvojës. Duam të ngajmë si ai ose ajo, bëhemi qesharak duke tentuar të kopjojmë idhullin tonë! Pastaj mësohemi se ka edhe forma tjera të krijimit. Nëse kemi fat mund të ndodhë që edhe të krijojmë, si shumë të ri, diçka krejtësisht origji-

nale e ta befasojmë veten me pyetje: si e krijova, pse s'mundem përsëri, a ka vlerë apo vetëm mua me duket se po? Pastaj rritemi dhe kombinojmë, kopjimin, eksperiencën, inteligjencën. Dyshimi në vlerën e veprës tënde është tërë kohën prezent dhe ndoshta dyshimi bashkë me tendencën për perfeksionizëm konstant, janë tipare që dallojnë artistin nga jo artisti. Por ka edhe njerëz që nuk krijojnë art, janë kaotik, konfuz, nuk arrijnë pragun që diferencon një vepër të mirë ose jo, e ata njëjtë dyshojnë dhe tentojnë perfeksionin! Ndoshta aftësia që të arrish të bartësh një ndjenjë (fisnike, se argëtues kemi sa të duash) që të gjithë e kemi ndjerë dhe e dallojmë kur e shohim, të transmetosh, pra, në një mënyrë tjetër e të arrish që ta ndjenjë e dallojë edhe të tjerët. Pa marrë parasysh a është i vogël numri i tyre, ndoshta kjo është të jesh artist. E di shumë mirë çka nuk është artistike, sipërfaqësorja, banalja, vulgarja, e parafinuara, mungesa e nuancës, manipulimi etj... Tërë qenia ime reagon me turp kur e vërej edhe në veprën time, ndihem keq! E shoh edhe tek të tjerët, shpesh, çdo ditë, por me të tjerët jam më tolerant, më pak kritik se me veten. S'di pse! Në fakt e di, si lejoj vetes të hyj në grupin e kritikëve të përhershëm, të zemëruar me krejt botën. Jo, dua të shoh të mirën, të paktën tek të tjerët.

## Cili/a artist/e ka lënë gjurmë të thella në personalitetin tuaj artistik?

Disa këngë që më kanë formësuar dhe mahnitur në fillimet e mia, që para disa dekadash si: David Bowie "Ashes to ashes", Kate Bush "Wuthering Heights", Eurythmics krejt këngët, pastaj shumë këngë të mira nga festivale të dikurshme të Kroacisë, të San Remos, Eurosong-ut, por edhe "S'jam tribu" nga Aurela Gaçe, disa këngë të "Gjurmëve", këngë të motrës sime Violetës... Sot me kureshtje dëgjoj dhe respektoj punën e Jerichos, Genc Salihut, Visar dhe Tomor Kuçit, hip-hopin shqiptar, vajzat kantautore si Fifi, Samanta, Ronela dhe Dafina, mos

deri në 150 mijë kopje. Si gazetar dhe mandej redaktor dhe së fundi edhe korrespondent i përhershëm i saj në Bon të Gjermanisë (nga viti 1974 dhe 1993-2008), kam marrë pjesë në këtë zhvillim kulturor dhe botues ndër më të fuqishmit e botës shqiptare në përgjithësi. Arsyet për këtë kanë qenë kulturore, shoqërore dhe politike njëherësh, ngaqë gazeta "Rilindja" si nga aspekti informativ, ai kulturor dhe shoqëror-politik për qëllim kishte që të nxjerr në pah identitetin tonë kulturor, arsimor, shkencor-hulumtues në të gjitha nivelet nga ato universitare dhe akademike. Në planin shoqëror-politik, nga viti 1972 Rilindja filloi hapjen e korrespondentëve jashtë, fillimisht në Lindjen e Afërme (korrespondent i parë ishte Nehat Islami), atë në Bon të Gjermanisë (korrespondent i parë isha unë për shumë vite), pastaj edhe në SHBA (korrespondent i parë ishte Maksut Shehu). Hapja e korrespondentëve në botë, ku gazetarët kishin tretmanin e diplomatëve kulturor, u ndanë në vitin 1981, nga regjimi i Beogradit, prej nga edhe do të fillojë faza e reprezaljeve ndaj kësaj gazete dhe gjithë kulturës shqiptare e cilësuar asokohe me Platformën e KQ të LKJ-së si "ushqyese e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar"! Ky formulim pra pasqyron më së mirë rolin e "Rilindjes" në vetëdijen kulturore dhe shoqërore dhe politike drejt arritjes së subjektivitetit tonë në federatën jugosllave

**Gjithashtu një vend të konsiderueshëm zënë edhe botimet për autorë të ndaluar në Shqipëri, sa e ndihmoi kjo letërsinë shqipe?**

Roli i madh i veprimtarisë botuese të Rilindjes, siç u tha më lartë, ishte se mbas marrëveshjes shtetërore midis Kosovës dhe Shqipërisë në vitin 1968, ishte në shkëmbimin e botimeve të librave nga Kosova në Shqipëri dhe anasjelltas. Kjo ishte periudha e lartë e njësimi tonë kulturor përmes librit. Rilindja i ofronte çdo vit rreth njëqind libra të autorëve nga Shqipëria (të shumtën letërsi), ndërsa edhe autorët kosovarë prezantoheshin në Shqipëri. Duhet thënë se kjo punë ndikoi që të thyhen edhe kornizat e socrealizmit si metodë ideologjike në Shqipëri.

factors at the same time because the newspaper "Rilindja" both from the informational, cultural, and socio-political aspects was intended to highlight our cultural, educational, scientific research identity at all levels from university and academic ones. In the socio-political plan, from 1972 Rilindja started opening correspondents abroad, first in the Near East (the first correspondent was Nehat Islami), then in Bonn, Germany (I was the first correspondent for many years), then in the USA (the first correspondent was Maksut Shehu). The opening of correspondents in the

world, where journalists were treated as cultural diplomats, soon were separated in 1981, by the Belgrade regime, from where the phase of reprisals against this newspaper and the entire Albanian culture began at that time with the Platform of the Central Committee of the LKJ as "feeder of Albanian nationalism and irredentism"! This formulation therefore better reflects the role of "Rilindja" in cultural, social,

and political awareness toward the achievement of our subjectivity in the Yugoslav Federation.

**"Rilindja" ka paraqitë barometri më të rëndësishëm të vlerave të arritura në të gjitha lëmenjtë e krijimtarisë sonë shpirtërore.**



**"Rilindja" has presented the most important barometer of the values achieved in all areas of our spiritual creativity.**

**Publications for authors banned in Albania also occupy a significant place, how much did this help Albanian literature?**

The great role of the publishing activity of Rilindja, as stated above, was that after the state agreement between Kosovo and Albania in 1968, it was in the exchange of book publications from Kosovo to Albania and vice versa. This was the high period of our cultural unity through the book. Every year, Rilindja offered around a hundred books by authors from Albania (mostly literature), while Kosovar authors were also presented in Albania. It must be said that this work influenced the breaking of the frames of social realism as an ideological method in Albania.

# Skulptura e rezistencës!

## The sculpture of resistance!

NGA BLEONA HAJDARI

**F**otografia ikonike e protestave të Republikës së Kosovës, për liri dhe pavarësi, e realizuar nga autori i mirënjohur Hazir Reka, është “materializuar” në bronz nga artistja Eliza Shala në sheshin e Prishtinës. Duke qëndruar stoikisht, kjo skulpturë e krijuar mjeshtërisht nga një fotografi shumë domethënëse që shpirt i ka dhënë personazhi Faik Rexhepi është dëshmi e vetë rezistencës së Kosovës.

“Fillimisht ka qenë një thirrje nga Komuna e Prishtinës, për realizimin e projekteve, për zbulimin e Prishtinës përmes veprave dhe instilacioneve artistike, gjë e cila ka qenë një rast i mirë të shpalos ndonjë punë artistike, që lidhet me studimet e mia. Me fotografinë e Faik Rexhepit jam ndeshur rastësisht në artikujt e postuara në rrjete sociale dhe më është dukur interesante, prandaj jam interesuar në lidhje me të dhe e gjithë historia e Faikut më ka impresionuar, sidomos stoicizmi i tij paqësor kundër dhunës së shfrenuar të pushtetit të asaj kohe”- thotë vetë artistja. Kjo skulpturë e vendosur në zemër të Prishtinës ngjallë vëmendjen e të gjithë qytetarëve dhe patjetër që përveç artit të mirëfilltë skulptura bartë në vete një mesazh shumë domethënës. “Skulptura në vete mund të shpreh disa mesazhe, unë mendoj se vizualisht pozicioni i tij jep një porosi paqeje dhe qetësie si një simbolikë shumë e fortë kundër asaj dhune që ka ndodhur ndaj një populli paqedashës e të pambrojtur. Skulptura ka bërë dhe një atraksion të madh vizuel sidomos tek vizitorët e huaj tek të cilët ngjallë kureshtje dhe një ndjenjë simpatie dhe adhurimi dhe sot kjo skulpturë është skulptura më e fotografuar në Kosovë”- vazhdon më tutje Eliza. Skulptura e rezistencës është dhe do të mbetet përherë ndërthurje shumë e bukur e të vërtetës së hidhur si dhe qëndresës heroike të mbarë popullit të Kosovës.



**T**he iconic photo of the protests of the Republic of Kosovo, for freedom and independence, created by the well-known Albanian author Hazir Reka, was “materialized” in bronze by the artist Eliza Shala in the Pristinasquare. Stoically, this sculpture carefully created from a very significant photograph inspired by the character Faik Rexhepi, is proof of the very resistance of Kosovo. “Initially it was a request from the Municipality of Pristina, for a subsidy for the implementation of projects, for the beautification of Pristina through artistic works and installations, which for me seemed a good opportunity to reveal my artistic work related to my studies. I accidentally came across the photograph of Faik Rexhepi in the articles posted on social networks and it seemed interesting to me, that’s why I became interested and the whole story of Faik struck me, especially his peaceful stoicism against the rampant violence of the government. in that time” - says Eliza. This sculpture, located in the heart of Pristina, attracts the attention of all citizens, and certainly, apart from the actual art, the sculpture carries a very significant message. “The sculpture itself carries several messages, I think that visually its location gives a message of peace and tranquility as a very strong symbolism against the violence that has happened to peace-loving and vulnerable people. The sculpture has become a great visual attraction, especially among foreign visitors, in whom it arouses curiosity and a feeling of sympathy and adoration, in such a way so that today this sculpture is considered the most photographed sculpture in Kosovo” - continued Eliza. The sculpture of resistance is and will always remain a beautiful combination of the bitter truth and the heroic resistance of all the people of Kosovo.



# “403” vlerë e rokut shqiptar

Zgjedhëm Hektor Gjurgjialiun nga grupi “403”, që të risjellë tek ne copëza nga e kaluara e lavdishme rokut në Kosovë si dhe aktualitetin e vlerave në industrinë e muzikës.



**Muzika rock është filozofi në vete. Muzikat e kohës moderne (që shume i pëlqej dhe i dëgjoj) janë komplet gjë tjetër.**

INTERVISTOI: GRETA GUCI

U rikthyet në skenë me një koncert madhështor, në nëntor, çfarë ndjesie ju jep skena?

Po, u rikthyem me koncert më nëntor, falë mbështetjes së Drejtorisë për Kulturë, të Komunës së Prishtinës, për çka i jemi shume mirënjohës. Një bandë rok-u e cila nuk performon LIVE nuk mund të quhet e tillë. Grupi 403 i ka këngët të incizuara në studio me cilësi shumë të lartë, por, performimi live është çdo herë një eksperiencë unike. Publiku gjithmonë të jep një emocion, i cili të jep frymëzim për të dhënë më shumë nga vetja. Grupi 403 nuk bën muzikë në lokale, manifestime të ndryshme apo festivale. Ne bëjmë muzikë siç e thotë edhe një fjalë urbane “Rrallë e për mall”. Por, kur bëjmë muzikë performojmë vërtet live, pa playback dhe pa hile. Larg asaj që ne të jemi muzikantë perfeksionist, por kur ne jemi në skenë performojmë me shpirt dhe me shumë kënaqësi sepse e kemi publikun që na jep zemër, e gjithë kjo punë reflekton dhe te ndjekësit tanë.

Ndër grupet e para të rokut në Kosovë, si ka qenë ajo periudhë e karrierës suaj?

Fillimi ka qenë shumë ndryshe në krahasim me kohët e sotme. Në atë

## “403” remains a rock value!

We have chosen Hektor Gjurgjiali of the group “403”, to bring us songs from the glorious past of rock in Kosovo and the relevance of the values and of the music industry in general, which is happening today in our country.

↑ You returned to the stage with a big concert in November, how does the stage make you feel?

Yes, we are back with a concert on November 18, 2023, at the Klan Arena, thanks to the financial support of the Culture Department of the Municipality of Pristina, and especially of the director Arta Balaj, for which we are very grateful. A rock band that doesn't perform live cannot be defined as such. The 403 group records songs in the studio with very high quality, but performing them live is a unique experience every time. The audience always gives you an emotion, which inspires you to give more of yourself. The 403 group does not play music in bars, events, or festivals. We make music as an urban saying goes “Once in a blue moon”. But when we make music we play it live, without reproduction and gimmicks. We are far from being perfectionist musicians, but when we are on stage we perform with spirit and with great pleasure because we have an audience that gives us their hearts, all this work is reflected in our followers.

Among the first rock bands in Kosovo, what was that first period of your career like?

The beginnings were very different than today's times. At that time the technical



kohë mundësitë teknike kanë qenë shumë të limituara, sepse ishte vetëm një studio e incizimit në RTP ku një herë në 3-4 muaj ke patur në dispozicion 3 orë për të incizuar dhe finalizuar 2-3 këngë. Ka qenë situata politike në ish Jugosllavi që nuk ka dhënë asnjë mundësi të shprehjes së lirë. Por në atë kohë është bërë muzikë LIVE e jo playback apo këndim me CD në prapavijë. Por, të them të drejtën, në ato kohëra ka pasur më shumë përkrahje për performuesit live e posaçërisht ndaj grupeve rock sesa tani, pasi në ditët e sotme teknologjia si duket e ka mbytur artin, dhe nuk vlerësohet performimi LIVE, por vetëm ai vizual. Më vjen shumë mirë që sa i përket muzikës, e posaçërisht asaj rock, jam i mendimit të vjetër që do thotë se: "Nëse nuk din me bo muzike LIVE atëherë lenë kreyjt". Fundja, sot me AI mund të prodhosh çfarë të duash, por, në realitet, muzika vjen nga shpirti, duart dhe zemra e krijuesit.

### **Sipas jush, çfarë e bën një grup të mirë, në aspektin cilësor dhe trendit që sjellë në skenën muzikore?**

Mendimi im është që kuantiteti dhe kualiteti janë dy gjëra komplet ndryshe në muzikë. Në sport, më saktësisht në futboll sa më shumë gola që jep lojtari apo ekipi aq më mirë është. Ndërsa në muzikë është komplet ndryshe sepse mund të kesh 7 -8 albume që në total janë 70 - 80 këngë nga të cilat as 2 nuk i kujton askush, apo një album me 10 këngë ku të gjithë njohim 5 apo 6 këngë dhe i dëgjojnë tërë kohën. Performimi live i një grupi do të thotë që të gjithë muzikantët të jenë shumë të mirë, dhe të mos e teprojnë me performanca live, sepse ajo e degradon vlerën e muzikës. Unë këtë gjë e krahasoj me festat. Nuk ka askund që festohet dita e hënë, e martë apo e premte sepse e ke një herë në javë gjithsesi. Nuk festohet askund data 1, 2, 15, sepse e ke një herë në muaj. Pse nuk ka? Sepse bëhen monotone apo që thotë populli bohen bajat. Festa si Viti i

possibilities were very limited because in RTP there was only one recording studio where once every 3-4 months you had 3 hours available to record and finalize 2-3 songs. It was the political situation in the former Yugoslavia that did not offer any possibility of free expression. But at that time it was live music played and not sung with a CD playing in the background. But, to be honest, in those days there was more support for live artists, especially rock bands, than now, since nowadays technology seems to have stifled the art, and live performance is not appreciated, but only the visual one. I'm very happy that when it comes to music, especially rock, I'm of the old opinion which means: "If you can't play music LIVE, forget about it". After all, today with artificial intelligence you can produce whatever you want, but, in reality, music comes from the soul, hands, and heart of the creator.

Ri, dita e verës, dita e flamurit, janë festa tepër të bukura sepse janë një herë në vit dhe ato mezi i pret që të vijin. Edhe muzika live e një bande Rock-u duhet të jetë ashtu, që të mos bëhet bandë të cilën e sheh një herë në javë apo çdo muaj sepse atëherë vjen në pozitë që as publiku nuk vjen për ty, por vjen vetëm se paska muzikë live. Mund ta kem gabim, por unë dhe grupi 403 nuk bëjmë muzikë live më shumë se një, maksimum dy herë në vit.

**Ju si vokalist, por edhe grupi juaj nuk keni bërë kompromise në muzikë, cili është mendimi juaj për këtë muzikë që po zhvillohet?**

Muzika rock (baladat apo këngët më të forta/më të shpejta apo të rënda) janë art në vete. Muzika rock është filozofi në vete. Muzikat e kohës moderne (që shume i pëlqej dhe i dëgjoj) janë komplet gjë tjetër. Muzika moderne përpos këngëtarit ka një ekip të madh mbrapa, ku dikush e menaxhon artistin, tjetri e komponon muzikën, dikush tjetër e shkruan tekstin, incizohet nga muzikantë në vende të ndryshme nga profesionistët, dhe performohet live nga ndonjë bandë komplet tjetër nga kudo. Muzika moderne është makineri dhe fabrikë parash. Aty fiton menaxheri, producenti, muzikantët, këngëtarët dhe këtë gjë e respektoj dhe jam shumë dakord. Por, muzika rock e një bande është muzikë e bërë nga vet grupi dhe për atë më duket më personale dhe më e veçantë. Çdo vit dalin shumë këngë që bëhen hit i verës apo i festave të fundvitit, por harrohen shumë shpejt. Muzika e bukur dhe këngët rock sipas mendimit tim nuk harrohen dhe nuk vdesin kurrë.

**In your opinion, what makes a good band, in terms of quality and the trend they bring to the music scene?**

The point is that quantity and quality are two completely different things in music. In sports, more precisely in football, the more goals a player or team scores, the better. While in music it's completely different because you can have 7-8 albums with a total of 70-80 songs of which no one remembers even 2, or an album with 10 songs where everyone knows 5 or 6 songs and listens to them all the time. Playing a live band means that all the musicians are very good, and don't overdo the live performances, because it devalues the value of the music. I compare it to holidays. No place celebrates on Monday, Tuesday, or Friday because it is celebrated once a week anyway. The date 1, 2, and 15 is not celebrated anywhere, because it is celebrated only once a month. Why there is not? Because they become monotonous or, as they say, they become stale. Holidays like New Year, Summer Day, and Flag Day, are very nice holidays because they happen once a year and you look forward to them. Even the live music of a rock band should be like this so that it doesn't become a band that you see once a week or every month, because then you end up in a situation where the audience doesn't even come to pick you up, but only comes because there 'It's live music... I could be wrong, but the band 403 doesn't play live music more than once, at most twice a year.

**You as a singer, but also your group, have not made any compromises for the musical genre you present to the public, what is your opinion on this music that is being developed?**

Rock music (ballads or louder/faster

or heavier songs) is art in itself. Rock music is itself a philosophy. Modern music (which I like and listen to) is a completely different thing. Modern music, in addition to the singer, has a huge team behind it where someone manages the artist, someone else composes the music, someone else writes the lyrics, recorded by musicians from different countries than the professionals, and performed live by completely different bands from anywhere. Modern music is a machine and a money factory. The manager, the producer, the musicians, the singers win there, and I respect that and agree with that. But a band's rock music is music made by the band itself and for this reason, it seems more personal and special to me. Every year, many songs are released that become summer hits or Christmas hits, but they are quickly forgotten. In my opinion, beautiful music and rock songs are never forgotten and never die.

“

**Rock music is itself a philosophy. Modern music (which I like and listen to) is a completely different thing.**



# DAM Fest, pikëtakimi i artistëve

**F**estivali DAM Fest këtë vit u konceptua i ndarë në dy faza, me përgatitjet e Garës së 3-të të Kompozitorëve të Ballkanit, që sivjet shënoi edicioni e tretë dhe ka për qëllim të krijojë lidhje në mes kompozitorëve të Ballkanit dhe instrumentistë evropian, duke zgjedh çdo vit një ansambël rezident për të luajtur veprat e kompozitorëve që konkurrojnë dhe kualifikohen për finalen e Garës. Këtë vit në Prishtinë erdhi ansambli prestigjioz NEC – Nouvel Ensemble Contemporain nga Zvicra, që në finale interpretoi veprat e 4 kompozitorëve ballkanas: Christos Ntovas, Jetmir Zaganjori, Konstantinos Chaliasas dhe Ylli Daklani, i cili u shpall fitues, me veprën “Wet Dreams”. Gara është një për kompozitorët në ngritje, nga drejtuesit e festivalit Rreze Kryeziu dhe Dardan Selimaj në bashkëpunim me kompozitorin dhe dirigjentin amerikan i cili jeton në Holandë Gregory Charette dhe organizohet çdo 2 vjet si pjesë e programit të festivalit. Këtë vit edicioni i 18-të të DAM-it, ishte i rezervuar për instrumentistë virtuoz dhe nisi mbarë me dy motrat, violiniste të jashtëzakonshme, Mariame Amira Abouzahra të shoqëruara në piano nga e ëma e tyre pianistja e eminente hungareze Nora Emody. Përveç shumë pjesëmarrësve duhet veçuar edhe pjesëmarrjen e pianistes kosovare Natyra Elezi dhe DJ Daniela La Luz, performanca e së cilave bashkoi tingujt e pianos me muzikën elektronike si dhe instrumentistë e tjerë si klarinetisti eklektik Florent Charpentier, pianistja e mirënjohur kosovare Pranvera Hoxha, flautistja italiane Lusìa Sello që njëherësh është shpallur Ambasadore e Kulturës Italiane në botë dhe instrumentistët e rinj e tejet premtues nga shkolla e muzikës “Prenk Jakova” në Prishtinë që i dhanë sharmin këtij edicioni. Ndërkohë Dam Festival ka përfshirë në program këtë vit instrumentistë nga moshat e vogla 7 dhe 8 vjeç e deri tek muzikantë me eksperiencë që ushtrojnë profesionin edhe në të 60-at e tyre. Ndërkohë në fokus të këtij festivali është gjithmonë promovimi i kompozitorëve dhe instrumentistëve të rinj, e paralelisht me këtë edhe afrimi i komunikimi me publikun dhe puna e vazhdueshme për të sjellë eksperiencën të veçanta koncertale edhe për publikun e ri.



## DAM Fest, the meeting place of artists

**T**he DAM Fest festival this year was divided into two phases, with the preparations of the 3rd Competition of Balkan Composers, which this year marked the third edition. The Competition is a platform that aims to create connections between Balkan composers and European instrumentalists and each year a resident ensemble is selected to play the works of competing composers and qualify for the final of the Competition. This year, Pristina was honored with the presence of the prestigious ensemble NEC - Nouvel Ensemble Contemporain from Switzerland, which in the final performed the works of four Balkan composers: Christos Ntovas, Jetmir Zaganjori, Konstantinos Chaliasas, and Ylli Daklani, who was declared the winner, with “Wet Dreams” written for the ensemble. The competition was founded in 2019, by the festival directors Rreze Kryeziu and Dardan Selimaj in collaboration with the American composer and conductor who lives in the Netherlands Gregory Charette, and it is organized every two years as part of the festival program. The 18th edition of the DAM Festival it was an edition reserved for virtuoso instrumentalists and it was opened with the two talented sisters, exceptional violinists, Mariame and Amira Abouzahra, accompanied on the piano by their mother, the eminent Hungarian pianist Nora Emody. In addition to the numerous participants, it is worth mentioning the participation of the Kosovar pianist Natyra Elezi and the DJ Daniela La Luz, whose performance combined the sounds of the piano with electronic music, as well as other instrumentalists such as the eclectic clarinetist Florent Charpentier, the well-known Kosovar pianist Pranvera Hoxha, the Italian flutist Lusìa Sello, who at the same time was declared Ambassador of Italian Culture in the world, and the very promising young instrumentalists of the “Prenk Jakova” who gave this edition its charm. Meanwhile, Dam Festival has included in the program this year instrumentalists to experienced musicians who practice their profession even in their 60s. The focus of this festival is always the promotion of young composers and instrumentalists, and in parallel with this, the approach of communication with the public and the continuous work to bring special concert experiences for the young public as well.

# Baleti i Kosovës mes sukseseve dhe sfidave!

## Kosovo Ballet between successes and challenges

**S**inan Kajtazi vjen në këtë shkrim në cilësinë e drejtorit të Baletit të Kosovës, 20 vjet si balerin e tashmë prej 2 vitesh udhëheqës i këtij institucioni, dy anët e medaljes për ta kuptuar më mirë gjendjen e baletit të vendit tonë. "Po bëhen gati dy vite që udhëheq BKK dhe sigurisht që është nder për mua me qenë në krye të një institucioni që ndër vite ka dëshmuar seriozitet, përkushtim e rezultate të jashtëzakonshme, si në vend, po ashtu edhe në skena ndërkombëtare"- shprehet drejtori i BKK-së.

Prej vitesh ky institucion ka shpalosur shpirtin e balerinëve

tanë, ëndrrat dhe arritjet e tyre, që nën kushte të vështira kanë arritur të realizojnë shfaqje të nivelit botëror, një rrugëtim tejet sfidues për artistët tanë. "Po bëhet punë e madhe, përkundër faktit që për shkak të renovimeve, ndërtesa e Teatrit Kombëtar është mbyllur, aty ku BKK është themeluar tash e 51 vite dhe kjo sigurisht na ka sjell sfida të mëdha, mirëpo përkundër kësaj, jam tejet i kënaqur që kemi arritur të krijojmë shfaqje me bashkëpunëtorë kombëtar e ndërkombëtar. Pra, konsideroj që infrastruktura është sfida më e madhe e momentit për BKK, të cilën edhe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit po

**S**inan Kajtazi introduces himself to this article as director of the Kosovo Ballet, 20 years as a dancer and already leading this institution for 2 years, two sides of the coin to better understand the state of ballet in our country. "I have been leading the BKK for almost two years and it is certainly an honor for me to be at the helm of an institution that over the years has demonstrated seriousness, dedication, and exceptional results, both in the country and on the international scene" - says the director of BKK.

For years, this institution has revealed the spirit of our dancers, their dreams, and achievements, who under difficult conditions have managed to produce world-class performances, a very challenging journey for our artists. "A lot of work is being done, although the National Theater building, where the BKK has been based for 51 years, is closed due to renovation work, and this has certainly brought us great challenges, but despite this, I am very happy to be able to create shows with national and international collaborators. So I believe that infrastructure is the biggest challenge of the moment for BKK, which we are trying to manage also with the support of the Ministry of Culture, Youth and Sports" - confesses Sinan Kajtazi. Despite these challenges, Kosovo



FOTO: ARBEN LLAPASHTICA

mundohe mi ta menaxhojmë"- rrëfen Sinan Kajtazi.

E megjithë këto sfida Baleti i Kosovës ka pasur një vit artistik të suksesshëm, duke sjellë në skenën tonë një larmi kryeveprash botërore, por njëkohësisht duke përçuar artin tonë përtej kufijve. "Jemi në fazën e fundit të provave për shfaqjen e katërt për vitin 2023. Kemi pas një vit me suksese të konsiderueshme. Premiera e baletit "Time" me koreograf Taulant Shehu, premiera "Correr o Fado" me koreografi nga koreografi portugez i njohur evropian e botëror, Daniel Cardoso, premiera "Shtegtimi", me koreografi nga Antonio Fini, e cila është shfaq si premierë në Kalabri të Italisë, Festivali i Kërcimit në Graz dhe Salzkamergut të Austrisë, paraqitja e balerinëve tanë në Festivalin Fini Dance Award në Nju Jork të ShBA dhe shfaqja "Arrëthyysi", të cilën jemi duke e realizuar në bashkëpunimin me orkestrën e Filarmonisë së Kosovës, ku koreograf e kemi primabalerinin shqiptar Ilir Kerni. Të gjitha këto suksese mund të them lirisht se e përbëjnë një vit të jashtëzakonshëm për BKK"- thekson ai.

Në fakt sukseset për këtë institucion kanë qenë të vazhdueshme, që ka arritur të nxjerrë një gjeneratë të mrekullueshme balerinësh, të cilët i kanë dhënë shumë skenës sonë kulturore.

"Jam njëri nga balerinët e gjeneratës së parë të balerinëve të gjeneratës së re, pra të pasluftës dhe jam dëshmitar i ringritjes së BKK që nga paslufta e këtej, sigurisht fal punës vetëmohuese të profesor Ahmet Brahimaj. Më janë bërë 22 vite që jam afër baletit të Kosovës. Fakti që jam ende këtu, tregon gjithçka!"- përfundon Sinan Kajtazi.

FOTO: ARBEN LLAPASHITICA



Ballet has had a successful artistic year, bringing a variety of world masterpieces to our stage, but at the same time taking our art across borders. "We are in the final stages of rehearsals for the fourth show of 2023. We have had a remarkably successful year. The premiere of the ballet "Time" with the choreographer Taulant Shehu, the premiere of "Correr o Fado" with the choreography of the well-known Portuguese choreographer European and global Daniel Cardoso, the premiere of "Shtegtimi", with the choreography of Antonio Fini, which debuted in Italy in Calabria, at the Graz and Salzkamerg Dance Festival in Austria, the appearance of our dancers at the Fini Dance Award Festival of New York, in the United States and the show "Nutcracker", which we are performing in collaboration with

the Kosovo Philharmonic Orchestra, where the well-known Albanian choreographer Ilir Kerni (Honor of the Nation). All these successes, I can sincerely say it, they constitute an extraordinary year for the BKK" - stresses Sinan.

There have been continuous successes for this institution, which has managed to produce a wonderful generation of dancers, who have given a lot to our cultural scene.

"I am one of the dancers of the first generation of dancers of the new generation, that is, the post-war generation, and I have witnessed the rebirth of BKK since the post-war period, thanks, of course, to the selfless work of Professor Ahmet Brahimaj. I have been present for 22 years to the Kosova Ballet, the fact that I am still here proves it all!" - concludes Sinan Kajtazi.



# Trashëgimia kulturore është dhuratë për të ardhmen

# Cultural heritage is a gift for the future

NGA GRETA GUCI

**B**eteja e Kosovës për tu bërë pjesë e UNESCO-s është një përpjekje shumë e madhe dhe tejet e rëndësishme, sepse jo vetëm që promovon vlerat kulturore, por nga ana tjetër sensibilizon shoqërinë tonë.

Është e vërtetë se jo të gjithë ndjehen të lidhur me trashëgiminë e tyre kulturore ndërsa shumë të tjerë mund ta kenë këtë lidhje më të fortë. Disa mendojnë se traditat janë arkaike dhe nuk janë më relevante, të panevojshme për kohët e sotme moderne. Megjithatë për një pjesë të shoqërisë sonë trashëgimia kulturore është një segment i rëndësishëm, që duhet ruajtur. Kultura i dhuron njerëzve një lidhje me vlera të

ndryshme sociale, ideologji, besime dhe shprehi. Ajo i lejon të identifikojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet me të tjerët. Sepse ndër dekada trashëgimia kulturore na ka treguar se mund të parandalojë izolimin social dhe të na lejojë të bëhemi më të mirëkuptueshëm dhe më largpamës, duke ndikuar kështu në mënyrë pozitive edhe për zhvillimin e gjeneratave pasuese.

Në shtete më të zhvilluara, mund të jetë e lehtë që të ndihesh konfuz në mes tërë atyre kulturave dhe ndryshimeve dhe kjo është një nga arsytet që duhen kuptuar dhe mbrojtur disa tradita që kanë domethënie për secilin prej nesh, që na përfaqësojnë dhe identifikojnë në një farë mënyre.

**K**osovo's battle to join UNESCO is a very big and important effort because it not only promotes cultural values but on the other hand raises awareness in our society. Not everyone indeed feels connected to their cultural heritage, while many others may have a stronger connection.

Some think that the traditions are archaic and no longer relevant, useless for today's modern times. However, for a part of our society, cultural heritage is an important segment that must be preserved. Culture offers people a connection with different social values, ideologies, beliefs, and customs. It allows them to identify similarities and differences with others. Because over the decades cultural heritage has shown us that it can prevent social isolation and allow us to become more understanding and far-sighted, thus positively impacting the development of subsequent generations.

In more developed countries it can be easy to feel confused among all those cultures and changes, and this is one of the reasons to understand and protect some traditions that are meaningful to each of us, that in some way represent





Sepse trashëgimia kulturore është pasqyrë e identitetit tonë, është pjesë ajo e asaj që kemi qenë.

Trashëgimia kulturore përbëhet nga shumë elemente, të cilat mund t'i shohim në ndërtesa të ndryshme, vende të ndryshme, artefakte të kohëve të lashta. Kultura mund të ruhet edhe nga burime natyrore si agrokultura dhe pjesë të tjera të lidhura me këtë, të ruhet me anë të librave, artefakteve, objekteve, fotografive, pikturave, artit dhe traditave të gojëdhënave.

Trashëgimia kulturore është në ushqimin që hamë, në rrobat që veshim, në religjionin që kemi në aftësitë për të nxënë. Nganjëherë shohim dhe prekim atë që është kulturë, herë të tjera kjo nuk mund të shihet apo preket, por sërish mbetet kulturë. Gjithçka fillon me të kuptuarin e kulturës. Vetëm atëherë mund të fillojmë ta vlerësojmë atë. Nga këtu, ne mësojmë të kujdesemi për kulturën dhe eventualisht ta ndjejmë atë. Me vullnet e punë arrijmë që të duam më shumë të mësojmë dhe të kuptojmë...

**Gjithçka fillon me të kuptuarin e kulturës. Vetëm atëherë mund të fillojmë ta vlerësojmë atë. Trashëgimia kulturore parandalon izolimin social dhe na lejon të bëhemi më largpamës.**

“

**It all starts with understanding the culture. Only then can we begin to appreciate it. Cultural heritage prevents social isolation and allows us to look to the future.**

us and identify us. Since cultural heritage is a reflection of our identity, it is part of who we are. Cultural heritage consists of many elements, which we can see in different buildings, different places, and artifacts from ancient times. Culture can also be preserved by natural resources such as agriculture and other related parts, preserved through books, artifacts, objects, photographs, paintings, art, and oral traditions. Cultural heritage lies in the food we eat, the clothes we wear, the religion we follow, and the ability to learn. Sometimes we see and touch what is culture, other times we neither see nor touch it, but it is still culture.

It all starts with understanding the culture. Only then can we begin to appreciate it. From here we learn to care about culture and ultimately feel it. With willpower and work, we come to want more to learn and understand...

# Tinguj pianosh mbi Prishtinë

“Jemi shumë të lumtur të konstatojmë se edhe këtë vit festivali ynë i muzikës klasike “Chopin PianoFEST Prishtina” në edicionin e tij të 13-të, ka dëshmuar arritjen e plotë të misionit të vet të çmuar të shpalosjes së vlerave kulmore të muzikës artistike profesionale në Kosovë!

NGA ERISA SARAQI



**N**jë festë e vërtetë e pianos në Prishtinë që organizohet në Prishtinë prej 13 vitesh nga dy organizatorët Lejla Pula dhe Besa Luzha, edhe këtë vit ngriti siparin për emra të njohur botëror. “Jemi shumë të lumtur të konstatojmë se edhe këtë vit festivali ynë i muzikës klasike “Chopin PianoFEST Prishtina” në edicionin e tij të 13-të, ka dëshmuar


## Piano sounds over Prishtina!

“We are very happy to say that this year our classical music festival “Chopin PianoFEST Prishtina” in its 13th edition, witnessed the full achievement of its precious mission of spreading the highest values of professional artistic music in Kosovo!

**A** real piano festival in Prishtina, which has been organized in Prishtinë for 13 years by the two organizers Lejla Pula and Besa Luzha, this year also raised the bar for world-renowned names. “We are very happy to say that this year our classical music festival “Chopin PianoFEST Prishtina” in its 13th edition, witnessed the full achievement of its precious mission of spreading the highest values of professional artistic music in Kosovo! Always keeping present the primary and essential objective of our communication with the artistic world outside the borders of Kosovo, the only way towards integration and progress in the field of the art of musical interpretation and musical creativity, through this Festival we try to transform Prishtina into a worthy capital where concerts take place and can be heard, as in every European and world capital!” - said pianist Lejla Pula.

The latest edition brought the wonderful music of the piano quintet from Italy and the famous Italian pianist Epifanio Comis to close with the fantastic pianist Avery Gagliano. Every year, in addition to the famous Bosnian artists, Chopin PianoFest Prishtina also hosts





arritjen e plotë të misionit të vet të çmuar të shpalosjes së vlerave kulmore të muzikës artistike profesionale në Kosovë! Gjithnjë duke e pasur parasysh synimin parësor, qenësor të komunikimit tonë me botën artistike jashtë kufijve të Kosovës, rrugës së vetme drejt integritit dhe përparimit në fushën e artit të interpretimit muzikor dhe të krijimtarisë muzikore, ne përmes këtij Festivali mundohemi ta shndërrojmë Prishtinën në një kryeqytet të denje ku ndodhin dhe mund të dëgjohen koncertet si në çdo kryeqendër evropiane dhe botërore!" - u shpreh pianistja Lejla Pula. Edicioni i kaluar solli muzikën e mrekullueshme të kuintetit pianistik nga Italia dhe pianistin e famshëm italian Epifanio Comis për ta mbyllur me pianisten fantastike Avery Gagliano! Çdo vit perpos artistëve të famshëm boëror, Chopin PianoFest Prishtina ka dhe numër të madh të artistëve shqiptarë vendor, të cilët dëshmojnë në vazhdimësi nivelin e lartë të artit interpretativ në Kosovë! Gjithashtu gjatë këtij muaji pianistik, zhvillohen ligjëratat, masterklaset dhe debate profesionale, ndërsa diplomacia kulturore është një element tejet i rëndësishëm në programet e tyre. "Jemi në fazën e hartimit të programit për sezonën e ardhshme koncertale dhe të edicionit të 14 të Festivalit Chopin PianoFEST Prishtina 2024! Për një planifikim cilësor e të mirefilltë konsiderojmë se është me rëndësi të madhe që buxheti i ngjarjeve muzikore të nivelit të këtillë mundësisht të planifikohet çdo vit nga institucionet tona, pa pasur nevojë të aplikimit të vazhdueshëm, por të përfshirjes permanente në axhendën e përhershme të ngjarjeve kulturore të vendit sikur që është rasti me festivalet e mëdha"- thotë Lejla Pula, në lidhje me edicionin e ardhshëm.

a large number of local Albanian artists, who continuously demonstrate the high level of interpretive art in Kosovo. Conferences, masterclasses, and professional debates also take place during this Piano Month, while cultural diplomacy is a very important element in their programs.

"We are in the process of drawing up the program for the next concert season and the 14th edition of the Festival Chopin PianoFEST Prishtina 2024. For genuine and quality programming, we consider it of great importance that the budget for musical events of this level is preferably planned every year by our institutions, without the need for continuous application, but for permanent inclusion in the permanent agenda of the country's cultural events, as happens with large festivals", says Lejla Pula, regarding the next edition.

# Për Vivien! For Vivien!

NGA FITNETE TUDA

**K**ur Bruna më kërkoi të shkruaja për Violeta Rexhepagiqin, për një moment më kaloi në mendje si një film Violeta apo Viki, si e thirrnim ne kolegët e saj në RTK. Ishte nga ata njerëz, që të dukej se e ke njohur gjithë jetën. E njoha përmes mënyrës më të bukur të mundshme, përmes muzikës. Ende më tingëllojnë tingujt e këngës, kur ajo këndonte në Akordet e Kosovës në RTP, e mbaj mend këngën e gjinkallës, një duet me vëllain, Armendin, një këngë e bukur sa ende e këndoj refrenin "xixëllonja fqinje na është kureshtare, rri me plot mendime në dritare..." e unë e këndoja bashkë me vëllaun tim duet në shkollë. Violeta ishte një fëmijë yll, me mënyrën si këndonte e lëvizte në skenë, zërin e ëmbël, portretin e bukur dhe sytë që i shkëlqenin, ajo ishte një artiste e vogël dhe unë e adhuroja. Pas shumë vitesh, e takova për herë të parë në shkollën e muzikës në Prishtinë, ajo ishte lozonjare, çapkëne dhe plot muzikalitet kur këndonte e luante në piano dhe të bënte për vete me energjinë e saj. Kur ishte tinejxhere, më kujtohet një ditë kur e pashë afër mensës së studentëve, flokët i kishte si pank frizurë, me ngjyrë të verdhë dhe me fije ngjyrë vjollce dhe të kuqe, në këmbë kishte mbathur një patikë të bardhë dhe një të kuqe, të gjithë njerëzit e kthenin kokën pas saj, duke sikur kishte ardhur nga një kohë tjetër, ashtu avangarde si në videoklipet e saj. Ajo ishte një rebele në jetë dhe muzikë, duke sjellë një frymë të re muzikore. Të gjithë flisnin për të, për mënyrën si vishej, stilin e saj, ishte shumë moderne me prezantimin e saj edhe kur e përfaqësoi dy herë

**W**hen Bruna asked me to write an article about Violeta Rexhepagi, for a moment it passed through my mind like in a movie Violeta or Viki, as we called her at work at RTK. She was one of those people that you seem to have known all your life. I got to know her in the most beautiful way possible, through music. Even today, the sounds of the song resonate with me, from my childhood when she sang in Chords of Kosovo on RTP, I remember the cicada song, a duet with her brother Armend, it was such a beautiful song that I still sing the chorus "we are curious, I sit full of thoughts at the window..." (which won the first prize) and I sang it with my brother in a duet at school. Violeta, since then was a shining child, especially in the way she sang and moved on stage, her sweet voice, her beautiful portrait, and her sparkling eyes, she was a little artist and I adored her. After many years, I met her for the first time at the music school in Pristina, - she was playful, and full of musicality when she sang and played the piano and impressed everyone with her energy. When she was a teenager, I remember one day when I saw her at the traffic lights near the student canteen, her hair was like a bun, yellow with purple and red strands, on one foot she was wearing a white sneaker and a red in the other one, all

**Violeta ishte një fëmijë yll, me mënyrën si këndonte e lëvizte në skenë, zërin e ëmbël, portretin e bukur dhe sytë që i shkëlqenin, ajo ishte një artiste e vogël dhe unë e adhuroja.**

**Violeta, since then was a shining child, especially in the way she sang and moved on stage, her sweet voice, her beautiful portrait, and her sparkling eyes, she was a little artist and I adored her.**



the people turned their heads looking at her, she looked like she came from another time, so avant-garde she looked in her music videos. She was a rebel in life and in music, she brought a new musical spirit. Everyone talked about her, about the way she dressed, for her style. She was very modern with her music and presentation, especially when she represented Kosovo twice at the Eurovision Song Contest in the former Yugoslavia, where all public televisions competed with the republics, while she made us proud when she presented Kosovo twice through RTP. In 1984, she was introduced to the group Vivien, which became her stage name (as a singer), inspired by the actress Vivien Li and the movie "Gone with the Wind", she adored her movie. Violeta worked at RTP as a culture journalist until 1990



Kosovën në Festivalin e përzgjedhjes së këngës së Eurovizionit në ish Jugosllavi, duke na bërë krenarë me prezantimin e Kosovës, dy herë, përmes RTP-së. Në vitin 1984, u prezantua me grupin Vivien, që ishte edhe emri artistik (si kantautore), e frymëzuar nga aktorja Vivien Li dhe filmi "Gone with the wind". Violeta punoi në RTP si gazetare e kulturës deri në vitin 1990 kur ky medium u mbyll me dhunë nga forcat serbe. Në vitin 1996 publikoi albumin e saj me 9 këngë, hite, si "Zhurme e ëndrrave të dikurshme", "Romantika", "Fjollat" etj, që janë margaritarë të muzikës moderne shqiptare. Nuk ishte koha të merresh me muzikë, kishte deklaruar më vonë Violeta. Po vinin erërat e luftës dhe nga një këngëtare e muzikës pop-rok ajo u shndërrua në një reportere e luftës nga Kroacia, e Bosnja duke punuar për mediat angleze. Ajo raportoi edhe nga Lindja e mesme, lufta në Irak. Nuk e di se si e ka përballuar këtë situatë shpirti i brishtë i një artisteje. Pas kthimit

në Kosovë, përjetoi një aksident të rëndë komunikacioni, i ishte dashur rreth 3 vjet që ta merrte veten. Për mua është gëzim kur zgjohem dhe e di se jam e lirë kishte thënë në një intervistë Violeta, pas çlirimit të Kosovës. Por vitet e pasluftës në Kosovë, sollën një krizë të vlerave në art e kulturë dhe artistët si Vivien u bënë të padukshëm dhe ishin harruar. Nga viti 2010 deri në vitin 2020 Viki punoi në RTK. Ishte fillimi i pandemisë dhe kishte filluar karantina, u takuam në punë dhe qeshëm më zë, ajo gjithmonë e kishte sensin e humorit edhe në situata të vështira. Ishte takimi i fundit, si në këngën e saj.

Sa herë të kam thënë, se do të vijë dita,  
Kur duart do të ngrihen në qiell  
Pa lamtumirë ika...  
Por kënga dhe muzika e kanë magjinë e saj, Vivien nuk e mori zërin e saj në botën e amshimit, e la për ne si kujtimin më të bukur!

when this medium was violently shut down by Serbian forces. In 1996, she published her album with 9 songs. The hit songs: "The Noise of Former Dreams", "Romantica", "Fjollat", etc, are some pearls of modern Albanian music. "It was not the time to deal with music!" Violeta declared later. The winds of war were coming and from a pop-rock singer, she turned into a war reporter from Croatia and Bosnia working for the English media. She also reported from the Middle East, the war in Iraq. I don't know how the fragile soul of an artist coped with this situation. After her return to Kosovo, she experienced a serious traffic accident and as the doctors said, they were surprised how she survived, it took her about 3 years to recover. She had spent the war period in Kosovo. For me, it is an immense joy when I wake up and know that I am free... -Violeta had said in an interview, after the liberation of Kosovo. But the post-war years in Kosovo brought a crisis of values in art and culture and artists like Vivien became invisible and were forgotten. From 2010 to 2020 Viki worked at RTK. It was the beginning of the pandemic and the quarantine had begun. We met at work and laughed out loud, she always had a sense of humor even in difficult situations. It was the last meeting, as in her song.

How many times have I told you, that the day will come,  
When the hands will be raised to the sky  
I left without a goodbye...  
But song and music have their magic, Vivien did not take her voice to the world of eternity, she left it for us as the most beautiful memory.

**Nga viti 2010 deri në vitin 2020 Viki punoi në RTK. Ishte fillimi i pandemisë dhe kishte filluar karantina, u takuam në punë dhe qeshëm më zë, ajo gjithmonë e kishte sensin e humorit edhe në situata të vështira. Ishte takimi i fundit, si në këngën e saj.**



**From 2010 to 2020 Viki worked at RTK. It was the beginning of the pandemic and the quarantine had begun. We met at work and laughed out loud, she always had a sense of humor even in difficult situations. It was the last meeting, as in her song.**



# Bukuroshja e Prishtinës!

Ne u rritëm me to, mendërisht e fizikisht, përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sociale, arsimore dhe sportive.



NGA GËZIM KASTRATI  
ARKITEKT

**D**ekada më parë Pallati i Rinisë dhe Sporteve si dhe Biblioteka Kombëtare u ndërtuan në Prishtinë. E lidhur me periudhën e rritjes së gjeneratës sime nga fillimi i viteve '80 e deri në fund të viteve '90 (shek. XX), këta dy gjigantë të arkitekturës shënuan jetën tonë. Se kam fjalën në nivel social apo brezash si shenja të një identiteti të mbytur në gjak apo një prishje në tranzicionin që pasoi, jo, e kam fjalën për atë shumë më personale, një ndjenjë që jam i sigurt e ndajmë me mijëra njerëz, që në një mënyrë ose në një tjetër janë rritur dhe kaluan nëpër këto institucione. Fëmijëria si e tillë mbart gjithmonë një dozë nostalgjie dhe me peshë të veçantë kur është në vendlindje. Ne u rritëm me to, mendërisht e fizikisht, përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sociale, arsimore dhe sportive. Rrëshqisim në sallat e sporteve, hapësirat e panairove dhe vërshonim sallat e koncerteve, bibliotekën, qendrën e Pionierëve apo amfiteatrin duke menduar për një të ardhme të ndritur. Kur ne ishim duke u rritur këto dy objekte hodhën kudo kujtime delikate të pranisë së këtyre dy gjigantëve shoqërorë. Këto entitete të mëdha thjesht kanë qenë gjithmonë aty, që nga agimi i kohës. Objekti i Bibliotekës kombëtare është natyrisht, një kujtim i pafundësisë, lirisë pa kufij të horizontit shkencor. Objekti i qendrës sportive, rekreative, tregtare dhe afariste "Boro-Ramizi" në Prishtinë konsiderohej si objekti më i bukur në qytet. Qendra me sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 50 mijë m<sup>2</sup>, e ndërtuar nga kontributet e qytetarëve të

## "The Beauty of Prishtina!"

We grew mentally and physically with the Palace of Youth and Sports and near the National Library facility through various cultural, social, educational, educational, and sporting activities.

**D**ecades ago, the Palace of Youth and Sports and the National Library were built in Pristina. Associated with the period of my growth and generation from the early 80s to the late 90s (20th century), these two giants of Architecture have marked our lives. I don't mean socially or generationally as signs of a blood-soaked identity or breakdown of the transition that followed, no, I mean the very personal one, a feeling that I'm sure we share with thousands of people who in one way or another with others have grown up and passed through these institutions. Childhood as such always brings with it a dose of nostalgia and a particular weight when it is in the homeland. We grew mentally and physically with the Palace of Youth and Sports and near the National Library facility through various cultural, social, educational, educational, and sporting activities. We glided through sports arenas, and fairgrounds and rushed into concert halls, the library, the Pioneer Center, or the amphitheater thinking of a bright future. When we were young, these two objects reminded us everywhere of the presence of these two social giants. Books, photographs, files, calendars... symbols scattered randomly in our daily lives. These great entities have simply always existed, since the dawn of time. The object of the National Library is, of course, a memory of the infinite, of limitless freedom scientific horizons. The facility of the sports, recreation, commercial, and business center "Boro- Ramizi" in Pristina was considered the most beautiful facility in the city. The center with a usable area of 50,000 square meters, built



FOTO ILIRIA NEZIRI

of this school. The association and its members with their values have greatly influenced the birth of cultural and artistic institutions such as the creation of the Academy of Fine Arts in 1973 and the Art Gallery in 1979. Among the young talents and enthusiasts of this school, the most known were: Muslim Mulliqi, Gjeloš Gjokaj, Tahir Emra, Agim Çavdarbasha, Rexhep Ferri, Xhevdet Xhafa, Agush Beqiri, Nusret Salihamixhiqi, Engjëll Berisha, Hamdi Bardhi, Shyqri Nimani, Nebih Muriqi, etc.

The new generations were then added to the above generation. More and more often, artists reflect with their personal and collective exhibitions on the cultural and social opinion of the country, and some, even in individual forms, find abroad the possibility of creating and developing a creative personality, leaving traces, even in the current of international contemporary art. Agim Çavdarbasha was one of the first figures of Kosovan sculpture, who left his mark in the history of visual arts of this century.

The creativity of the sculptor Çavdarbasha finds its support in the treatment of marble and wood frozen in bronze, where sculpture appears as plastic art, "matter" where light-shadow, contrasts, volumes, textures, the finesse of the manipulation of materials appear as tangible structures.

Instinct, the aesthetic force that guides Agim Çavdarbasha, was disciplined in his uncompromising respect for the qualities of the sculptural materials and the refined techniques with which he worked. In it, we can admire the compositional idea of two figures fused in a large concentric ellipse, in the leitmotif of light. His work somehow suggests an ancient power with things he dealt with intensely with great sensitivity, but anonymously. The spheres with figures, similar and different, but never the same, intersect between the large volumes of the sculpture and more clearly testify to its creative individuality. In them, we can admire the compositional idea of the sphere with figures projected in large concentric ellipses, in the leitmotif of light. For a heavy sculptural form with a spatial quality, it adds dimensions of expression to the contemporary painting.

Agim Çavdarbasha was selected to be exhibited, together with "Women of Lybenic" and "Women of Pristina", in the 14th edition (2017) of the great Dokumenta Biennale, one of the most authoritative presentations of contemporary art today in Kasel, Germany.

Some of Agim Çavdarbasha's monumental works are: Pietà, Family, Table, Spheres, Kosovo or Mother, Embrace, Birds, Cages, etc.



# Zëri i një gruaje!

## A woman's voice!



**K**a rrugë që janë shtruar me shumë vështirësi dhe sfida, udhëhequr nga guximi dhe dëshira për pavarësi. Për këtë iu detyrohemi shumë burra e gra që para nesh kanë hapur perspektiva të reja, lirie personale. Për ne gazetarët e kulturës, ka plot shembuj të tillë, në këtë numër sjellim një ndër gazetaret e para të Kosovës, Nafije Berisha- Latifi.

Portreti i të cilës është shumë dimensional! Një rrugëtimi i gjatë, të cilin e kanë shenjuar ngjarje dhe personalitete. Nafije Berisha-Latifi, studimet për Gjuhë e Letërsi Shqipe i kreu në Fakultetin Filologjik në Prishtinë. Në vitin e parë të studimeve filloi punën si gazetare në revistën studentore "Bota e Re", dhe pas një viti kaloi gazetare e pastaj redaktore në revistën e vetme për të rinjtë "Zëri i rinisë". Nga viti 1976-2006 punoi redaktore në revistën për femra dhe familje "Kosovarja", me ndërprerje derisa ishte sekretare e Konferencës për Aktivitet Shoqëror të Grave të Kosovës (1986- 1989) dhe redaktore në "Shkëndija", revistë për arsim dhe kulturë (1989 - 1992). Me shkrimet si gazetare, nxiti shkollimin dhe punësimin e të rinjve, sidomos të vajzave të viseve rurale dhe përkrahu angazhimin e gruas në jetën shoqërore e politike duke afirmuar vlerat e mirëfillta të tyre në Kosovë, jo vetëm si përkatësi gjinore.

Është një ndër margaritarët e një gazetarie të mirëfilltë shqiptare, e cila nuk bëri kompromis me të vërtetën që duhej përçuar te publiku.

**S**ometimes roads are paved with many difficulties and challenges, driven by courage and the desire for independence. For this, we owe it to many men and women who have opened up new perspectives and personal freedom for us. As cultural journalists, there are many such examples, in this issue we bring one of the first female journalists from Kosovo, Nafije Berisha-Latifi, whose portrait is very dimensional! It is a long journey, marked by events and personalities.

Nafije Berisha-Latifi studied Albanian Language and Literature at the Faculty of Philology in Prishtina. In her first year of studies, she starts working as a journalist in the student magazine "Bota e Re", and after a year she becomes a journalist and then editor in the only youth magazine "Voice of Youth". From 1976 to 2006 she worked as an editor in the women's and family magazine "Kosovarja", intermittently until she was secretary of the Conference for Women's Social Activity of Kosovo (1986-1989) and editor in "Shkëndija", a magazine for culture and education (1989 - 1992). With her writings as a journalist, she promoted the education and employment of young people, especially girls from rural areas, and supported the commitment of women in social and political life by affirming their real values in Kosovo, not only as a gender issue.

In 2000-2004, Mrs. Berisha-Latifi published the magazine for young people called "Reze", which helped a significant number of young journalists to move forward in their profession.

It is one of the pearls of true Albanian journalism, which did not compromise with the truth that had to be conveyed to the public. 40 whole years of journalism, a golden



Në vitet 2000 -2004, botoi revistën për të rinj "Rreze", e cila i ndihmoi një numri të konsiderueshëm të bashkëpunëtorëve të rinj që ti bëjnë hapat e parë në gazetari.

Është një ndër margaritarët e një gazetarie të mirëfilltë shqiptare, e cila nuk bëri kompromis me të vërtetën që duhej përçuar te publiku. Plot 40 vite në gazetari, periudhë e artë, në të cilën intervistoi dhe rrëfeu me qindra personalitete dhe ngjarje. E megjithatë nuk përfundon thjeshtë në pension një grua me një personalitet të tillë. Shkëputja nga gazetaria erdhi për arsye shëndetësore, të cilat më vonë do t'i

kthente në lajmotiv të jetës së saj.

Nafije Latifi është e para grua në Kosovë që hapi tema tabu siç ishte kanceri i gjirit. Një tjetër mision jete, shumë fisnik dhe dinjitoz, si jeta dhe personaliteti i saj. Prej 18 vitesh i është dedikuar informimit dhe sensibilizimit të shoqërisë për diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit. Kudo nëpër Kosovë, me vullnet të hekurt dhe vizion të qartë për ta kthyer këtë çështje në qendër të vëmendjes shoqërore dhe institucionale. Ia ka arritur! Si gjithmonë! Është simbol i guximit, forcës dhe shpresës për qindra e mijëra gra! Sepse gratë e forta janë të tilla gjithë jetën e tyre!

It is one of the pearls of true Albanian journalism, which did not compromise with the truth that had to be conveyed to the public.

period, in which she interviewed and reported on hundreds of characters and events and yet a woman with such a personality does not simply retire. The separation from journalism occurred for health issues, which would later become the reason for her life.

Nafije Berisha- Latifi is the first woman in Kosovo to speak up about taboo topics such as breast cancer. Another life mission, very noble and dignified, like her life and personality. For 18 years, she has been dedicated to inform and raise the society awareness about the early diagnosis of breast cancer. Everywhere in Kosovo, with a strong will and clear vision to turn this important issue into the center of social and institutional attention. And as always, he has succeeded! She is a symbol of courage, strength and hope for hundreds and thousands of women! Because strong women are like that all their life!





# ReMusica, skena e artit muzikor

## ReMusica, the music art scene

**R**emusica në edicionin e saj të 22, erdhi këtë vit me moton "INHALE • EXHALE", me mesazhin për rëndësinë e shëndetit, si moment reflektimi dhe ndërgjegjësimi për shëndetin dhe mirëqenien mendore. ReMusica solli një program të gjerë, koncertet me artistët më të çmuar të skenave botërore dhe vendore; diskutime; instilacionet konceptuale/tingullore; masterklase, punëtori me gjeneratat e reja; ReMusica Junior - programin për fëmijë e deri tek performansat unike ku muzika takoi meditimin. Me mbi 200 pjesëmarrës dhe me 10 premiera botërore, iu kushtua në veçanti repertorit për instrumente me frymë, duke vënë theks në formacionet frymore dhe ansamblet vokale. "20 ditë me eksperiencën të pasura muzikore, me një program duke filluar nga kryeveprat e muzikës klasike deri te performancat e reja inovative, me artistët më të çmuar të skenave botërore dhe vendore, nga brezat e vjetër e deri tek gjenerata e reja, seminare, masterklasa, instilacione erdhi me një edicion jashtëzakonisht të pasur dhe ambicioz. Në kuadër të tij, u paraqit Ansambli vokal i festivalit ReMusica i themeluar këtë vit nga ReMusica me solistët më të shquar të skenës vendore dhe dirigjent Rafet

**R**emusica, now in its 22nd edition, presented itself this year with the motto "INHALE • EXHALE", with the message on the importance of health, as a moment of reflection and awareness for mental health and well-being. The ReMusica program offered a vast programme, concerts with the most popular artists in the world and on the local scene; discussions; conceptual/sound installations; masterclasses, workshops with the new generations; ReMusica Junior – the program for children; acousmatic and electroacoustic concerts for unique shows where music meets meditation. With over 200 participants from Kosovo and all over Europe and with 10 world premieres, it was dedicated in particular to the repertoire for wind instruments, emphasizing wind formations and vocal ensembles. "20 days of rich musical experiences, with a program that ranges from classical music masterpieces to new innovative performances, with the most precious artists in the world and on the local scene, from the old generations to the new generation, workshops, masterclass, the installations have arrived with an extremely rich and ambitious edition. Within this context, the vocal ensemble of the

ReMusica solli një program të gjerë, koncertet me artistët më të çmuar të skenave botërore dhe vendore

The ReMusica program offered a vast programme, concerts with the most popular artists in the world and on the local scene; discussions

ReMusica festival founded this year by ReMusica performed with the most important soloists of the local scene and the conductor Rafet Rudi, the Calefax wind ensemble, considered one of the most important wind ensembles on the European scene, the Belgian pianist Julien Libeer who brought the collection of Bach's Preludes and Fugues and many other activities and concerts, including local ensembles and artists who have always had space on the ReMusica stage. The 22nd edition concluded with the masterful concert show with the EUYO - The European Union Youth Orchestra and the soloist Daniel Roëland", stated the director of ReMusica, Donika Rudi. It should be noted that the ReMusica festival over the years has worked to extend the quality program with activities of various natures. ReMusica's program consists of very important pillars: starting from modern international repertoire and trends of the 20th century to Kosovar creativity - especially the promotion and stimulation of young local authors (composers). Through many activities, ReMusica has managed to offer a musical life, with a unique program that includes pieces from different stylistic eras. The interaction between ReMusica and its



Rudi, ansambli frymor Calefax, si një nga ansamblet me të shquara të frymës në skenën europiane, pianistin belg Julien Libeer i cili solli përmbledhjen e Preludimeve dhe Fugave të Bahut dhe shume aktivite te koncerte të tjera, përfshirë ansamblet dhe artistët vendor që gjithmonë kanë pasur hapësirën në skenën e ReMusicas. Edicionit të 22-të u përbyll me spektaklin mjeshhtëror koncertal me EUYO - The European Union Youth Orchestra dhe solist Daniel Rowland." - u shprehë drejtoresha e ReMusica-s, Donika Rudi. Duke theksuar se festivali ReMusica ndër vite punon në shtrirjen e programit kualitativ me aktivite te natyrave të ndryshme, si repertori modern ndërkombëtar dhe tendencave të shekullit XX e deri tek krijimtaria kosovare - në veçanti promovimi dhe stimulimi i autorëve (kompozitorëve) të rinj vendorë. Nëpërmjet shumë aktiviteve, ReMusica ka arritur të ofrojë një jetë muzikore, me një program unik, që përfshin pjesë të epokave të ndryshme stilistike. Ndërveprimi midis ReMusica dhe publikut të saj ka ndihmuar në realizimin e nevojës për zgjerimin e fokusit te saj, duke rezultuar në pasurimin e fizionomisë së Festivalit duke prezantuar muzikën e epokave

të tjera stilistike, si Renesansë, Barok, Klasicizmi etj. "Sot ky mision është më prezent se kurrë, si rezultat i zgjerimit të aktiviteve të festivalit në fusha që lidhen me jetën kulturore, si promovimi i artistëve vendas, kompozitorëve dhe interpretëve, ngritja e kapaciteteve artistike, edukimi muzikor, inovacioni muzikor, ndërgjegjësimi për muzikën, e kështu me radhë. Poashtu, Festivali ka një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e artistëve dhe kulturës kosovare posaçërisht te krijuesve shqiptarë përmes bashkëpunimit shumë të ngushtë dhe me artistë të shquar ndërkombëtarë." - thotë znj. Rudi. ReMusica punon në ngritjen e kapaciteteve

Festivali ReMusica njihet nga European Festivals Association - EFA si një festival kualitativ dhe shquar i arteve në Evropë me etiketë "Remarkable Arts Festival" etiketë kjo, e dhënë nga EFA që nga viti 2019 në kuadër të EFFE. Edicioni i ardhshëm do të vijë edhe më i pasur në kuptimin programor, por dhe me disa ndryshime në fizionominë e saj, gjithmonë duke e ruajtur traditën 22 vjeçare dhe rëndësinë që ajo gjithmonë ka patur për vendin tonë.

audience has helped to realize the need to expand its focus, resulting in the enrichment of the Festival's physiognomy by presenting the music of other stylistic eras, such as Renaissance, Baroque, Classicism, etc. "Today, this mission is more present than ever, as a result of the expansion of the festival's activities in areas related to cultural life, such as the promotion of local artists, composers, and performers, the development of artistic capacities, musical education, musical innovation, awareness of music, and so on. In addition, the Festival has a very important role in the promotion of Kosovar artists and culture, especially Albanian creators through very close cooperation with prominent international artists," says Mrs. Rudi.

The ReMusica Festival is recognized by the European Festivals Association - EFA as a qualitative and outstanding arts festival in Europe with the "Remarkable Arts Festival" label, given by the EFA since 2019 within the framework of EFFE. The next edition will be even richer in terms of programming, but also with some changes in its physiognomy, always preserving the 22-year tradition and the importance it has always had for our country.



# Portreti i një aktoreje

Skalitet thellë në kujtesën e artdashësve fytyra e saj në filma dhe shfaqje teatrore, Rebeka Qena vjen në këtë intervistë me të gjitha ndjesitë e një artisteje. Për kinemanë, teatrin, muzikën, rolet në karrierën e saj.

INTERVISTOI:  
**DANIELA CANA**

FOTO:  
**NORIK UKA**

FLOKËT:  
**AGON ISMAJLI**

GRIMI:  
**SELLMA**



## A mund të na flisni pak për rrugëtimin tuaj artistik?

Rrugëtimi im në botën artistike është i pazakontë, ndoshta aq sa unë vetë jam e çuditshme. Një rrugë e mbushur me sfida, befasi dhe shpesh herë, heshtje. Zakonisht krijimi im artistik ndodh në mënyrë spontane, duke shfaqur një lloj magjie jashtë vetës sime. Për një kohë të gjatë, kam qenë larg nga aktiviteti i rregullt artistik për shkak të përgjegjësisë të tjera që më marrin kohën, ose edhe për shkak të mangësisë së vullnetit për të gjetur kohë për këtë pasion të sinqertë. Megjithatë, në këtë rrugëtim,

# The Portrait of an Actress

Her face is deeply etched in the memory of art lovers in films and theater performances, Rebeka Qena comes to this interview with all the feelings of an artist. About the cinema, theater, music, the roles that have influenced her career, she reveals them all very elegantly in Prishtina Culture.

## Can you tell us a little about your artistic journey?

My journey in the artistic world is an unusual one, perhaps as unusual as I am myself. It is a road full of challenges, surprises, and often silence. Often my artistic creation happens spontaneously, manifesting some kind of magic outside of myself. For a long time, I have been away from regular artistic activity due to other responsibilities that take up my time (like a regular job with a busy schedule), or even because of the unwillingness to find time for this passion honest. However, in this journey, I have managed to create a kind of harmony with myself, accepting that the departure from artistic creation is not a sign of the loss of the creative spirit. In fact, it is a moment of reflection and contemplation about the future which I am happy to say - is happening. The beauty of this is that during this journey, I have found a unique friendship with whom I share the same passion and values. This has been the fruit of a deep understanding of my need for help and support of my creative path.

## Which role or character is firmly etched in your artistic memory?

There are some roles that have left a deep mark on me. Now I'm playing Hava in "Stiffler" (text by Doruntina Basha; direction by Kushtrim Koliqi), and I find it special because I feel

kam arritur të krijoj një lloj harmonie me veten time, duke pranuar se largimi nga krijimi artistik nuk është një shenjë e humbjes së shpirtit krijues. Në fakt, është një moment reflektimi dhe përsiatjeje për të ardhmen gjë që jam e lumtur të them – po ndodh. E bukura e kësaj është që gjatë kësaj udhëtimi, kam gjetur miqësi dhe bashkëpunim me të tjerë që ndajnë pasionin dhe vlerat e njëjta. Kjo ka qenë fryt i një kuptimi të thellë të nevojës sime për ndihmë dhe mbështetje në këtë rrugë të krijimtarisë sime.

### **Cilin rol apo personazh është skalitur fort në kujtesën tuaj artistike?**

Ka disa role që kanë lënë një shenjë thellë në mua. Tani po luaj Havën në "Stiffler", teksti nga Doruntina Basha, regjia Kushtrim Koliqi, dhe e kam të veçantë sepse e ndiej se përjetoj dhimbje reale sa herë e mendoj e sa herë e luaj në skenë. Po qe se nuk më dhëmbin përjetimet e saj më duket se gënjej dhe e tradhtoj atë grua që është reale në kokën time. Një figurë e vuajtjes, e tragjedisë vetjake. Është një viktimitë e rrethanave në të cilat është rritur, por në të njëjtën kohë një grua që nuk akuzon apo kërkon fajtorë për fatin e saj. Ajo është një heroinë para dallgëve të jetës, si gratë heroike shqiptare. Një rol tjetër që nuk do të harroj është ai i Mias në dramën e Ivor Martinic, "Djali im vetëm ecën pak më ngadalë" në regji të Iliriana Arifit. Ajo karakterizohet nga kompleksiteti dhe normaliteti të cilin e jeton e pas të cilit fshihen shumë sfida jetësore. Dhimbja e thellë që ajo përjeton për humbjen e aftësisë së djalit për të ecur, humori i errët që përshkon dramën, dhe veçanërisht përballja në skena me nënën time, Igballe Qena e bëjnë këtë përvojë të paharrueshme. Të ndash skenën me nënën ka ndikuar në një lloj rishikimi të marrëdhënieve tona,

that I experience real pain every time I think about it and every time I play it on stage. If her experiences do not hurt me, it seems to me that I am lying and betraying that woman who is real in my head. She is a figure of suffering, of personal tragedy. She is a victim of the circumstances in which she grew up, but at the same time a woman who does not blame or blame her fate. She is a heroine before the waves of life, like heroic Albanian women. Another role I will never forget is that of Mia in Ivor Martinic's drama, "My son just walks a little slower" directed by Iliriana Arifi. It is characterized by the complexity and normality which it is lived behind which many life challenges are hidden. The deep pain she experiences at the loss of her son's ability to walk, the dark humor that permeates the drama, and especially the confrontation in the scenes with my mother, Igballe Qena make this an unforgettable experience. Sharing the stage with my mother has influenced a kind of review of our relationship, it has enabled me to know her better, as an actress and as a person. Learning and being inspired by her performance in this show has been a very valuable experience.

### **What do you think about the development of Albanian cinema in general?**

A drastic change has taken place in Albanian cinema and is continuing to take place. The beauty has happened to see a more concrete and sincere communication in the film, featured by originality, and courage in the artistic expression. Certainly, many roles were beautifully and convincingly performed but unfortunately, there was little financial support. However, the time has come for young creators who are not ashamed to say what they believe and feel, and this undoubtedly encourages others, whether colleagues or the audience, to stay true to themselves and their ideas.

### **What are your current projects in cinema?**

There is something in post-production, there is something that is being fought, there is a commitment to the series... there is also the play that is still in the Theater repertoire. The last period has been quite active, I was also engaged in the development of a campaign, and then I contributed to the realization of a documentary film. Well, these activities really match my nature, to be involved in things, or rather to say, in many things that require a mental, creative commitment, some of which give tangible results faster and some are more long-term projects, of which the results are seen later. In general, for me, the golden word is "process". I love the process because, for such a thing to happen, many elements need to be combined. The outcome is not always in control or predictable. Therefore, it officially opened the season of many processes.

### **Between music and cinema, can you describe how the art of music influenced your artistic personality?**

Përmes muzikës e kam njohur





ka mundësuar te njoh më mirë, si aktore dhe si njeri. Të mësoh dhe të frymëzohesh nga performanca e saj në këtë shfaqje ka qenë një përvojë shumë e çmuar.

### **Çfarë mendimi keni për zhvillimin e kinemasë shqiptare në përgjithësi?**

Një zhvillim i hovshëm ka ndodhë në kinemanë shqiptare dhe po vazhdon të ndodhë. Ka ndodhë bukuria që të shohim një komunikim më konkret e më të sinqertë në film, origjinalitet dhe guxim në shprehje artistike. Patjetër, shumë role të realizuara bukur dhe bindshëm por fatkeqësisht pak mbështetje financiare. Megjithatë, ka ardhur koha e krijuesve të rinj që nuk turpërohen të thonë atë që besojnë dhe ndiejnë dhe kjo padyshim se i nxit edhe të tjerët, qoftë kolegët, qoftë edhe vet audiencën, ti qëndrojnë besnik vetes dhe ideve të tyre.

### **Cilat janë projektet tuaja aktuale në kinema?**

Ka diçka në post produksion, ka diçka që po zihet, ka angazhim në serial...e ka edhe shfaqje që ende është ne repertori Teatri. Periudha e fundme ka qenë aktive, kam qenë e angazhuar dhe në zhvillim të një fushate, pastaj kam kontribuar edhe në realizim të një filmi dokumentar. Eh, këso aktivitete realisht përputhen dhe me natyrën time, të jem e përfshirë në gjëra, ose më mirë thënë, në shumë gjëra që kërkojnë një angazhim mental, krijues prej të cilave disa japin rezultate të prekshme më shpejt e disa janë projekte më afatgjata, të cilave ua sheh rezultatin më vonë. Përgjithësisht, për mua fjala e artë është procesi. E dua procesin se për të ndodhë procesi duhen shumë elemente me u kombinuar. Rezultati jo gjithmonë është në kontroll apo i

parashikueshëm. Prandaj, zyrtarisht e hapi sezonin e shumë proceseve.

### **Mes muzikës dhe kinemasë, mund të na përshkruani si ndikoi arti i muzikës në personalitetin tuaj artistik?**

Muzika të nxit kreativitetin, të jep krahë e t'i këputë ato. Muzika është nevojë në jetën e secilit njeri. Nevoja për me kriju e për me u shprehë është e pandashme prej qenies njerëzore. Si të gjithë të tjerët, sigurisht edhe unë jam formësuar nga llojet e ndryshme të muzikës. Ekspozimi në melodi e këngë të ndryshme, qysh si fëmijë, besoj se më ka zhvilluar imagjinatën. Përmes muzikës e kam njohur botën pa u largu asnjë hap prej dhomës sime. Më ka zhvilluar empatinë, kam qajt e ende qaj me ndonjë këngë. Dhe e bukura e muzikës është se ndonjëherë emocionet që ngjallë janë kolektive, një muzikë e caktuar të kujton ty ashtu si edhe të tjerët në të njëjtën gjë. E ndonjëherë ajo këngë, ajo melodi di të jetë lidhje mistike vetëm e jotja personale, me dikë tjetër ose më vet universin. Muzika ka shënuar periudhat më të vështira e më të bukura të jetës sime. Kohën e para – luftës, luftës, jetën time jashtë Kosove. Dhe transportuesi më i lehtë e më lirë patjetër se është muzika. Muzika më ka bërë njeri më të mire, shpresoj të më ketë bërë artiste më të mirë.

“

**Muzika të nxit kreativitetin, të jep krahë e t'i këputë ato. Muzika është nevojë në jetën e secilit njeri.**

botën pa ulargu asnjë hap prej dhomës sime. Më ka zhvilluar empatinë, kam qajt e ende qajme ndonjë këngë. Dhe e bukura e muzikës është se ndonjëherë emocionet qëngjallë janë kolektive, një muzikë e caktuar të kujton ty ashtu si edhe të tjerët në të njëjtën gjë. E ndonjëherë ajo këngë, ajo melodi di të jetë lidhje mistike vetëm e jotja personale, me dikë tjetër ose më vet universin. Muzika ka shënuar periudhat më të vështira e më të bukura të jetës sime. Kohën e para – luftës, luftës, jetën time jashtë Kosove. Dhe transportuesi më i lehtë e më lirë patjetër se është muzika. Muzika më ka bërë njeri më të mire, shpresoj të më ketë bërë artiste më të mirë. Music stimulates creativity, gives you wings and breaks them. Music is a necessity in everyone's life. The need to create and express oneself is inseparable from the human being. Like everyone else, of course I have been shaped by different types of music. Being exposed to different melodies and songs, since I was a child, has strongly developed and shaped my imagination. Through music I got to know the world without leaving my room. It developed and stimulated my empathy, I cried and still cry with any song in particular. And the beauty of music is that sometimes the emotions it evokes are collective, a certain music reminds you as well as others of the same thing. And sometimes that song, that melody can be a mystical connection only in your own, with someone else or with the universe itself. Music has marked the most difficult and beautiful periods of my life, the time before the war, during the war, and my life outside Kosovo. The easiest and cheapest transporter is definitely music. Music has made me a better person, I hope it has made me a better artist.

# Rrëfime nga BPB

# Stories from BPB

SHKRUAN: ARLENA KRIVENJEVA



**J**o rrallë herë si person kontakti për marrëdhëniet publike të Bankës, instinktivisht më pyesin për hierarkinë e institucionit me pyetjen “Kush është drejtori?”.

Kjo pyetje me përcaktim gjinor, ka një përgjigje po me përcaktim të njëjtë,

shkurtimisht, “Drejtoresha po mendon”. Në disa gjuhë të botës, pozitat nuk kanë gjini dhe besoj që në kultura të tilla, paragjykimet për rolin e gjinive nuk shpërfaqen gjithmonë kaq drejtpërdrejtë si në shqip, ndonëse jam e vetëdijshme që janë të rralla shoqëritë kur një titull udhëheqës nuk aludon gjininë mashkullore. Në këtë sfond, nuk do të duhej as të kisha disponimin të shkruaja këtë rrëfim, si një e re ambicioze që e shikoj veten me të gjithë titujt që familja dhe profesioni i jep një vajze. Por, puna dhe rrëfimet e kolegeve të mia, Mimozës, Argjirës dhe Gresës, më japin shembull që ekuilibri punë-familje-shoqëri, e jo vetëm, është i mundur por edhe çelës suksesi që institucioni ku punoj BPB dhe secili prej nesh që kontribuojmë aty e gëzojmë. Padyshim që një ekuilibër i tillë, nuk arrihet pa promovuar familjen si vlerë dhe institucionin si familje. Emrat e kolegeve më lart i referohen Kryeshefes Ekzekutive të BPB-së, Udhëheqëses së Retailit dhe Bankimit Dixhital dhe Udhëheqëses së Financave, respektivisht. Unë po ju drejtohem me emra, siç edhe komunikojmë në bankë, ngaqë mesazhi që dëshirojmë të përçojmë ka të bëjë me personalitete, më shumë se sa me tituj. Për PrishtinArt nga Banka e Vendit, rrëfimet e tre grave të Prishtinës, për jetën mes familjes dhe profesionit.

**M**ore often than not, in my role as the contact person for the Bank’s public relations, I find myself being naturally asked about the institution’s hierarchy with the question “Who is the director?” In Albanian, this question carries a gender-specific implication, assuming that the director is a man. Consequently, I often need to clarify that, in fact, the director is a woman. In many other languages around the world, job positions are not gender-specific, and thus gender role prejudices are not always as explicitly manifested as they are in Albanian. However, I am aware that instances where leadership titles do not imply a male gender are rare. Given this context, I might not have the inclination to write this narrative as an ambitious young woman who envisions herself with all the titles bestowed by family and profession. Nonetheless, the experiences and stories of my colleagues—Mimoza, Argjira, and Gresa—serve as an example that achieving a work-family-society balance is not only possible but is also the key to success that both the institution where I work, BPB, and each of us contributing there, appreciate. Undoubtedly, such a balance cannot be attained without promoting the family as a value and viewing the institution as a family. The aforementioned colleagues hold the positions of BPB’s Chief Executive Officer, Head of Retail and Digital Banking, and Head of Finance, respectively. I address them by their names, as we do during our encounters in the bank, emphasizing that the core of our message revolves around personalities rather than titles. While gender quotas may enforce representation numbers in some places, in BPB, women are well-represented across all departments, often holding leadership roles and deeply engaging in the development and management of various processes that accompany the complex operations of a bank.

For PrishtinART by BPB, these narratives share the experiences of three women from Prishtina regarding life between family and profession.



**Mimoza Godanci**  
KRYESHEFE EKZEKUTIVE

Derisa diku, kuota gjinore mund të imponojë numra përfaqësimi në hierarki, në Bankën e Vendit, gratë janë të përfaqësuara në secilin departament, shpesh udhëheqëse dhe në çdo situatë të përfshira në zhvillimin e biznesit apo menaxhimin e proceseve të ndryshme që përcjellin operativën komplekse të një banke. Në kushtet kur punon e rrethuar nga gra të suksesshme, është e mundur që ndonjëherë humbasim aftësinë për të gjykuar drejtë problemet që gratë hasin në zhvillimin e tyre profesional dhe luftimin e paragjyqimeve. Nuk janë të rralla as rastet kur edhe vet si gra dështojmë të lexojmë sinjale diskriminimi edhe kur ato janë shënuar me "shkronja të mëdha" tregon Mimoza, teksa tregon se si njëra nga vajzat e saj e ka pyetur se pse Mbretëria e Bashkuar nuk është "QueenDom", por "Kingdom", me që në krye të saj atëherë kur u bë pyetja ishte Mbretëresha Elizabetë. "Nuk besoj që të kem pas përgjigje për vajzën atë kohë, por gjithsesi situata nxjerr një mësim, "Fakti që një situatë është botërisht e pranueshme, nuk e bën atë të drejtë, e drejta bëhet e evidente vetëm nëse gjykohet me çiltërsinë e një fëmije ". Në këtë kontekst, vendimet që marrim çdo ditë kanë mundësi të mëdha të mbesin të mangëta (pre e paragjyqimeve gjinore), edhe kur femrat janë ato që vendosin. Pyetja e vajzës se Mimosës mbart në vete edhe

shqetësimin e shumë vajzave të vogla që mund të shikojnë rolin e tyre si një vendim binar, por shembujt që japim këtu dhe ato të qindra kolegeve që nuk patëm mundësinë t'i portretizonim në dy faqe reviste tregojnë që roli i gruas ka më shumë kolorit dhe si i tillë duhet të trajtohet, "Një punë që tradicionalisht mund të ketë qenë punë burrash, nuk të bën më pak grua".



**Gresa Godeni**  
UDHËHEQËSE E  
DEPARTAMENTIT TË  
FINANCAVE

"Si nënë e tre fëmijëve, por e njohur në veçanti si nëna e Benit, shpesh herë jam kursyer nga detaje të jetës personale, për të mos dhënë idenë se përmes kësaj historie me të cilën nuk përballem vetëm unë po tentoj të marr një lloj simpatie e tolerimi. BPB e ka bërë të kundërtën, e atë që rrallë e bën një institucion për një kauzë si Sindroma Down. Tash e sa vite, Banka e Vendit është partner kryesor i shoqatës dhe me nismat e tyre kanë lehtësuar jo vetëm jetën e Benit por edhe të të gjithë shokëve e shoqeve të tij në DSK", thotë Gresa, rrëfimi i të cilës në fakt, ndoshta më shumë do t'i shkante një reportazhi televiziv. Gresathotë se është tejet falënderuese për rritjen graduale që e përkufizon si "të shëndetshme" dhe e vetmja që duhet të ndiqet, sepse është ajo që e ka formësuar në profesionisten që është sot. "Në jetë, rrugëtimit e secilit prej nesh janë të ndryshme, e si të tilla, asnjëra nuk e ka rezultatin e njëjtë. Ajo që na ndërton si

## Mimoza Godanci

CHIEF EXECUTIVE OFFICER

Surrounded by successful women, there is a risk that we might lose the ability to empathize with the challenges women face in their professional development and the fight against prejudices. It is not uncommon for situations where, as women, we fail to recognize signals of discrimination even when they are marked with "capital letters," as shared by Mimoza, recounting her daughter's inquiry about the gendered nature of the name United Kingdom instead of "Queendom" when Queen Elizabeth held the position. "I don't think I had an answer for my daughter at that time, but in any case, the situation teaches a lesson, "The fact that a situation is globally acceptable does not make it right; right becomes evident only when judged with the clarity of a child." In this context, the decisions we make every day have the potential to remain flawed (due to gender prejudices), even when women are the ones making those decisions. Mimoza's daughter's question encapsulates the concerns of many young girls who might perceive their role as a binary decision. However, the examples we provide here, along with those of hundreds of colleagues not portrayed in these pages, demonstrate that the role of a woman is rich in color and should be treated as such- "A job that traditionally may have been seen as a man's does not diminish one's womanhood."

individ janë ëndrrat tona dhe angazhimi që ne bëjmë në baza ditore për t'i përbushur ato. Ajo se për çka njerëzit krijojnë dyshime për profesionistët gra, ndonjëherë e kalon edhe profesionin dhe shkon drejt personales. Nëse nuk gjykoresh për atë se çka përfaqëson sipas funksionit të cilin e ushtron, për shkak se projektet dhe rezultatet flasin më së miri, komentoresh për balancën familje-punë. Po, pra është e mundur dhe duhet të punojmë çdo ditë për të çuar përpara idenë se të dyja janë jo vetëm të menaxhueshme por rezultat i njëra-tjetrës, dhe kontribut e mbështetje reciproke", thotë Gresa.

## Argjira Kadrijaj - Dushi

UDHËHEQËSE E

DEPARTAMENTIT PËR BANKIM  
DIXHITAL DHE RETAIL

Argjira ndërkaq, thotë se specifikat e profesionit shpesh diktojnë orare të zgjatura e vikende jashtë shtëpisë. Por, që shton se menaxhimi i duhur i kohës dhe prioritetëve dëshmon se balanca në fakt është jo vetëm e mundur, por përditshmëri dhe nevojë. "Sot Tana dhe Darsi kanë pyetjet që unë kam pasur dikur për prindërit e mi. Faktikisht derisa rritesh përgjigjet për pyetjet që ke i merr vet, pa pasur nevojë për fjalë. Për mua, e rëndësishme është që pos rolit si nënë, të ju krijoj fëmijëve të mi mundësi të reja çdo ditë për zhvillimin e tyre dhe kjo nuk do të thotë se do të bëhet duke sakrifikuar diçka nga vëmendja që ju duhet çdo minutë", thotë ajo. Derisa, karakteret për të cilat fola sot janë modeste nga natyra, mua si PR më bie barra kryesore ta bëj të kundërtën. Faktikisht, derisa Argjirës po mundohesha të ia shkruaja profilin, mendova të përmend bankimin dixhital që po vjen si forcë transformuese e sistemit, por, pastaj, do të lija anash të arritura tjera. Vetëm në pak muaj në bankën e vendit nën leadershipin u realizuan suksesshëm projekte të ndryshme të biznesit përdërisa projekte ekskluzive presim vitin e ardhshëm. Argjira, paralelisht këtyre vazhdon studimet të doktoratës për ekonomi dixhitale, si një ndër profesionistet e pakta në Kosovë për këtë fushë.

## Gresa Godeni

HEAD OF FINANCE  
DEPARTMENT

"As a mother of three children, but known especially as Beni's mother, I often withhold personal details to avoid giving the impression that this story, which I am not facing alone, is an attempt to again sympathy and tolerance. BPB does the opposite, and it is rare for an institution to go as far as BPB has for a cause like Down Syndrome.

For years now, BPB has been a key partner of the organization, and their initiatives have not only improved Beni's life but also the lives of all his friends in DSK," says Gresa, whose narrative might be more suitable for a television reportage. Gresa expresses deep gratitude for the gradual growth, defining it as "healthy" and the only path worth following, as it has shaped her into the professional she is today.

"In life, everyone's journey is different, and as such, no one has the same result. What builds us as individuals are our dreams and the daily commitment to fulfill them. Doubts people have about women's professional success sometimes extend beyond the profession itself and delve into their personal lives. If you are not judged for what you represent and the work you do, you are scrutinized for the work-family balance. Yes, it is possible to achieve this balance, and we should work every day to advance the idea that both are not only manageable but also mutually reinforcing," says Gresa.



## Argjira Kadrijaj - Dushi

HEAD OF DIGITAL BANKING  
AND RETAIL DEPARTMENT

On the other hand, Argjira notes that the specifics of the profession often necessitate long hours and weekends outside the home. Nevertheless, she adds that proper time and priority management prove that balance is not only possible but also a daily reality and necessity. "Today, Tana and Darsi have the questions that I once had for my parents. As you grow up, you get answers to the questions without the need for words. For me, it is important that, in addition to the role of a mother, I create new opportunities for my children and contribute to their development each day, without sacrificing the attention they need every minute," she says. While the characters I discussed today are modest by nature, as a PR person, my primary objective is to do the opposite. Indeed, while attempting to write Argjira's profile, I considered mentioning digital banking as a transformative force in the financial system. However, I realized that would overlook other achievements. In just a few months under her leadership in BPB, various successful projects were executed, and many more are anticipated for the next year. Simultaneously, Argjira continues her studies for a Ph.D. in digital economics, making her one of the few professionals in Kosovo in this field.



# Jeta është një poezi e shkruar!

“Shkruaj poezi për ta lehtësuar shtrëngimin që shpesh më trazon, për të mos harruar sa pafat jam, për ta thirrë fatin. Shkruaj sepse nuk kam një tjetër trashëgimi për këtë botë” - shprehet në këtë nintervistë Arbër Selmani, gazetar dhe poet, një zë brilant i poezisë shqipe.

INTERVISTOI & FOTO: SHPEND MALIÇI

## Çfarë do të thotë për ju të shkruani poezi?

Pyetje shumë e tensionuar. Nëpër vite, ndryshon edhe përgjigjja ime. Në fëmijëri, shkruaja për të qenë i lumtur unë dhe njerëzit rreth meje. Në adoleshencë, shkruaja për të bërtitur, dhe besa-besa kam bërtitur shumë sepse më kanë shtypur shumë. Sot, në moshën 32 vjeçare, shkruaj poezi si një vazhdimësi e një interviste të gjatë me veten time. Unë nuk flas shumë me njerëz, nuk dal shumë, nuk kam kontakt të mirë me sytë e njerëzve, kam qenë më ekstrovert dikur, kjo krejt ndoshta për ta njohur më shumë veten time. Poezia është vijueshmëria ime, e jetës sime, e ndodhive të mia. Nuk po bërtas shumë, nuk po revoltohem shumë, sepse kjo më bën tmerrsisht dëm në shëndetin tim mendor. Të shkruaj poezi, do të thotë të vuaj shumë për ato çaste sa merr formë krijesa ime. Shkruaj poezi për ta lehtësuar shtrëngimin që shpesh më trazon, shkruaj poezi për të mos harruar sa pafat jam, shkruaj poezi për ta thirrë fatin, shkruaj poezi kur më vjen dhe jo kur e kërkon kuvendi. Shkruaj sepse nuk kam një tjetër trashëgimi për këtë botë.

## Ka pasur ndonjë ngjarje në jetën tuaj që ju ka afruar më shumë me poezinë?

Si i rritur, patjetër, poezia ‘Kur vdiq baba’. Kur e shkrova poezinë dhe kur e pashë reagimin e njerëzve, e kuptova që ndoshta ka një shkëndijë që premtan, te unë si poet e tregimtar. Më duhej pak konfirmim, dhe e morra, vazhdoj ta marr sidomos për atë poezi. Nuk ishte shumë ngjarje sa ishte një moment kur kuptova se mund ta kem fjalën armën më të fortë. Unë kam shkruar gjithmonë, poezinë e parë e kam shkruar në moshën 8 vjeçare. Midis librit tim të parë me poezi (Pse hidhërohet gjyshi, 2005) dhe librit të dytë me poezi (48 Piano, 2022), janë 17 vite mungesë, por edhe krijim, kompozim, shkrim, reflektim, udhëtim, shpesh edhe një bllokadë poetike pas së cilës gjithmonë del Dielli dhe prapë rigjehet vetja, motivet, shtigjet e reja, jo përsëritjet. Urrej të përsëritem, por ndodhë, e pamundur të mos ndodhë. Mua më ndodhë, çdo poeti, çdo zanati.

Kam shkruar sepse kam qenë fëmijë me shumë energji dhe ngushticat e mia i kam tejkaluar më lehtë përmes poezisë. Nëse ke qenë fëmijë e adoleshent në fillim të viteve 2000, pas mbarimit të luftës, poezia ka qenë pjesë e jetës tënde: kemi lexuar poezitë



e Agim Devës, Rifat Kukajt, Adelina Mamaqit, Arif Demollit, Xhevat Sylës, Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë na vizitonte vit për vit, kjo kam përshtypjen që më ka mbushur me imagjinatë, me jetë, me motive për të shkruar. Një fëmijë shkruan broçkulla të mahnitshme. Unë bëja diçka të tillë. Një ngjarje që mund t'i ketë dhënë sinjal trurit tim njomak për të shkruar e për të lexuar poezi në vazhdimësi ishte botimi i librit tim të parë me poezi. Kthehem në shtëpi pas shkollës, një pasdite, dhe gjej në banesë disa pako të mbushura me të njëjtin libër, e njëjta kopertinë e verdhë. Lart shkruhej ‘Arbër Selmani’ dhe më poshtë shkruhej ‘Pse hidhërohet gjyshi’, shoqëruar edhe më poshtë me një fotografi bardhë e zi të një plaku e një vocërraku. Babai ma kishte sjellë librin tim në shtëpi, pa ditur unë asgjë, dhe kjo ishte hera e parë në jetë që një ndjenjë së cilës as unë emrin nuk ia dija, po më trupësohej: krenari. Tash vonë e kuptova që qysh i vogël e kam shkruar emrin tim në kopertinat e plot librave që i kishim në banesë, ndoshta, sikur doja të bërtisja për një libër timin autorial që do të vinte më vonë.

## Poezia “Kur vdiq baba” është kthyer në një himn dashurie, dhembje dhe malli, na trego pak më shumë për të, si ndjeheni ju?

Babi ka vdekur në vitin 2016. Poezia është shkruar në vitin 2018, në një pasdite të ftohtë, me një Arbër të ftohtë dhe të humbur në mendime. Fillimisht kam menduar që atë poezi nuk do ta ndaja kurrë me njerëz, por në vitin 2020, në fillim të izolimit prej pandemisë, e ndava poezinë me miqtë e mi në rrjetet sociale me datë 1 prill, në përvjetorin e vdekjes së babis. Kujtohem që kur e postova poezinë dola dhe eca në rrugët e qytetit tim, po qaja, jo për vdekjen sa po qaja për atë poezi dhe për gjendjen time të trishtë atë ditë. Janë edhe 2-3 poezi të tjera të miat që kanë depërtuar te lexuesi shqiptar të shkruara me aq zhveshje e me aq pafajësi e me aq hidhërim, por ‘Kur vdiq baba’ nuk ka vdekur kurrë dhe e ndjej që do të më varrosë edhe mua. Jam me fat nëse ajo poezi jeton gjatë. Gënjej nëse them që përmes asaj poezie kam dashur ta monumentalizoj babin tim, figurën e tij. Jo, atë poezi e kam shkruar sepse zemra po plaste prej dhimbjes dhe ndoshta doja një mekanizëm shpëtuës. Isha 27 vjeçar dhe pa shumë përvojë për t'i marrë dy role që pasuan: të qenit poet e të qenit



kryefamiljar.

Poezia është përkthyer në gjuhën angleze, serbokroate, turke, frënge, gjermane, norvegjeze, italiane: nuk ka muaj që dikush nuk më shkruan për atë poezi. E urrej kur i bëj njerëzit të qajnë, e di që ndeshem me veten, por nuk dua t'i bëj njerëzit të qajnë. Në asnjë gjuhë tjetër ajo poezi, megjithatë, nuk godet aq fortësisht sa origjinali në gjuhën shqipe. Nuk më pëlqen të shkruaj për vdekjen, çdo vdekje e shkakuar prej çdo shkakut është e dhimbshme. Vdekja premtom vetëm material për letërsi të mirë, për poezi antologjike, dhe kaq, mbetet shterpë, rrotullon jetën tënde dhe është gjeniale në shpejtësinë me të cilën kalon. Të gjithë kthehem në dasma, dy ditë pas vdekjes. 'Kur vdiq baba', e them përlësisht, është një tërmet në jetën tim. Nuk e kam vuajtur shumë shkrimin e saj sa e vuaj faktin që atë nuk e lexoi kurrë babai im, ai besonte fuqishëm në aftësitë e mia shprehëse. Poezia i takon botës dhe në një formë është e shkruar tanimë prej qindra grave e burrave që kanë humbur baballarët e tyre, kanë humbur ndjenjën e sigurisë, janë privuar prej motivimit që ta jep një baba shembullor dhe i thepët.

### Si i strukturoni idetë dhe i konsolidoni ato në gjuhën poetike?

Luaj me motive, me fjalë, kështu vjen në jetë letërsia. Refuzoj të jem patetik, e fundit gjë që dua është që letërsia ime të jetë patetike, e përçmuar, e varfër në llavën e saj, e mjerë. Tragjike, mirë, e lejoj të jetë tragjike shpesh. E gjallë, po, dua që letërsia ime të jetë e gjallë edhe kur vdekja vendoset sipër saj. Nuk jam ai djali që shkruan çdo ditë, çdo mbrëmje, me një mal të madh të thumbimeve e ngacmimeve. Po, çdo gjë mund të kthehet në gjuhë poetike, por unë nuk dua të merrem me çdo gjë. Letërsia për mua është terapeutike, është shëruese, shpëtimtare, serotoninë. Duhet, e para, të më leverdisë mua, të më shërbejë mua, të jetë e dobishme për mua, për shpirtin tim. Tutje, nëse arrij deri te një njeri tjetër, te njerëz të tjerë, zemra më bëhet mal i madh edhe e them me shumë përvuajtje që dua ta përqafoj e ta dëgjoj çdo tregim a rrëfenjë që mund të dalë si pasojë e një vargu që e kam shkruar dikë. Idetë

më vijnë në kokë vend e pa vend, në terr e në dritë, në metro e në aeroplan, e çuditshme shumë. Më vijnë fytyrat, më vijnë emrat e njerëzve, jam tepër erotik me të dëgjuar një emër mashkulli që më pas më bën të notoj në vargjet e mia. Gratë, vajzat, në anën tjetër, kanë emra aq të mahnitshëm e sakrifikojnë aq shumë për mirëqenien e të tjerëve, sa që më duhet një turbulencë e vogël që unë ta hedh veten në krijim. Në poezinë time 'Babai im në shi' është një film i shkurtër, do ta kthej një ditë në një të tillë, më ka ardhur si një përfytyrim, si një vegim. Plot poezi më vijnë të tilla, si projekte kinematografike të cilat, përmes fjalës e shkronjës, i kthej në dorëshkrime. Nuk kam punuar ndonjëherë në projekte filmike por merrem rrallëherë me kurimin e ekspozitave, edhe prej kësaj ane inspirohem shumë. Poezia është platformë, unë e marr si të tillë, jo si një udhëtim ekzotik ku unë shpreh patjetër fantazitë e mia dhe qejfet e mia hysterike. Poezia më vjen prej këngës, shpesh, prej melodive klasike. '48 piano', libri im i fundit me poezi, ka pafundësisht muzikë brenda. Nuk e di, nuk shkruaj 500 faqe letërsi çdo vit, nuk e ndjej, kërkoj edhe perfeksionin e kjo më dëmton shumë. E di që shkruaj për ta shkrirë veten në mijëra copa, dhe nëse kjo nuk ndodhë, nuk kam bërë asgjë.

### What does writing poetry mean to you?

A very tense question. Over the years my answer also changed. As a child, I wrote to make myself and the people around me happy. As a teenager, I wrote to scream, and I think I screamed a lot because I was so oppressed. Today, at the age of 32, I write poetry as a continuation of a long conversation with myself. I don't talk much to people, I don't go out much, I don't have good eye contact, I was more extroverted, all this perhaps to get to know myself more. Poetry is my continuity, my life, my events. I don't shout too much, and I don't rebel too much, because this is terribly harmful to my mental health. Writing poetry means suffering a lot for those moments when my body takes shape. I write poems to ease the tension that often disturbs me, I write poems so as not to forget

## “Shkruaj poezi për ta lehtësuar shtrëngimin që shpesh më trazon, për të mos harruar sa pafat jam, për ta thirrë fatin.

how unfortunate I am, I write poems to invoke destiny, I write poems when I feel like it and not when the assembly requires it. I write because I have no other legacy for this world.

### Was there any event in your life that brought you closer to poetry?

gabimi në qasje ndaj pacientit. Është një vend ku çdo gjë trajtohet me shumë dashuri dhe përkushtim për profesionin duke e bërë që FARMACIA IME të jetë një destinacion final i shëndetit dhe bukurisë me një prekje franceze.

### **Cili është brendi i fundit që keni sjellë në Prishtinë?**

Gjithmonë e më shumë trendi botëror po drejtohet nga kujdesi për shëndetin mendor. Andaj menduam të sillnim produkte që përmirësojnë emocionet dhe relaksojnë muskujt. Kështu së fundmi i është bashkëngjitur brendeve tona edhe një tjetër markë fantastike nga Franca, Roger&Gallet, një linjë e ujit të parfumuar me ekstrakte të bimëve të ndryshme, e testuar dhe provuar shkencërisht mbi ndikimin emocional dhe fiziologjik në mirëqenien e atyre personave që e përdorin. Duke distiluar lumturinë që nga viti 1862 dhe trashëgimtar i Eau de Cologne-it të famshëm, Roger&Gallet krijojnë ujë aromatike të pasur me veti unike. Pavarësisht nëse janë relaksues apo energjikë, përfitimet e tyre janë të konfirmuara, falë një studimi shkencor të kryer në partneritet me Departamentin e Neuroshkencës në Universitetin e Tours dhe Emospin. Dhe ky është faktori kryesor që kemi dashur ta kemi në Kosovë në gamën e brendeve tona.

### **Sipas jush çfarë e bën një grua të suksesshme?**

Nuk ka formula të gatshme për të qenë grua apo burrë i suksesshëm. Puna konsistente dhe konkurrenca me veten, me atë çfarë ke qenë dje dhe atë çfarë je sot sjellin pa diskutim frytet e tyre. Por të pasurit të një familje të shëndetshme dhe të jesh i rrethuar nga miq të vërtetë, që jeta nuk t'i ka tjetërsuar mendoj që janë suksesi më i madh i një njeriu, qoftë grua apo burrë!

the right advice and obviously, a good image was given to our brands. Therefore in 2021 "My Pharmacy" was born, a pharmacy in the heart of Pristina. "My Pharmacy" was created to be the pharmacy for every family, where patients are treated with care even when they don't have something to buy, this is ultimately the pharmacist's task. The moment when the owner of a pharmacy considers a customer or a buyer as a client, the error in the approach to the patient begins. It is a place where everything is treated with so much love and dedication to the profession making "MY PHARMACY" the ultimate destination for health and beauty with a French touch.

### **What is the latest brand that you have brought in Pristina?**

Yes, recently in our brand has been joined another fantastic one from France, named Roger&Gallet, the line of water perfumes with extracts of various plants, enriched with lemon essential oil which stimulates the body and mind, with 95% of natural ingredients, this is a line produced in France. Distilling happiness since 1862 and heir to the famous Eau de Cologne, Roger&Gallet creates aromatic water endowed with unique properties.

### **What do you think makes a woman successful?**

In my opinion, there are no ready-made formulas for being a successful woman or man. Consistent work and competition with yourself, with what you were yesterday and what you are today, undoubtedly bears fruit. But having a healthy family and being surrounded by true friends, whose life has not alienated you, I think it is the greatest success of a person, be it a woman or a man.





## Muret “vishen” me art

**G**jatë muajve korrik dhe gusht të vitit 2023 është realizuar edicioni i 9-të i Guerilla Art Festival, ku tema kryesore ishte “Grafitekture”. Koncepti dhe ideja për këtë edicion ka qenë shkrimi e artit të grafitëve nëpër fasada, duke theksuar vlerat ekzistuese të lagjeve, prandaj edhe u zgjodh lagjja Dardania si një nga lokacionet për t’u trajtuar. Dy artistët e përzgjedhur për edicionin e 9-të, Joys Ead dhe Millo, nga Italia dhe i përkasin gjeneratave të para të street art. Ata kanë qenë pjesë e fillimeve të artit të rrugës në botë dhe kanë renome botërore. Prishtina ka pasur fatin

## The walls are “dressed” in art

**I**n July and August 2023, the 9th edition of the Guerilla Art Festival was held, where the main theme was “Grafitekture”. The concept and idea of this edition was the fusion of graffiti art on the facades, underlining the existing values of the neighborhoods, which is why the Dardania neighborhood was chosen as one of the places to be covered. The two artists selected for the 9th edition, Joys Ead and Millo, come from Italy and belong to the first generations of street art. They were part of the beginnings of street art in the world and have worldwide fame. Prishtina was lucky enough to have two big names in the same year. “Guerilla is one of the first festivals in Kosovo and we can say that in Prishtina street

që në të njëjtën vit të ketë dy emra të mëdhenj.

“Guerilla është një nga festivalet e para në Kosovë dhe mund të themi se në Prishtinë arti i rrugës (street art) ka filluar me Guerilla-n. Që nga edicioni i parë në vitin 2014, çdo vit ky festival ka sjell murale shumë të rëndësishme për qytetin dhe sot Prishtina është në shumë harta dhe lista në këtë sektor për shkak të vlerave që ka krijuar në fushën e street art. Këto vepra kontribuojnë shumë në industrinë kreative, veçanërisht në turizmin kreativ, që organizata QART synon ta çojë përpara dhe ta zhvillojë të ardhmen e këtij sektori në Kosovë”- shprehet Agon Xhelili, drejtor i festivalit. Prej vitesh tashmë Prishtina është një “ekspozitë” e përhershme e disa prej grafitëve më të bukura, duke e bërë më të gjallë dhe më me shumë ngjyra qytetin tonë dhe është pikërisht “Guerilla Art Festival, që mban “vulën” në shumë këto ndryshime. “ Në këto 10 vite, Prishtina ka evoluar në një kryeqendër të vërtetë të grafitëve dhe artit të rrugës në rajon. Kemi bërë histori duke sjellë murale dhe shfaqje të jashtëzakonshme, duke transformuar qytetin tonë në një ambient të pasur me ngjyra dhe shpirt krijues. Në edicionin e ardhshëm të Guerilla Art Festival, festivali do të shënojë një moment të veçantë, 10-vjetorin e saj. Kemi synim të krijojmë një edicion frymëzues për të nderuar këtë jubile dhe për të theksuar ndikimin e jashtëzakonshëm që ky festival ka pasuar në skenën kulturore lokale ndër vite”- thotë Agoni.



art began with Guerilla. Since the first edition in 2014, every year this festival has brought very important murals to the city and today Prishtina is present on many maps and lists of this sector due to the values it has created in the field of street art. These works contribute a lot to the creative industry, especially creative tourism, which the “QART” organization aims to advance and develop the future of this sector in Kosovo” - says Agon Xhelili, director of the festival. For years now, Prishtina has been a permanent “exhibition” of some of the most beautiful graffiti, which makes our city more lively and colorful, and it is precisely the “Guerilla Art

Festival” that puts the “stamp” on many of these changes. “In these 10 years Prishtina has evolved into a true center of graffiti and street art in the region. We have made history by bringing extraordinary murals and performances, transforming our city into an environment rich in color and creative spirit. In the next edition of the Guerilla Art Festival, the festival will mark a special moment, its tenth anniversary. We intend to create an inspiring edition to honor this jubilee and to highlight the extraordinary impact this festival has had on the local cultural scene over the years” - says Agoni.

# Kur ëndrrat përkthehen në suksese

Urate Shabani është pjesë e gjeneratës së re të aktorëve kosovarë, të talentuar, ambicioz dhe sfidues...një yll premtues i teatrit dhe filmit shqiptar.

Filmi 'Luaneshat e Kodrës' rezultoi të ishte një mundësi e artë për të gjithë aktorët pjesëmarrës, por sidomos për ne që na u besuan rolet kryesore.

The movie "Hill Lionesses" turned out to be a golden opportunity for all the participating actors, but especially for us who were entrusted with the main roles.

**G**enerata e re e aktorëve në Kosovë gjithnjë e më shumë po shndrin në skenën. Këtë numër sjellim profilin e aktorese Uratë Shabani, të cilën pasioni i madh për aktrim e shtyu të merrte pjesë në festivale të filmit dhe teatrit, ku fillimisht punonte si vullnetare e më pas u bë protagoniste e tyre. "Filmin e kam konsideruar gjithmonë si një mundësi shumë të mirë për ta promovuar veten në shumë festivale kombëtare dhe ndërkombëtare. Filmi 'Luaneshat e Kodrës' rezultoi të ishte një mundësi e artë për të gjithë aktorët pjesëmarrës, por sidomos për ne që na u besuan rolet kryesore. Suksesi i filmit u pa që në ditët e para të xhirimeve nga energjia dhe përkushtimi i madh i regjisores po ashtu edhe nga aktorët e gjithë kastit. Në vitin 2021 ishim pjesëmarrës në festivalin e Kanës në Francë "Director's Fortnight".- tregon Urata për rrugëtimin e saj artistik. Ndërsa filmi 'Luaneshat e Kodrës' udhëtoi drejt festivalit të Sarajevës në kategorinë kryesore ku dhe rrëmbyen çmimin si aktoret kryesore më të mira, të njëjtin çmim e fituan edhe në Prifest në Prishtinë. "Këtu ishte ndjenja më e mirë për mua për faktin sepse u vlerësua nga vet vendi im. Filmi ka vazhduar rrugëtimin nëpër botë, vazhdon të shfaqet dhe të fitojë çmime të ndryshme nëpër shumë festivale të mëdha."Toka brenda meje" nga Fisnik Maxville është një tjetër film me një kast të jashtëzakonshëm ku kam marrë një eksperiencë të madhe profesionale, i vlerësuar me çmime të ndryshme si filmi më i mirë dhe regjia më e mirë. Në rrugëtimin tim kinematografik ndikim të veçantë ka pasur

# When dreams turn into success

Urate Shabani is part of the new generation of Kosovo actors, talented, ambitious and challenging...a promising star of Albanian theater and film.

**T**he new generation of actors in Kosovo is increasingly shining on the stage. In this edition, we bring the profile of the actress Urate Shabani, whose great passion for acting led her to participate in film and theater festivals, where she first worked as a volunteer and then became their protagonist. "I have always considered the film as a very good opportunity to promote myself in many national and international festivals. The movie "Hill Lionesses" turned out to be a golden opportunity for all the participating actors, but especially for us who were entrusted with the main roles. The success of the film was seen in the first days of shooting by the great energy and dedication of the director as well as the actors of the entire cast. In 2021, we participated in the "Director's Fortnight" Cannes festival in France." - says Urata about her artistic journey. While the film "Hill Lionesses" traveled to the Sarajevo festival in the main category where they won the award as the best leading actresses, they also won the same award at Prifest in Prishtina. This was the best feeling for me because I got recognition from my own country. The film has continued its journey around the world, it still continues to appear and win various awards at many major festivals. "The Earth Inside Me" by Fisnik Maxville is another film with an extraordinary cast where I earned a great professional experience, awarded with various awards such as the best film and the best director. In my cinematic journey, the film "Our World" by Luana Bajrami had a special impact, where we had the pleasure of being part of the film festival in Venice, accompanied by a unique experience and a series of contacts exchanged with world-famous artists"- says the actress.





edhe filmi “Bota Jonë” nga Luana Bajrami ku patëm kënaqësinë të ishim pjesë e festivalit ë filmit në Venecia, e shoqëruar me një përvojë unike dhe një sërë kontaktesh të shkëmbyera me artistë me famë botërore” - thotë aktorja.

Është një nga artistet më premtuese në vendin tonë, megjithatë Urata ecën sigurt në hapat e karrierës së saj ndërkohë që lundron në karaktere dhe personazhe, e gatshme ta sfidojë veten në zhanre e të ndryshme, po aq edhe me problematikat që hasin të rinjtë sot. “Profesioni i aktrimit është gjithmonë sfidues kur ka krijimtari të mjaftueshme, sidomos te ne sepse ka shumë talente me të cilët mund të punosh pa asnjë vështirësi dhe është një konkurrencë shumë e madhe për ta zhvilluar vetëm brenda kufijve. Sfidë që ka kaluar arti kosovar në këto dy dekada ka qenë pikërisht udhëtimi i lirë pa viza, i cila ka ndikuar në zhvillimin e karrierës tek secili artist por me shumë në pamundësinë për të promovuar siç duhet artin dhe kinematografinë kosovare. Megjithatë kjo sfidë ndoshta është shndërruar tek unë në një forcë motivuese për të dhënë më të mirën time si dhe për ta përfaqësuar vendin tim përtej kufijve në mënyrë dinjitoze”- shprehet Urata. Aktorja i ka qëllimet e qarta duke ditur se çdo rrugë e arrirë me punë të dërgon drejt të njëjtit qëllim. “Me rëndësi për mua është që të përjetoj çdo gjë që bëj dhe gradualisht planet që projektoj do të fillojnë të ndërtohen natyrshëm. Njihem si person shumë ambicioz dhe dua që të udhëtoj nëpër rrugë të sigurta drejt karrierës sime”- përfundon ajo.

↓

**Është një nga artistet më premtuese në vendin tonë, megjithatë Urata ecën sigurt në hapat e karrierës së saj**



**She is one of the most promising artists in our country, however, Uratë Shabani, is walking confidently in the steps of her career**

↑

She is one of the most promising artists in our country, however, Uratë Shabani, is walking confidently in the steps of her career while navigating in profiles and characters, ready to challenge herself in different genres, regardless of the problems faced by young people today. “The acting profession is always challenging, especially when there is enough creativity, as there are many talents that you can work with, without encountering difficulties, and there is a big competition to be developed only within the country. The challenge that Kosovar art has faced in these two decades has been precisely the free travel without visas, which has influenced the career development of each artist, but more so the impossibility of properly promoting Kosovar art and cinematography. However, this challenge has probably turned into my motivating force, and give my best to represent my country with dignity beyond the borders - says Urata. For several years now, she has been a protagonist in successful films, while as a young and very promising actress, Uratë Shabani has clear goals, knowing that every path reached with work leads to the same goal. “It is important for me to experience everything I do and gradually every plan I project will start to build naturally. I am known as a very ambitious person and I want to travel through safe paths towards my career” - she concludes.



# Ethno Fest, “muze” i kulturës sonë

Edicioni i 13 i Etno festit ishte e ngjarje e madhe kulturore edhe për Prishtinën, duke e pasuruar skemën e aktiviteteve verore kulturore të mbështetura nga komuna e Prishtinës, EtnoFesi dhe etno fshati Kukaj u bën një adresë kulturore tejet atraktive frymëzues për artistët dhe qytetarët.

## Ethno Fest, “The Museum” of our cultural heritage

The 13th edition of Ethno Fest was also a great cultural event for Pristina, enriching the program of summer cultural activities supported by the municipality of Pristina, EtnoFest, and the ethnic village Kukaj, making it a very attractive and stimulating cultural address for artists and citizens.



**T**his edition of the Etno Fest was a real success, which took place for 8 consecutive days at the Kukaj ethnic complex, with around 8,000 spectators, many from the diaspora, but also foreign tourists. “We had a rich program, divided into 10 pillars, which allowed close communication between the communities of theatrical and figurative artists, the musical and ethnocultural scene, the artisans and gastronomes, the scenographers, the architects and the ethnocultural researchers, well-known names of the music that kept the large audience in a festive atmosphere until late hours in the premises of the ethnic complex in Kukaj” - says director Fadil Hysaj. The 13th edition of Ethno Fest was also a great cultural event for Pristina, enriching the program of summer cultural activities supported by the municipality of Pristina, EtnoFest, and the ethnic village Kukaj, making it a very attractive and stimulating cultural address for artists and citizens.

“Our objective continues to be the cultivation and promotion of the values of the spiritual and material heritage, which risk disappearing. This can happen above all with the cultural heritage coming from rural areas, with wedding and funeral rites, with songs and ancient dances, with the art of traditional conversation, with the traditional culture of clothing, food, housing, working tools, and various crafts of their countries. creation that is disappearing and everything that

**N**jë sukses i vërtetë ka qenë ky edicion i Etno Festit i mbajtur për 8 ditë me radhë në etno kompleksin në Kukaj, me rreth 8000 spektatorë. “ Kemi pasur një program të pasur, i ndarë në 10 shtylla që mundësoi një komunikim të afërt mes komuniteteve të artistëve të teatrit dhe atyre figurativë, skenës muzikore dhe të etnokulturës, zejtareve e gastronomëve, skenografëve, arkitektëve dhe studiuesve të etnokulturës, emra të njohur të muzikës që mbajtën publikun e shumtë në atmosferë festive deri në orët e vona në ambientet e etnokompleksit në Kukaj”- shprehet

drejtori Fadil Hysaj. Edicioni i 13 i Etno festit ishte e ngjarje e madhe kulturore edhe për Prishtinën, duke e pasuruar skemën e aktiviteteve verore kulturore të mbështetura nga komuna e Prishtinës, EtnoFesi dhe etno fshati Kukaj u bën një adresë kulturore tejet atraktive frymëzues për artistët dhe qytetarët. “Synimi ynë vazhdon të jetë kultivimi dhe valorizimi i vlerave trashëgimore të karakterit shpirtëror e material, të cilat rrezikojnë të zhduken. Kjo mund të ndodhë sidomos me trashëgiminë kulturore me origjinë nga zonat rurale, me ritet e dasmave dhe mortit, me këngët dhe vallet e vjetra, me artin e bisedimit

tradicional, me kulturën tradicionale të veshjes të ushqimit, të banimit, me mjetet e punës dhe zejet e ndryshme të krijimit të tyre që po zhduken dhe gjithçka që konsiderohet me vlerë por që e ka shkelë dhe vazhdon ta shkelë dhe tjetërsojë koha e ashtuquajtur modern. Gjithçka që është e vjetër dhe që njerëzit me vetëdije të ultë kulturore e braktisin ose e zhdukin, ka 13 vite që ne mundohemi t'i gjejmë vend në hapësirat e etno kompleksit në Kukaj dhe ta bëjmë të dukshme qoftë si pjesë të ekspozitave ose të aktiviteteve performuese të Etnofestit. Qëllimi ynë nuk është vetëm ruajtja apo konservimi i këtyre vlerave trashëgimore, por që ato vlera t'iu ofrojmë edhe si brymë motivues e frymëzues artistëve kontemporan me dëshirën që veprat e reja artistike të kenë një bazament autokton dhe identitar, që do t'i bënte më të fuqishme dhe më të pranueshme jo vetëm për audiencën kombëtare, por edhe në atë ndërkombëtare"- thotë z.Hysaj. Duke theksuar më tej se artistët më të suksesshëm të arteve muzikore e figurative, të arkitekturës dhe instilacioneve kontemporane janë ata që kanë shfrytëzuar në mënyrë kreative trashëgimin shpirtërore e materiale të nënqiellit tonë. Etno Festi gjatë këtyre 13 viteve ka ndikuar shumë në ngjyrimin tradicional të muzikës kontemporane shqiptare. Duke ndikuar edhe në shijen e publikut me çka po rritet edhe ndjenja e përkatësisë kulturore. Etno Festi do të vazhdoj të jetë porta përmes së cilës artistët e të gjitha arteve mund të hyjnë në zonën e pasur të traditës, të marrin atë që i frymëzon dhe prej aty të dalin shumë më të pasur shpirtnisht dhe më të frymëzuar artistikisht për veprat e tyre të reja. " Pos në rritje të aspektit programor, synojmë rritje edhe në aspektin infrastrukturor të Etno festit. Etno kompleksi vetvetiu është shndërruar në një vlerë edhe si muze i krijuar prej 14 viteve. EtnoFesti dhe EtnoKompleksi në Kukaj tashmë është një adresë e rëndësishme kulturore, aty mund të zhvillohen shumë ngjarje kulturore për të cilat Komuna e Prishtinës e ka të vështirë t'iu gjej ambiente të përshtatshme



“ Etno Festi do të vazhdoj të jetë porta përmes së cilës artistët e të gjitha arteve mund të hyjnë në zonën e pasur të traditës, të marrin atë që i frymëzon dhe prej aty të dalin shumë më të pasur shpirtnisht dhe më të frymëzuar artistikisht për veprat e tyre të reja.

is considered precious but which has been violated and continues to be violated and alienated by the so-called modern time. Everything that is old and that people with little cultural awareness abandon or destroy. For almost 13 years we have been trying to find a place for the “Ethno Fest” in the spaces of the Kukaj ethnic complex and to make it visible both in the scope of exhibitions and performative activities. Our goal is not only to preserve or conserve these heritage values, but to offer such values as motivational and inspirational rime to contemporary artists with the desire that new artistic works have an indigenous and identity basis, which makes them more powerful and more acceptable not only for the national public, but also for the international one” - states Mr. Hysaj. Further highlighting that the most successful artists of contemporary musical and visual arts, architecture, and installation are those who have creatively used the spiritual and material heritage of our underworld.

During these 13 years, EthnoFest has strongly influenced the traditional color of contemporary Albanian music. Influencing the public's taste, with which the sense of cultural belonging grows. Ethno Fest, as in past years and into the future, will continue to be the gateway through which artists of all arts can enter the rich territory of tradition, take what inspires them, and emerge much richer spiritually and artistically for their work of arts.

“In addition to increasing the programmatic aspect, we also aim to increase the infrastructural aspect of the Etno festival. The ethnic complex itself has also become valuable as a museum created 13 years ago. The EtnoFest and the Etno Complex of Kukaj are already important cultural addresses, many cultural events can take place there for which the Municipality of Pristina has difficulty finding adequate facilities for shows and exhibitions. It is a great opportunity for our rich traditional heritage to be used as a source of inspiration, not only for our artists but also for international artists, and in this way, the influence of the values of our heritage extends its influence to other cultures too.” - says Fadil Hysaj.

# A po e shkatërron fotoshopi fotografinë artistike?!

"A ka shkuar aq larg fotoshopi? Ka njerëz që mendojnë se po, edhe fotografët vet e mbështesin këtë ide. Kur shumë personazhe nuk e njohim më veten në kopertinat e revistave, ndaj shumë pajtohen me mendimin se efekti fotoshop po bëhet një terren i rrezikshëm. Është koha të rifreskojmë memorien dhe të pyetemi se për çfarë në fakt është krijuar fotoshopi: për të sjellë subjektin më në fokus apo për të krijuar fiksione?!"

## Is Photoshop destroying artistic photography?!

"Has Photoshop reached this point? Some think so, even the photographers themselves support this idea. When many celebrities no longer recognize themselves on the covers of various magazines, many agree with the opinion that the Photoshop effect is becoming dangerous terrain.. It's time to refresh our memories and ask ourselves what Photoshop was created for to bring the subject more into focus or to create fiction."

FOTO: SHENOLL ZEHRI





# Arben Llapashtica

FOTOGRAF



## A po e dëmton fotoshopi lirinë artistike?

Fotoshopi është vetëm edhe një program më i avancuar sa i përket ndërhyrjeve në fotografi, por që fatkeqësisht thumbohet pasi që është app-i vetëm ndër më të avancuarit. Ashtu

si aparati fotografik dhe fotoshopi vetëm kërkojnë mënyrë të duhur të përdorimit të tyre.

## Manipulimi në foto korrigjim korrekt apo një ndërhyrje e padëmshme e lirisë artistike?

Brendet e kamerave mundësojnë ndërhyrje ende pa u shkrepur fotografia, andaj aty përfundon debati rreth ndërhyrjeve në momentin kur shkrepet fotoja. Sa i përket temës se a ia shton vlerën apo e degradon fotografinë, mund të them se kur këto ndërhyrje janë relative e plotësojnë efektin estetik të fotografisë. Natyrisht, intervenimet e shumta në fotografi humbin shpirtin e fotografisë pasi që në thelb fotografia tenton të jetë pasqyrim i realitetit.

## A reflekton në çështje të ndjeshme siç janë objektiviteti te gjinitë dhe deformimi i asaj që konsiderohet bukuri natyrale?

Unë mendoj se ndonjëherë fotoshopi atakohet pa të drejtë. Publiku kur vëren se në fotografitë e të famshmëve që ata pëlqejnë nuk përkojnë me pamjen e tyre reale, reagojnë duke e thumbuar fotoshopin, por rrallë përmendin aplikacione të ndryshme që me një klik dhe një pagese e tjetërsojnë personin. Unë i takoj gjeneratës se re të fotografëve, pavarësisht se jam koleksionues i kamerave të vjetra, mendoj se edhe në atë periudhë ka pasur tendenca për manipulim të fotografisë, qoftë për të mirë apo për të keq. Kjo ka ndodhur nëpërmjet përdorimit të celuloidit varësisht se si e ka parë të nevojshme fotografi, dhe kjo ka qenë një ritual jo edhe i lehtë gjatë përpunimit të një fotoje.

## Si e shihni ndikimin e fotoshopi në kulturën tonë?

Mendoj që tash është një aspekt më negativ sepse fotoshopi është bërë më i qasshëm edhe për njerëzit që nuk janë profesionistë të fotografisë dhe shumë lehtë mund të ndodhë keqpërdorimi i tij. Sa kam lexuar, tjetërsimi i vetes duke manipuluar me filtra ndikon keq në shëndetin mendor, sidomos te njerëzit që nuk janë të kënaqur me veten dhe

# Arben Llapashtica

PHOTOGRAPHER

## Is Photoshop harming artistic freedom?

Photoshop is indeed one of the most advanced programs in terms of photo manipulation, but unfortunately, it suffers because it is the only app among the most advanced. Camera and Photoshop just require a correct way to use them.

## Photo manipulation, a proper correction, or a harmless intervention of artistic freedom?

Camera brands allow tampering even before the photo is taken, so the debate over tampering ends the moment the photo is taken. Regarding the issue of whether it adds value or degrades the photograph, I can say that when these interventions are relative, they complete the aesthetic effect of the photograph. Naturally, the numerous photographic interventions lose the spirit of photography, since fundamentally photography tends to be a reflection of reality.

## It reflects on sensitive issues such as gender objectivity and thing distortion. Is it considered natural beauty?

I think sometimes Photoshop gets attacked unfairly. When the public notices that the photos of celebrities they like do not match their real appearance, they react by attacking Photoshop but rarely mention several applications that alienate the person with one click and one payment. I belong to the new generation of photographers, despite being a collector of old cameras, I think that even in that period there were tendencies to manipulate photography, for better or for worse. This was done through the use of celluloid as the photographer deemed it necessary, and this was not an easy ritual when working on a photo.

## How do you see Photoshop's influence on our culture?

I think it's an even more negative aspect now because Photoshop has become more accessible even to non-professionals and can very easily be misused. From what I've read, alienating yourself by manipulating filters harms mental health, especially for people who are dissatisfied with themselves and try to hide their complexes and depressive side through applications.



# Arian Mavriqi

FOTOGRAF



## A po e dëmton fotoshopi lirinë artistike?

Në fakt mendoj se gjithçka varet sesi e përdor fotoshop-in, por nëse flasim në përgjithësi atëherë padyshim se po. Edhe mua, personalisht,

nga ky problem më pyesin a e ke foton tende apo është fotoshop? Sepse kanë parë manipulime të ndryshme dhe tani dyshojnë tek secili fotograf.

## Manipulimi në fotografi korrigjim korrekt apo një ndërhyrje e padëmshme e lirisë artistike?

Mendoj se është ndërhyrje e padëmshme nëse largon si për shembull ndonjë mbeturinë ose diçka kot që na del para, por asnjëherë duke mos e tepruar me vet objektin që ke fotografuar.

## Si e shihni ndikimin e fotoshopit në kulturën tonë?

Por mendoj se gjithçka duhet gjykuar nga mënyra se për çka përdoret, mund të them që përdorimi kohëve të fundit të fotoshop-it, sidomos në fytyrë kalon çdo kufi, dhe është i dëmshëm edhe për vete klientët, të cilët në fotosesione porosisin diçka të tillë, duke e ditur brenda vetes se ata nuk janë në të vërtetë ashtu.

# Arian Mavriqi

PHOTOGRAPHER

## Is Photoshop harming artistic freedom?

I think it all depends on how I use Photoshop, but if we're talking in general then definitely yes. Also, personally, because of this problem, they asked me do you have my photo or if it was photoshopped. Because they have seen several manipulations and now doubt every photographer.

## Photo manipulation, a proper correction, or a harmless intervention of artistic freedom?

I think it's a harmless intervention if you remove, for example, some rubbish or something useless that is in front of us, but without ever removing too much of the object you photographed.

## How do you see Photoshop's influence on our culture?

But I think that everything should be judged by the way it is used, I can say that the recent use of Photoshop, especially on the face, exceeds all limits, and is harmful even for the clients themselves, who order something like this in photo sessions, knowing inside of themselves that I'm not really like that.



# Shenoll Zehri

FOTOGRAF



## A po e dëmton fotoshopi lirinë artistike?

Edhe pse bota moderne dhe evoluimi i industrisë së fotografisë ka ndryshuar shumë kohëve të fundit, çdo

fotograf artistik duhet ta ruaj sa me tepër vlerat origjinale të fotografisë dhe ta nxjerr anën më të mirë gjatë shkrepjeve në mënyrë që të mos ketë nevojë për ndërhyrje të tepërta apo photoshop pasi që çdo gjë origjinale është më e bukur, më me vlerë dhe emocion.

## Manipulimi në fotografi korrigjim korrekt apo një ndërhyrje e padëmshme e lirisë artistike?

Korrigjimi dhe ndërhyrja korrekte në fotografi është e mirëseardhur për shkak që mundemi ta qesim në pah imazhin duke mos ja humbur origjinalitetin dhe vlerat artistike.

## Si e shihni ndikimin e fotoshopit në kulturën tonë?

Edhe pse trendi i përdorimit të fotoshopit tek ne është çdo herë në rritje si nga fotografët ashtu edhe nga njerëzit në përgjithësi, unë mendoj që nuk është duke ndikim i mirë në shoqërinë tonë për arsye që mund të ketë edhe efekte negative, psikologjike. Duke bërë që njerëzit mos të kënaqen me pamjen e tyre reale dhe duke krijuar në këtë

# Shenoll Zehri

PHOTOGRAPHER

## Is Photoshop harming artistic freedom?

Although the modern world and the evolution of the photographic sector have changed a lot in recent times, every artistic photographer should preserve the original values of photography as much as possible and bring out the best side during the shots so that there is no need for excessive intervention or of Photoshop because everything original is more beautiful, more precious and emotional.

## Photo manipulation, a proper correction, or a harmless intervention of artistic freedom?

Correction and intervention in the photograph are welcome because we can highlight the image without losing its originality and artistic values.

## How do you see Photoshop's influence on our culture?

Even though the trend of using Photoshop in our country is increasing both among photographers and people in general, I think it does not have a good impact on our society because it can also have negative psychological effects. Making people dissatisfied with their actual appearance and thus creating an unrealistic self-image. Furthermore, the excessive use of Photoshop by our photographers is creating confusion among the public between the real and the unreal (photoshop).



# Galeritë private “katalizator” të artit pamor

Prej vitesh galeritë private po lulëzojnë dhe revolucionarizojnë skenën e artit pamorë në Prishtinë, duke u bërë një platformë ideale për promovim dhe prezantim të artit shqiptar.

## Private galleries as “catalysts” of visual art

For years, private galleries have been flourishing and revolutionizing the visual art scene in Pristina, becoming an ideal platform for the promotion and presentation of Albanian art.



### Qahili Gallery

**T**he Qahili Gallery was founded in 2013 to be a meeting point for artists and art lovers in all its forms. A space for artistic expression, promotion of art, collaboration for cultural exchange, creation, education, and greater access to culture. “Visual art has gained more visibility platforms for artists, thus more opportunities to promote their work to the public, including art critics, enthusiasts, collectors, and buyers of works, but also expansion of networks and enrichment of the cultural scene. The more they open up, the more they will influence the process of increasing cultural capital in society, especially the inclusion of art and culture in people’s daily lives” says the one from the gallery

It was a rich year in terms of the program, audience, collaborations, and new opportunities to further develop ideas, since January, Qahili Gallery has started with the educational program of four painting workshops for children and two for adults - educational and social activities welcomed by the participants. Subsequently, the annual exhibition

### Galeria Qahili

**G**aleria Qahili u themelua në vitin 2013, si një pikëtakim i artistëve dhe dashamirëve të artit në të gjitha format e tij. Një hapësirë e shprehjes artistike,

promovimit të artit, bashkëpunimit e shkëmbimit kulturor, krijimit, edukimit dhe rritjes së qasjes në kulturë. “Arti pamor ka fituar më shumë platforma të dukshmërisë së artistëve, më shumë mundësi të promovimit të punëve të tyre te

publiku përfshirë këtu kritikë arti, entuziastë, koleksionistë e blerës të veprave, por edhe zgjerim të rrjeteve e pasurim të skenës kulturore. Sa më shumë që ka, aq më shumë ndikon në kapitalin kulturor në shoqëri, sidomos kyçjes së artit dhe kulturës në jetën e përditshme të njerëzve"- shprehen nga kjo galeri. Viti 2023 ka qenë një vit i pasur për nga programi, audienca, bashkëpunimet dhe mundësitë e reja për zhvillim të mëtejshëm të ideve për Galerinë Qahili, ku prej janarit ka filluar me programin e edukimit të katër punëtorive pikturimi për fëmijë e dy për të rritur - aktivitete edukuese e shoqërimi të mirëpritura nga pjesëmarrësit. "Më pas, programi vjetor i ekspozitave ka ofruar shumëllojshmëri të veprave të artistëve duke filluar nga ekspozita "Muzeu i Fëmijërisë" së artistit të njohur Eshref Qahili, ekspozita "Pragu" e artistes së re Renea Begolli, - këto të dyja të ndjekura edhe me evente të hapura diskutimi me artistët, ekspozita kolektive "Ato" për nder të Ditës Ndërkombëtare të Gruas e përcjellur edhe me një sesion Yoga me Dodonë, e inicuar nga Shigi Studio, ekspozita e koleksionistit Austin Clarke e titulluar "Ma n'fund n'shpi t'vetën", e cila është bartur edhe në Etno Fest, ekspozitë kolektive "28" në kuadër të Festivalit "28", ekspozitë dhe njëkohësisht ndejë përcjellëse e ambasadorit norvegjez për Kosovë dhe Shqipëri Jens Erik Grondahl e titulluar "Leaving but Not Going", ekspozitë e artistit të merituar nga Shqipëria Zamir Mati me ilustrime e tij për librin Beni Ecën Vet e hapur nga diskutimi me arkeologun Ilir Mati, e titulluar "Udhëtojmë", ekspozita "E kaluar e çmuar" me punime nga artistët shqiptarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Burhan Ahmeti dhe Nevzat Kica. Si aktivitete finale të

përmbylljes së një viti të suksesshëm do të prezantohet para publikut edhe ekspozita vjetore "Hijet e Bardha" e nënquajtur "Blu" e që ngërthen punime të dorëzuara nga artistë të ndryshëm që po i përgjigjen thirrjes së hapur për dërgim të punimeve me përmbajtje ngjyrën e kaltërt, animacione edukuese të cilat do të publikohen si seri, si dhe një ndejë përmbyllëse për të falënderuar e takuar të gjithë miqtë e Galeria Qahili"- theksojnë themeluesit e saj.

## Galeria 17

**G**aleria 17 erdhi si dëshirë dhe nevojë për gjithëpërfshirje dhe qëndrueshmëri të një skene artistike në fermentim, ku nevoja për hapësira të reja të eksperimentimit është jetësore. Ekspozitat e prezantuara prodhojnë hapësirë duke u rishikuar dhe shndërruar. "Në këtë kuptim galeria mund të perceptohet si hapësira e një guaske që lind me moluskun dhe rritet. Përshtatet dhe transformohet në varësi të nevojave të zhvillimit, sikurse edhe hapësirat e përbashkëta publike që reflektojnë strukturën tonë shoqërore në brendësi të labirinteve të progresit urban. Duke pasur fokus të veçantë në çështjet sociale, artistët/et dhe kuratorët/et ftohen të eksperimentojnë me konceptet, idetë dhe hapësirën. Të sjellin ekspozita të guximshme që krijojnë dialog dhe nxisin debate publike, duke kontribuar vazhdueshëm në dokumentimin dhe krijimin e referencave të munguara përgjatë një procesi që arkivon dhe edukon"- shprehen nga Galeria 17, e cila synon të jetë pjesëmarrëse në bërjen e politikave kulturore etike dhe aktive, duke siguruar përfaqësim dhe përfshirje në industrinë kulturore

program offered a variety of works by artists, starting with the exhibition "Children's Museum" by the well-known artist Eshref Qahili, "Prague" exhibition by the young artist Renea Begolli, - these two followed by open discussion events with the artists, the collective exhibition "Ato" in honor of International Women's Day followed by a Yoga session with Dodona, promoted by Shigi Studio, the exhibition of the collector Austin Clarke captioned it "Finally in the own House", also reported in Etno Fest, collective exhibition "28" within the Festival "28", exhibition and at the same time accompanying party of the Norwegian ambassador for Kosovo and Albania Jens Erik Grondahl entitled "Leaving but Not Going", exhibition by the award-winning Albanian artist Zamir Mati with his illustrations for the book "Beni Ecën Vet" opened by the debate with the archaeologist Ilir Mati, entitled "Traveling", exhibition "Precious Past" with works by the Albanian Artists from the Republic of North Macedonia, Burhan Ahmeti and Nevzat Kica. At the end of a successful year, the annual exhibition "White Shadows", also called "Blue", will be presented to the public, which collects the works presented by the various artists who respond to the open call for works containing the color blue, educational animations that will be published as a series, as well as a closing party to thank and meet all the friends of Galeria Qahili" said the creator of the magazine

## Gallery 17

**G**allery 17 comes as a desire and need for inclusiveness and sustainability of a fermenting artistic scene, where the need for new spaces of experimentation is vital. The presented exhibitions produce space by being



ndërkombëtare. Galeria 17, është galeri e pavarur jo-komerciale e cila menaxhohet nga Shtatëmbëdhjetë, duke i kontribuar skenës artistike në vend me një program të pasur prej 4 ekspozitave në vit, performancave dhe programin e edukimit në kuadër të cilit hyjnë biseda me artistë/e, Klasat e Majit, panele diskutimi, prezantime, etj. "Galeria 17, si dhe çdo hapësirë tjetër ekspozuese, qoftë ajo galeri apo tjetër, sigurisht se kontribuojnë në pasurimin dhe ngritjen e vitalitetit kulturor në vend. Krijimi i hapësirave të tilla kontribuon edhe në zhvillimin e skenës artistike por edhe në ofrimin e mundësive për trajtim të temave dhe çështjeve të rëndësishme shoqërore përmes artit. Krijon edhe mundësi për zhvillim dhe rritje të vet personave krijues duke u ofruar mundësi për prezantim para publikut dhe njëkohësisht krijimin e bashkëpunimeve"- theksojnë nga galeria.

2023 ka qenë një vit i suksesshëm për Galerinë 17, duke u bazuar

“**Ishte një vit i pasur për sa i përket programit, audiencës, bashkëpunimeve dhe mundësive të reja për të zhvilluar më tej idetë, që nga janari Galeria Qahili ka filluar me programin edukativ prej katër punëtorive piktore për fëmijë dhe dy për të rritur - aktivitete edukative dhe sociale të mirëseardhura. nga pjesëmarrësit.**

**It was a rich year in terms of the program, audience, collaborations, and new opportunities to further develop ideas, since January, Qahili Gallery has started with the educational program of four painting workshops for children and two for adults - educational and social activities welcomed by the participants.**

te aktivitetet e zhvilluara, numrin e vizitorëve dhe pjesëmarrësve/eve. Ka katër tema që trajton në kuadër të programit të vet vjetor përmes ekspozitave: Skanimi i rajonit, Techne, Arkivimi i Tranzicionit dhe Ekologjia Queer. Këtë vit për herë të parë janë mbajtur edhe Klasat e Majit të udhëhequra nga artistë/e, teoristë/e, kuratorë/e, shkrimtarë/e, aktivistë/e ndërkombëtarë, të cilët/at zhvilluan një kurikulë interdisciplinare, duke iu përgjigjur nevojave të kontekstit lokal, krahas zhvillimeve dhe sfidave bashkëkohore. Gjithashtu për herë të parë po mbahet ajo që e kemi quajtur Pop-up Art Week ndërsa për 10 ditë hap dyert dhe për artistë/e, kolektive dhe formacione të ndryshme kreative të bëhen pjesë e Pop-up Art Week. Në veçanti do t'i shërbejë rrjetëzimit dhe dialogut ndërmjet perspektivave dhe programeve në mes të Galerisë 17 dhe individëve/grupeve të ndryshme e të pavarura të komunitetit kulturor.

revised and transformed. In this sense, the gallery can be perceived as the space of a shell that is born with the mollusk and grows, adapts, and transforms depending on the needs of development, as well as the common public spaces that reflect our social structure inside the labyrinths of urban progress. With a particular focus on social issues, artists and curators are invited to experiment with concepts, ideas, and space. Also, this space aims to bring bold exhibitions that create dialogue and stimulate public debate, continuously contributing to the documentation and creation of missing references along a process that archives and

educates.-was stated by gallery 17, which aims to participate in making ethical and active cultural policies, ensuring representation and inclusion in the international cultural industry.

Galeria 17 is an independent, non-commercial gallery managed by Seventeen, therefore, contributing to the country's art scene with a rich program of four exhibitions a year, performances, and an educational program, which includes conversations with artists, May classes, round

tables, presentations, etc. "Gallery 17, as well as any other exhibition space, be it a gallery or otherwise, certainly contributes to enriching and increasing the cultural vitality of the country. The creation of such spaces contributes not only to the development of the art scene but also to providing opportunities to treat important social themes and issues through art. It also creates opportunities for creative people to develop and grow by offering them opportunities to present themselves to the public and at the same time create collaborations." stresses out those responsible for the gallery.

# Kush e do Prishtinën, e di edhe pse nuk e pëlqen....



NGA RREZEARTA REKA THAQI

Prishtina i bëhet shpi secilit dhe gjithkujt. Është streha që njerëzit e kërkojnë me andje, me gjasë ma shumë për shpirtin se kokën. Njëjtë si unë, në fillim të viteve të '80-ta, që bashkë me familjen nga Shkupi, shtëpinë e kishim gjetur në një lagje të re në Prishtinë, kodrën që e ngrohte dielli, pranë konvikteve të studentëve, e me rënie të lirë, drejt e në korzon ku pulsonte jeta rinore. Atëbotë, Prishtina e viteve të 80-ta, ishte kryeqyteti që shpërthente në revolucion politik e kulturor: e Universitetit që fliste shqip për të gjithë shqiptarët, e "Vivienit" në Akordet e Kosovës, e Tre Sheshirave të poetëve bohemë, dhe e Elidës së ëmbël, vatrës së ideologjive politike të kohës. Shpejtë, natyrshëm dhe pavërejtshëm, sikur dashnitë e mëdha, Prishtina do të shndërrohej në qytetin për të cilin brohoritej "Besa Besë" në stadiumet e futbollit, aty ku sheshet oshëtinin "Kosova Republikë", me shtëpitë shkolla-shtëpinë Kodër të Trimave, në "Kurrizin" e dashuriçkave dhe rezistencës, e nga ku me dhimbje do të largoheshim në marsin e vitit 1999, por që pandalshëm, do të ktheheshim në qershorin e çlirimit: me sytë e njomur deri sa shikonim Prishtinën, teposhtëzës së Veternikut. E dua Prishtinën në çdo stinë: në verë kur të gjitha rrugët të çojnë në Prishtinën që magjishëm shpërthen jetë. S'ka rëndësi çka han e çka pin, po kotësia e ambël e "Ça bone, qe ti ça bone", është përkujtim se ti këtu e ke vendin, pavarësisht dramave urbane të liftit që nuk punon, ujit që ndalet natën dhe mbeturinave që nuk mblidhen me kohë. E dimrit, kur rrugicat qullozen skllotë, trotuaret i ngrin

# Who loves Pristina, knows why he doesn't like it....

Prishtina became a hub for anyone and everyone. It is the refuge that people seek most, probably more for the soul than the mind. The same as me in the early 80s, together with my family from Skopje, located in a new neighborhood of Pristina, on a hill warmed by the sun, near the student dormitories, and with a free fall towards and in the corridors where youthful life pulsed. Then, Prishtina in the 80s, was the capital that exploded in a political and cultural revolution: of the University that spoke Albanian for all Albanians, of "Vivien" in the Chords of Kosovo, of "Three Hats" of bohemian poets, and that of sweet Elida, the hearth of the political ideologies of the time. Quickly, naturally, and imperceptibly, like the great lovers, Prishtina would turn into the city for which "Besa Besa" was chanted in the football stadiums, where the squares were called "Kosova Republic", with the school houses of Kodër-Trimave, the "Kurrizi" of love and resistance, from where we would leave with pain in March of 1999, but we would inevitably return in June of liberation: with teary eyes as we looked at Pristina, at the bottom of Veternik. I love Pristina in every season: In the summer, when all roads lead to Pristina, which magically bursts with life. It doesn't matter what they eat or what they drink, but the sweet futility of "Ça bone, qe ti ça bone", is a reminder that you belong here, despite the urban dramas of the elevator that doesn't work, the water that stops at night, and the garbage that isn't collected in time. In the winter, when the roads are covered with slush, the sidewalks are frozen by snow that always takes us by surprise, your ears burn from the cold, and you barely get on the 4th, but as soon as you get on the bus, you realize that

bora që gjithmonë na zënë befasi, e veshët të djegin nga të ftoftit, ti memzi e zen 4-shin, por që me tu ngjitur në autobus, e kupton që s'ki pare për biletë. "Zotni, më fal po s'pasna pare për biletë", i thua konduktorit në faj. "Kofsh shnosh e udha e mbarë", ta kthen, sinqerisht. Dhe ti mbërrin në kodër, aty ku e ke shtëpinë, në Prishtinë. Aty ku te shitorja e lagjes i ke lënë çelësat e shpisë, ku rrobaqepësja ti ruan pantallonat e shkurtuar derisa të kthehesh prej punës, ku në kafenenë poshtë banesës, kamerierët ta sjellin pijen e preferuar pa të pyetur, dhe ku për secilin emërtim zyrtar të rrugëve ti di edhe emrin "e rrugës". Prishtina është shtëpia që mban dyer të e hapura për të gjithë: pa gjykuar, plot liri, ku asnjëherë nuk je vetëm. Ky qytet është shtrat ëndrrash për ëndërrimtarët, që bashkë me nostalgjinë e vendeve të origjinës, ndërtojnë jetë të reja, për tregime të reja. E për mërgimtarët, që "përkohësisht" shpesh zgjat shumë, Prishtina është shtëpia që sigurtë, kurrë nuk humb. Prishtinën e do ose e urren. Mbase edhe të dyja në të njëjtën kohë. E unë e urrej veç për një arsye: asnjëherë nuk kam gjetur shkas të bollshëm për ta braktisur përgjithmonë. E pas udhëtimeve, pjesa më e bukur në fund është kthimi në shtëpi: në Prishtinë, e dashuruar pak më shumë se herën e kaluar.



NGA VLORA KONUSHEVCU

Një nga synimet kryesore të kësaj ngjarje ishte ofrimi i një platformë për artistët në zhvillim dhe profesionistët e industrisë në Kosovë që të lidhen, të mësojnë dhe të frymëzohen, por gjithashtu përgjegjësia si koncept, çështje. "Aktivitetet dhe panelet janë formuar në atë mënyrë që të reflektojnë rëndësinë e të qenurit përgjegjës, duke filluar prej institucioneve e artistëve, e deri tek qytetari i thjeshtë. Përgjegjësia ka qenë në fokus për shumë arsye, kryesisht sepse është shqetësimi i madh etik dhe social. Në mënyrë që t'i japim formë më të mirë artit muzikor duhet t'i trajtojmë shqetësimet shoqërore që ndikojnë në zhvillimin e kulturës tonë, të influencojmë tolerancën, dhe mirëkuptimin në mënyrë që inspirimi të jetë rrjedhojë. Sipas raporteve dhe evolimit të rezultateve, kemi parë që audiencia e ka kapur thelbin e aktivitetit të cilin e kanë përcjellë, e që të gjitha kanë qenë të rrënjëzuara në përgjegjësi"- tregon Kushtrimi.

Ndërsa edicioni i radhës, i cili që tani është në përgatitje e sipër, do të ketë mysafirë të rinj, artistë të rinj e shumë performanca, të cilat do të shtrihen në periudhën e një jave të tërë PRISHTINA MUSIC WEEK ku synim i Prishtinës dhe komunitetit do të jetë përkrahja e muzikës dhe arteve ndërlidhëse si dhe mundësi të shumta për zhvillimin biznesor të kësaj industrie.



of being responsible, starting from institutions and artists, up to the common citizen. This kind of responsibility has been in focus for many reasons, mainly because it is one of the major ethical and social concerns. To better shape the art of music, we must address the social concerns that influence the development of our culture, and influence tolerance and understanding so that inspiration can flow. According to reports and evolution of the results, we saw that the public grasped the essence

of the activity they followed and that everyone is rooted in responsibility" - says Kushtrimi.

While the next edition, which is now in preparation, will have new guests, new artists, and many shows, which will extend during an entire week PRISTINA MUSIC WEEK where the focus of Pristina and the community will be the support of music and related arts and numerous opportunities for business development in this sector.

“

According to reports and evolution of the results, we saw that the public grasped the essence of the activity they followed and that everyone is rooted in responsibility" - says Kushtrimi.



# Robert Elsie, kështjellë e kulturës shqiptare!

Disa vargje dedikuar albanologut, studiuesit, përkthyesit, hulumtuesit, njeriut të të gjitha përmasave të letrave, njeriut që e dashuroi shqiptarët si asnjë i huaj tjetër, Robert Elsie, një nga personalitetet më të mëdha të kulturës shqiptare.



“Unë erdha në Shqipëri para shumë viteve. Më dukej shumë vend interesante, vendi i çudirave i them unë, sepse ka shumë çudira që nuk kuptohen në botë. Dhe unë desha ta bëjë këtë vend të njohur, ky është qëllimi i punës time, që Shqipëria të kuptohet dhe shqiptarët të mirëkuptohen në botë”. Njeriu që vite të jetës së tij, si albanolog, shkrimtar, përkthyes e studiues ia dedikoi shqiptarëve. Robert Elsie lindi në Vankuvër, studioi në Universitetin “British Columbia” për filologjinë klasike dhe gjuhësi dhe u diplomua në vitin 1972. Vazhdoi studimet e larta në Universitetin e Lirë të Berlinit Perëndimor, pastaj në “Ecole Pratique des Hautes Etudes” në Paris, në Institutin e Dublinit për Studime të Larta në Irlandë, dhe në Universitetin e Bonit, ku mbrojti doktoraturën për gjuhësi të krahasuar dhe keltologji më 1978. Robert Elsie ishte anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. “Një akademi që ecte, një nga njerëzit që punoi i vetëm aq sa institute nuk

## Robert Elsie, the fortress of Albanian culture!

A few verses dedicated to the Albanologist, researcher, translator, researcher, man of letters of all dimensions, the man who loved Albanians like no other foreigner, Robert Elsie, one of the greatest personalities of Albanian culture.

“I came to Albania many years ago. It seemed like a very interesting place, I call it the place of wonders because many wonders are not understood in the world. And I wanted to make this country known, this is the objective of my work so that Albania is understood and Albanians are understood in the world”. The man who dedicated years of his life, as an Albanian, writer, translator, and researcher. Robert Elsie was born in Vancouver, and studied classical philology and linguistics at the University of British Columbia, graduating in 1972. He continued his higher studies at the Free University of West Berlin, then at the “Ecole Pratique des Hautes Etudes” in Paris, at the Dublin Institute for Advanced Studies in Ireland, and at the University of Bonn, where he defended his doctorate in comparative linguistics and Celtology in 1978. Robert Elsie was an external member of the Kosovo Academy of Sciences and Arts, as well as an honorary member of the Association of Writers from Kosovo. “A moving academy, one of



A few verses dedicated to the Albanologist, researcher, translator, researcher, man of letters of all dimensions, the man who loved Albanians like no other foreigner, Robert Elsie, one of the greatest personalities of Albanian culture.

mundën dot, e la në mes e të pakryer kështjellën letrare të tij ku strehonte kulturën shqiptare. Ai la pas një vepër të jashtëzakonshme dhe të pazëvendësueshme” ka thënë shkrimtarja e mirënjohur Flutura Aça për Robert Elsie. Sa i përket kontributit që Robert Elsie ka dhënë në Kosovë, duke marrë parasysh gjendjen jashtëzakonisht të rëndë në Kosovë, gjendje kryesisht të panjohur në botën e jashtme, ai përpiloi antologjinë e parë të madhe me shkrime për temën e Kosovës në vëllimin 600-faqesh Kosovo: In the Heart of the Poëder Keg, 1997. Elsie zbuloi dhe botoi gjithashtu dorëshkrimin në gjermanisht të albanologut hungarez, baronit Franc Nopça (1877-1933) që doli shqip në vëllimin Udhëtime nëpër Ballkan. Në bashkëpunim me Bejtullah Destanin, ai botoi ditarin e poetit dhe piktorit të njohur anglez, Edëard Lear .

the people who worked alone when the institutes could not, left his literary castle where he housed Albanian culture. He left an extraordinary and irreplaceable work,” the well-known writer Flutura Aça told Robert Elsie. Regarding Robert Elsie’s contribution to Kosovo, considering the extremely dire situation in Kosovo, largely unknown to the outside world, he compiled the first major anthology of writings on the topic of Kosovo in the 600-page volume Kosovo: In the Heart of the Poëder Keg, 1997. Elsie also discovered and published the German manuscript of the Hungarian Albanologist, Baron Franc Nopça (1877-1933), which appeared in Albanian in the volume “Travels through the Balkans”.

# Kosova, një adresë turistike

Në Unionin e Turizmit, na pëlqen të mësojmë dhe të përshtatemi, po ashtu, jemi të interesuar për gjithçka që kjo epokë moderne ofron. Falë rrjetit tonë të gjerë, njohurive dhe përvojës së stafit profesional, Unioni i Turizmit përfshihet në aktivitete dhe krijimin e trendeve të fundit të turizmit.



NGA BAKI **HOTI**

DREJTOR I UNIONIT TË  
TURIZMIT  
TË KOSOVËS

**R**ealiteti ekonomik ka pësuar ndryshime të mëdha viteve të fundit, të gjithë po përballen me sfida të reja, e sidomos industria e turizmit. Por ne mbesim optimistë, pasi që udhëtimet, turizmi dhe ndërveprimet njerëzore në mjedise të ndryshme do të ekzistojnë përgjithmonë. Në Unionin e Turizmit, na pëlqen të mësojmë dhe të përshtatemi, po ashtu, jemi të interesuar për gjithçka që kjo epokë moderne ofron. Falë rrjetit tonë të gjerë, njohurive dhe përvojës së stafit profesional, Unioni i Turizmit përfshihet në aktivitete dhe krijimin e trendeve të fundit të turizmit. Jemi të vetëdijshëm se praktikrat më të mira të biznesit bazohen në besueshmërinë dhe krijimin e marrëdhënieve afatgjate, ndaj synojmë që të rritemi së bashku me partnerët tanë duke

# Kosova, a touristic address

At the Tourism Union, we love to learn and adapt but we are also interested in everything this modern age has to offer. Thanks to our wide network, the knowledge and experience of the professional staff, the Tourism Union is involved in the activities and creation of the latest tourism trends.

**T**he economic reality has undergone major changes in recent years; everyone is facing new challenges, especially the tourism industry. But we remain optimistic, as travel, tourism and human interactions in different environments will be around forever. At the Tourism Union, we love to learn and adapt but we are also interested in everything this modern age has to offer. Thanks to our wide network, the knowledge and experience of the professional staff, the Tourism Union is involved in the activities and creation of the latest tourism trends. We are aware that the best business practices are based on trust and creating long-term relationships, so we aim to grow together with our partners creating benefits and advantages for your businesses. TUK, as an organization, was created with the aim

krijuar përfitime dhe avantazhet për bizneset tuaja. UTK-ës, si organizatë, është krijuar me qëllim të mbështetjes së bizneseve dhe profesionistëve që merren me industrinë e Turizmit në Kosovë. Përmes qasjes inovative, Unioni vazhdimisht avokon në përmirësimin e politikave dhe strategjive zhvillimore; në anën tjetër forcon bashkëpunimin e anëtarëve përmes rrjetizimit dhe koordinimit me partnerët e tyre. Aktivitetet tona, ndërliiden me zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Kosovë dhe kanë për qëllim lehtësimin e të bërit biznes në industrinë e turizmit, qasjen më të lehtë në financa, rritjen e konkurrencës përmes ngritjes së kapaciteteve njerëzore, përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve turistike si dhe promovimin e tyre. UTK ka gjithsej 230 anëtarë, në mesin e tyre kemi agjensione turistike, hotele, ciceron, biznese të agroturizmit dhe restaurante.

Kosova ka një potencial të jashtëzakonshëm turistik dhe po shënon progres pozitiv. Avancimi i ofertave turistike përfshirja e tyre ne paketat ballkanike dhe rropiane, pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e numrit të turistëve në Kosovë. Ngritja e standardeve qofshin ato në sektorin e akomodimit, mikpritjes, gastronomisë dhe shërbimeve tjera turistike janë poashtu elemente që kanë ndikuar në përmirësimin dhe avancimin e shërbimeve. Mirëpo ende kërkohen investime dhe strategji të qarta zhvillimore dhe lehtësuese për bizneset e sektorit të turizmit në Kosovë. Mikpritja, ushqimet tradicionale, vendet atraktive e sidomos ato malore, trashëgimia kulturore dhe çmimet e favorshme janë disa nga elementet që kanë tërhequr interesimin e shumë grupeve të turistëve ndërkombëtar. Potencialet që ka Kosova në sektorin e turizmit janë: turizmi kulturor, turizmi malor, turizmidimëror, turizmi rural dhe agroturizmi, turizmi sportive dhe turizmi shëndetësor. Për të gjithë ju që dëshironi të dini më shumë rreth turizmit të Kosovës, Unioni i Turizmit të Kosovës ka funksionalizuar aplikacionin e vetëm në Kosovë për t'ua bërë më të lehtë eksplorimin në formë digjitale andaj mund ta shkarkoni aplikacionin pa pagesë.

**Kosova ka një potencial të jashtëzakonshëm turistik dhe po shënon progres pozitiv. Avancimi i ofertave turistike përfshirja e tyre ne paketat ballkanike dhe rropiane, pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e numrit të turistëve në Kosovë.**



**Kosova and are aimed at facilitating doing business in the tourism industry, easier access to finance, increasing competition through the development of human capacities, improving tourism products, services and as well as their promotion.**

of supporting businesses and professionals dealing with the tourism industry in Kosovo. Through the innovative approach, the Union constantly advocates for the improvement of development policies and strategies; but on the other hand, it strengthens the cooperation of members through networking and coordination with their partners. Our activities are related to the development of sustainable tourism in Kosovo and are aimed at facilitating doing business in the tourism industry, easier access to finance, increasing competition through the development of human capacities, improving tourism products, services and as well as their promotion. TUK has a total of 230 members; among them we have tourist agencies, hotels, agro-tourism businesses and restaurants. Kosovo has an extraordinary tourism potential and is marking positive progress. The advancement of tourist offers, their inclusion in Balkan and European packages, and participation in international fairs have had a positive effect on the increase in the number of tourists in Kosovo. The raising of standards, whether in the sector of accommodation, hospitality, gastronomy and other tourist services, are also elements that have influenced the improvement and advancement of services. However, investments, clear development and facilitating strategies are still required for the businesses of the tourism sector in Kosovo. Hospitality, traditional foods, attractive places, cultural heritage and favorable prices are some of the elements that have attracted the interest of many groups of international tourists. The potentials that Kosovo has in the tourism sector are: cultural tourism, mountain tourism, winter tourism, rural tourism, agro-tourism, sports tourism and health tourism. For all of you who want to know more about Kosovo tourism, the Kosovo Tourism Union has operationalised the only application in Kosovo to make it easier for them to explore in digital form, so you can download the application for free.



# Magjia e kapelave

Puna dhe përkushtimi i saj janë një shembull i shkëlqyer për artistët e rinj që dëshirojnë të ushtrojnë të njëjtin profesion, pasioni dhe inspirimi i pashtjerrshëm janë burim i suksesit të vetë artistes Njomëza Luci.

NGA BLEONA HAJDARI  
FOTOGRAFIA: SHENOLL ZEHRI



**N**jë gjë është e sigurt, elegancën që një kapelë i'a dhuron një veshjeje asgjë tjetër nuk mundet, mirëpo duhet një sy i mprehtë për të parë të bukurën dhe elegancën. Në Kosovë kemi Njomza Lucin, dizjneren e kapelave, e cila ndërthur pasionin e talentin për kapelet.

"Superfuqia ime është kreativiteti. As në momentet më të vështira nuk më është ndalë. E kam përshtypjen që kapela më ka zgjedhur mua, kisha fituar një bursë nga British Council, në drejtimin që kisha zgjedhur, kostumografi për teatër, dy ditë para nisjes u anulua dhe më është dukur interesant drejtimi për kapele, pasi thashë me vete askush nuk punon kapele në Kosovë për teatër. Nuk e kisha menduar ta materializoj këtë punë si shumë shkolla të tjera që kam ndjekur, vetëm për të përmbushur kureshtjen dhe pasionin e pashtjerrshëm që më përcjellë ditë e natë" – fillon rrëfimin Njomëza. Përveç profesion, ajo gjen padyshim dhe një kënaqësi të brendshme shpirtërore dhe

# The magic of hats

Her work and dedication are an excellent example for young artists who wish to practice the same profession, passion and inexhaustible inspiration are the source of the artist's success Njomëza Luci.

**O**ne thing is certain, the elegance that a hat gives to an outfit cannot be matched by anything else, but it takes a careful eye to grasp its beauty and elegance. In Kosovo, we have Njomza Lucin, the hat designer, who combines her passion and love for hats to create magic. Njomza's love for costumes, as well as her great work during and after her studies, make her the unique and most special hat designer in Kosovo and beyond, a passion she exercises with great zeal and dedication. "My superpower is creativity. Even in the most difficult moments, I didn't stop. I have the impression that the hat chose me, I had won a scholarship from the British Council, for a summer school, at Central Saint Martins and the direction I had chosen was the design of costumes for the theatre, two days before departure this direction was canceled and I found the direction of the hats interesting, because I told myself that no one in Kosovo produces hats for the theatre. I had never thought to realize this work, as well as many other schools that I have attended, just to satisfy the inexhaustible curiosity and passion that follows me day and night" - begins his confession. In addition to his profession,



kjo gjë vërehet dhe pasqyrohet qartë në punën e saj. "Gjatë procesit të krijimtarisë, e kam kuptuar që po gjej balancë kur po dizajnoj kapele, e i tërë ky proces i përngjanë një vallëzimi të bukur, meditimit.

Gjej shumë harmoni. Unë zhytem në botën time kreative shumë thellë, aty çdo gjë ka zgjidhje. Dhe në fund e shes këtë krijim. Kështu që nuk më bie të shkojë në punë pothuajse kurrë, sepse punën e kam si lojë"- thotë ajo. Çdo kapelë është e dizajnuar me kujdesin më të madh dhe bartë në vete një rrëfim, një pasion.

Puna dhe përkushtimi i saj janë një shembull i shkëlqyer për artistët e rinj që dëshirojnë të ushtrojnë të njëjtin profesion, pasioni dhe inspirimi i pashtjerrshëm janë burim i suksesit të vetë artistes. "Inspirimi vjen nga të gjitha anët, mjafton të jem e hapur ndaj botës dhe magjia fillon. Për të qenë e hapur më ndihmojnë ritualet, të cilat më japin hapësirë dhe komoditet në botën paralele të imagjinatës. Çdo ditë dal në Gërmi, dhe gjatë ecjes në mal, natyra më dhuron aq shumë bukuri, dhe çdo ditë është ndryshe nga tjera. Është aq e bukur, nuk ka kufi"- vazhdon artistja. T'i duash apo jo kapelet është çështje e shijes personale, mund t'i duash, por të kesh frikë se si do duken tek ty, do të

↑ Njomeza finds an inner spiritual satisfaction in designing hats, and this is observed and reflected in her work. "During the creative process, I realized that I am finding a balance when I design hats, and the whole process is like a beautiful dance, a meditation. I find a lot of harmony. I dive very deeply into my creative world, everything there has a solution and in the end, I sell these creations. So I rarely feel like going to work, because I consider work like play," he says. Each hat is designed with the utmost care and carries with it a story, a passion, and certainly Njomeza's unconditional love. Her work and dedication are an excellent example for young artists who wish to practice the same profession, passion and inexhaustible inspiration are the source of the artist's success. "Inspiration comes from all sides, you just need to be open to the world and the magic begins. To be open, rituals are of great help to me, which give me space and comfort in the parallel world of imagination. Every day I go out to Gërmi, and while I walk in the mountains, nature completes me with beauty, and every day is different from the others. It's so beautiful, there is no limit" - the artist continues her story.

Whether you like hats or not is a matter of personal taste, you can love them, but being afraid of how they will look on you, of showing elegance or of looking ridiculous is a dilemma that people always face, but I don't deny that hats are the accessories that complete an outfit and underline its magnificence. "There is something dynamic about the concept of the hat, the hat is made depending on how you look at it. The hat is more of an attitude than a fashion statement. You can wear

të dhurojnë elegancë apo do të dukesh qesharake?! “Ka diçka dinamike brenda konceptit të kapeles, kapela bëhet varësisht se si e shikoni. Kapela është qëndrim më shumë se sa shprehje e modës. Mund ta vendosni një shigjetë të lakuar, dhe te dukeni si Peter Pan, ose një shigjetë të mbështjell me perla, për ceremoninë e dasmës tuaj. Nëse ndjeheni rehat, do të dukeni madhështore, e nëse nuk ndjeheni rehat, do të dukeni qesharake. Më pëlqen t’i potencoj shprehjet e karaktereve të klientëve në kapele. Klientët e mi më frymëzojnë shumë. Sidomos ata që më besojnë punën deri në nënshkrimin tim, i cili rrjedhë shumë spontanisht, në përfundim të punës e që as vetë nuk e di se si do duket” – shprehet artistja. Si një nga dizajneret e vetme shqiptare të kapelave padyshim që ka lënë gjurmë të mëdha në industrinë e modës në Kosovë, Shqipëri e më gjerë, ka diçka të veçantë tek puna dhe sharmi i saj që i bën njerëzit t’i besojnë kaq shumë dhe ta duan artin e saj. “Kam filluar të krijoj që në moshën 5 vjeçare, e kam zhvilluar kreativitetin deri në atë pikë që nuk di të kopjoj, çdo krijim i imi është ndryshe nga tjetri. E kam imagjinatën pa limit dhe gjatë procesit të krijimit meditoj”- thotë ajo. Kapelet duhet të jenë pjesë e gardërobës së një njeriu, është

a curved arrow and look like Peter Pan, or a wrapped arrow in pearls, for your wedding ceremony. If you feel comfortable, you will look great, while if you feel uncomfortable, you will look ridiculous. I like to emphasize the expressions of customers’ characters in the hats. Customers inspire me a lot, especially those who entrust me with the work until my signature, which emerges in a very spontaneous way, at the end of the work and I don’t even know what it will be like” - says the artist. As one of the few Albanian hat designers who has left a big mark in the fashion industry in Kosovo, Albania, and beyond, there is something special about her work and charm that makes people trust her so much and love her art. “I started creating at the age of 5, I developed my creativity to the point that I don’t know how to copy, each of my creations is different from the other. I have a limitless imagination and I meditate during the creation process,” she says.

Hats should be part of a person’s wardrobe, it’s up to us to look beautiful and more sumptuous with a single accessory. “The hats I make are durable accessories, in terms of structure and production method. While concerning the trend they do not go out of fashion, because I am not at all tied to fashion trends, I create according to the character of the customer, the desire he/she has, how he/she will feel” - confesses Njomëza, adding that she is constantly busy as a costume designer for shows in theaters in Kosovo and Tirana, she also works as a trainer. “I have several programs for the

në dorën tonë të dukemi bukur dhe më madhështorë me një aksesor të vetëm. “Kapelet që i punoj unë, janë aksesor të qëndrueshëm, sa i përket strukturës dhe metodës së realizimit. E sa i përket trendit, ato nuk dalin nga moda, sepse unë nuk jam e lidhur aspak me trendet e modës, unë krijoj varësisht prej karakterit të klientit, dëshirës që ka, se si do të ndjehet” – rrëfen Njomëza, duke shtuar se vazhdimisht angazhohet si kostumografe e shfaqjeve në teatro dhe si trajnere. “ I kam disa programe të ndryshme për zhvillim të kreativitetit, terapi përmes artit. Punoj dhe me grupe te marginalizuara të grave, e tash jam duke e përgatitur një program edhe për organizata e biznese të cilët janë të interesuar, ta balancojnë stresin e mbingarkuar të punëtorëve dhe rritjen e produktivitetit në punë” –thotë ajo. E bukura është përherë në trend, po ashtu edhe eleganca, kur këto bashkohen krijohet magji. Këtë gjë në mënyrë perfekte vazhdon ta sjellë artistja jonë Njomëza Luci.

development of creativity, and therapy through art. I also work with marginalized women’s groups and now I am preparing a program for organizations and companies interested in balancing the excessive stress of workers and increasing productivity at work” - Njomze tells us.

Beauty is always in trend, elegance is always beautiful, when beauty and elegance come together, magic and greatness are born together. Our artist Njomëza Luci brought all this perfectly and continues to bring her love, passion, and dedication linked within the artist bringing thus the true and beautiful art of designing hats.



# Prishtina qytet evropian i sportit

## Prishtina, European city of sports



**N**jë lajm i bukur përmbylli vitin 2023 për kryeqytetin tonë, u shpall nga ACES Europe, "Prishtina, qytet evropian i sportit 2024". Sipas të parit të Komunës, z.Përparim Rama, ky titull është dëshmi e angazhimit tonë të palëkundur për të krijuar një qytet që përfaqon jetën e shëndetshme, gjithëpërfshirjen dhe mikpritjen. Na pret një vit i mbushur me ngjarje sportive, angazhim të komunitetit dhe investime në infrastrukturën sportiv. "Unë besoj fuqimisht se ky titull është katalizator që na nevojitet për ta kthyer fokusin tek rëndësia e sportit në shoqëri për një të ardhme të ndritshme dhe të shëndetshme dhe më gjithëpërfshirëse për qytetin tonë si dhe përshpejtim i përgatitjeve për Olimpiadën Mediterane me Prishtinën nikoqire në vitin 2030, andaj këtë titull t'a gëzojmë të gjithë së bashku"- theksoi z.Rama. Ndërsa, drejtori i Drejtorisë për Sport në Komunën e Prishtinës, Granit Rugova, është shprehur se kjo njohje është dëshmi e punës së palodhshme, misionit dhe aktiviteteve të shumta sportive që na kanë pozicionuar krahas qyteteve të zhvilluara evropiane. Prishtina vazhdon të shkëlqejë dhe të vendosë standarde të larta në botën e sportit.

**A**wonderful news concluded the year 2023 for our capital city, and it was announced by ACES Europe, "Prishtina, European city of sport 2024". According to the Mayor of the Municipality, Mr. Përparim Rama, this title is proof of our unwavering commitment to create a city that embraces healthy living, inclusiveness and hospitality. A year full of sporting events, community engagement and investments in sports infrastructure awaits us. "I strongly believe that this title is the catalyst we need to turn the focus to the importance of sport in society for a bright, healthy and more inclusive future for our city as well as speeding up the preparations for the Mediterranean Olympics with Prishtina as the host in the next games at 2030, so let us all enjoy this title together" - emphasized Mr. Rama. Meanwhile, the director of the Directorate for Sports in the Municipality of Prishtina, Granit Rugova, said that this recognition is a strong proof of the tireless work, mission and numerous sports activities that have positioned us alongside developed European cities. Prishtina continues to shine and set high standards in the world of sports.



# Rrugëtimi profesional drejt së bukurës

**V**jollca Gashi Gajtani ka ndërthurur në vete botën e estetikës me mjekësinë, të dyja pasione të hershme, që me përkushtim e vullnet ka krijuar sot një përvojë të jashtëzakonshme mes Suedisë dhe Kosovës, pa i ndaluar asnjëherë trajnimet dhe specializimet e mëtejshme për të qenë sa më profesioniste dhe me standarde evropiane. “Para 10 vitesh kam punuar në emergjencë në një nga spitalet në Suedi, por edhe në Oslo. Aty pranonim pacientë, që kishin pësuar efekte anësore të shkaktuara nga fillers ose që kanë pësuar shok Anaphylactic, ku edhe sot fatkeqësisht shumë injektor nuk dinë të merren si duhet me injektim. Një moskujdesje e vogël që mund të sjellë deri te verbimi i pacientit. Për habi disa pacientë dukeshin edhe bukur dhe nuk e di se çka nuk pëlqenin tek vetja. Pasi psikologjikisht për të bërë një ndërhyrje tek vetja zakonisht bëhet për tu dukur më bukur edhe pse limitet janë jo të karta ndaj definimit të një bukurie natyrale. Kjo ishte shtysa e parë për fillers, së bashku me ndikimin e motrës time të madhe, që më inkurajoi t’i dedikohesh kësaj pune. Atë kohë isha kundër fillers dhe botoksit, çka ende befasohe”- nisë rrëfimin Vjollca. Sot një emër shumë i njohur dhe profesional në botën e estetikës në Suedi, por edhe në Kosovë, ka diçka që e veçon punën e saj nga tjerët, është etika profesionale për të ruajtur bukurinë natyrale, të cilën e zbaton në klinikën ku punon, “Citadelkiniken” në Malmo.

“Të mirëmbajmë një freski, që rrezaton bukuri të shëndetshme dhe relaksuese. Ndaj na duhet një edukim rreth procesit të trajtimit, informacione çka “What to expect ageing through the decade”. Mënyra e jetesës luan shumë rol se si reflekton lëkura gjatë jetës, sa i përkushtohemi mirëmbajtjes së lëkurës. Nga ushqimi deri te rutina e përditshme e sidomos te pastrimi i lëkurës nga moshën e fillimit të pubertetit, konsumimi i duhanit dhe alkolit, fast food e faktorë tjerë që ndikojnë në lëkurën tonë. Por është me rëndësi që ne si injektor, të informojmë mirë sidomos vajzat e reja, të cilat kanë krijuar një ide të gabuar dhe se “të dukesh seksi” është mbi të gjitha. Në realitet një lëkurë e shëndetshme do të duhej të ishte më e rëndësishme edhe se fillers. Pra, t’i edukojmë moshat e reja në këtë aspekt, sidomos kur insistojnë për fillers, siç bëjnë vajzat 17 vjeçare, t’u ofrojmë shërbim

## The professional journey towards beauty

**V**jollca Gashi-Gajtanihas combined in herself the world of aesthetics with medicine, both very early passions and with great dedication and will to work, has today created an extraordinary experience between Sweden and Kosovo, without ever stopping further training and specializations to be as professional as possible with European standards.”10 years ago, I worked in an emergency in one of the hospitals in Sweden, but also in Oslo, once a month, in A-hus. There we accepted patients who had suffered side effects caused by fillers or who had anaphylactic shock, where even today, unfortunately, many injectors do not know how to deal with injections properly. A little carelessness can lead to the blinding of the patient. Surprisingly, some patients even looked beautiful and I don’t know what they didn’t like about themselves. Psychologically, to intervene in yourself is usually done to look more beautiful, even though the boundaries are not clear to the definition of natural beauty. This fact made me consider the idea of fillers along with the influence of my older sister encouraging me to take this job seriously while at that time I was very against fillers and Botox, which today still surprises me”- Vjollca begins the story. Today, she is a very well-known name in the world of aesthetics in Sweden, also in Kosovo, there is something that sets her work apart from others, it is her professional ethics to preserve natural beauty, which she implements in the clinic where she works today at the Citadelkiniken in Malmo. “To maintain a freshness that radiates healthy and relaxing beauty. Therefore, we need education about the treatment process, and informative education about “What to expect from aging over the decade”. Lifestyle plays an important role in how the skin is reflected throughout life and how much we dedicate ourselves to the maintenance of the skin. From nutrition to daily rou-



Të mirëmbajmë një freski, që rrezaton bukuri të shëndetshme dhe relaksuese. Ndaj na duhet një edukim rreth procesit të trajtimeve, informacione çka “What to expect ageing through the decade”. Mënyra e jetesës luan shumë rol se si reflekton lëkura gjatë jetës, sa i përkushtohemi mirëmbajtjes së lëkurës.

minimal. T'ui ofrojmë një plan rreth trajtimit pas moshës 18 vjeçare, kur ato vendosin vetë, e gjithë kjo në aspektin e edukimit të saktë. Në këtë moshë unë sugjeroj vetëm bërjen e buzëve, atë minimalisht vetëm 0,3-0,5 ml. Pra, ta ruajmë etikën në punë dhe si prezantohemi është shumë e rëndësishme sot”- tregon Vjollca.

### **Mbi të gjitha kujdesi dhe informimi edukimi i klientit**

Vjollca është nga ato estetiste që nuk bën kompromise me shëndetin dhe kujdesin ndaj klientit, sepse për të bukuria natyrale ende mbetet një nga vlerat kryesore, që ajo çmon. “Bukuria natyrale i jep vetëbesim njerëzve si në aspektin e vetëbesimit dhe shëndetit

tine and above all to cleansing the skin from the beginning of puberty, to smoking, fast food, and many factors that influence the increase in stress on our skin. It is important that we injectors, in addition to work, take care to inform well, especially young girls, who have created a wrong idea of what is considered “looking sexy” In reality, skin health should be more important than fillers. So, let’s educate young people on this aspect, especially when they insist on fillers, as 17-year-old girls do, to offer them a minimum service, where the presence of parents is necessary. We offer a treatment plan even after the age of 18 when they decide on their own, all this in terms of education and accurate information. At this age, I suggest applying only on the lips and even minimally only 0.3-0.5 ml and no

more. So, maintaining ethics at work and in the way we present ourselves is very important today” - says Vjollca, adding that they have the utmost responsibility towards the services they offer.

### **Above all care and information, customer education**

Vjollca Gashi Gajtani is one of those beauticians who does not compromise with health and customer care, because for Vjollca natural beauty remains one of the main values that must be exalted. “Natural beauty gives people confidence both in terms of self-confidence and mental health. Of course, we as estheticians help this beauty of joy by increasing people’s self-confidence” - says Vjollca. For this reason, she never stops participat-

mental. Natyrisht ne si estetist i ndihmojmë kësaj bukurie të ngazëllej duke ia rritur vetëbesimin njerëzve"- thotë ajo. Për këtë arsye ajo asnjëherë nuk i ndal seminarët dhe konferencat në Europë, për të freskuar njohuritë dhe krijuar kontakte të reja në fushën e estetikës. "Do veçoja takimin e fundit në Paris e ftuar nga IBSA Company, ku ligjëroj një profesor i njohur tani në fushën e operacioneve plastike, fillers dhe botox, Mauricio de Maio nga Brazili. Ai është edhe bashkautor i tre librave mbi operacionet plastike dhe unë e përcjellë me vite, më ka frazuar dhe mësuar shumë. Ende sot praktikën e punës e zhvilloj në bazë të sugjerimeve të tij hap pas hapi, si paraqitem ndaj klientëve, konsultimeve paraprake, nevojat e klientëve, pjesën emocionale të klientëve, pra çka ndiejnë rreth trajtimit. Për të krijuar një plan sa më optimal të trajtimit, duke u bazuar në MD Codes nga Dr Mauricio de Maio" – shprehet ajo. Tashmë prej kohësh e ndan përvojën e vet profesionale mes Malmos dhe Prishtinës, duke sjellë një frymë komplet ndryshe, por edhe të guximshme, e para që ofroi Profhilo e certifikuar nga IBSA, e cila e ftoi edhe në kongresin me të madh në botë të estetikës IMCAS World Congress.. "Në Kosovë, fatkeqësisht ka shumë parregullsi në këtë aspekt. Së pari mungesa e ligjit se kush ka të drejtë për injektim. Në Suedi tash minimumi duhesh me qenë infermiere për të ushtruar tretmanin për Fillers dhe Botox. Në anën tjetër mungon edukimi tek pacientët rreth definimit të bukurisë dhe ku janë limitet. Nga ajo që kam pa nuk ka shumë informacione për benefitet dhe të mirat e trajtimit, pasojat anësore dhe disavantazhet e tij. Si dhe kontradiktat që janë krijuar rreth trajtimit Është shndërruar në biznes. Ka mungesë të artikujve të avancuar dhe nuk merren fare me statistikat rreth trajtimeve "- thekson Vjollca. Sipas saj, ndërhyrjet estetike janë të ngjashme, po ka shumë mungesa rreth konsultimeve paraprake dhe planifikimit të trajtimit, ndërsa dija ndaj anatomisë dhe përjashtimeve të mundshme gjatë dhe pas trajtimit as që diskutohen. Në fund Vjollca jep këto këshilla për femrat që bëjnë ndërhyrje estetike. "Ti je e vlefshme ashtu si je. Por, nëse një ndërhyrje të bënë të ndihesh mirë, bëje. Ndërhyrjet e vogla nga përvoja kam parë se i kanë ndryshuar grave edhe mënyrën e jetesës, e cila mund të bëhet edhe me një volum, pasi ka munguar edhe një rutinë e mirëmbajtjes së lëkurës. Një këshillë shkon për nënat e reja dhe me fëmijë, ju jeni shembull i bukurisë klasike, nuk keni nevojë për bukuri të ekzagjeruar. Para trajtimit interesohuni dhe merrni informata rreth tretmanit dhe pasojave anësore, produkteve dhe gjeni një injektor me përvojë dhe profesionist. Gjeneri klinika profesioniste që kanë primare sigurinë dhe efikasitetin në punë. E fundit, të mos ndikohen nga çmimet e lira. Jeta e juaj vlen më shumë."- përfundon ajo.

ing in seminars and conferences around Europe, to refresh her knowledge and create new contacts in the field of Aesthetics. "I would highlight the last meeting in Paris invited by IBSA Company, where a well-known professor in the field of plastic surgery, fillers, and Botox, Mauricio de Maio from Brazil, gave a lecture. He is also the co-author of three books on plastic surgery and I have followed him for years, from whom I have been educated a lot in the field of Aesthetics, where I also develop my work practice based on his step-by-step suggestions, how I present myself to clients, preliminary consultations, the needs of the clients, the emotional part of the clients, i.e. what they feel about the treatment. To create the most optimal treatment plan, based on MD Codes by Dr. Mauricio de Maio" - says the beautician. For a long time, she shared her professional experience between Malmö and Pristina, bringing a different but also daring spirit, the first one offered by Profhilo certified by IBSA, which also invited her to the world's largest aesthetics congress IMCAS World Congress. "In Kosovo, unfortunately, there are many irregularities in this aspect. First, lack of law on who has the right to inject. In Sweden, at least you have to be a nurse to practice the treatment for fillers and Botox. On the other hand, there is a lack of education among patients about the definition of beauty and where the limits are. From what I have seen, there is not much information about the benefits and advantages of the treatment as well as the side effects and disadvantages of the treatment. Also, the contradictions that have been created around the treatment. The idea is that everything has turned into a business. There is a lack of advanced articles and they do not deal at all with the statistics about the treatments" - confesses Vjollca. According to her, aesthetic interventions are similar, but there are many deficiencies regarding preliminary consultations and treatment planning, while knowledge of anatomy and possible exceptions during and after treatment is not even discussed.

In the end, Vjollca Gashi Gajtani gives this advice to all girls and women who undergo cosmetic surgery. "You are precious just the way you are. But if an operation makes you feel good, do it. From experience, I have seen how small operations have changed women's lifestyles, which can be done with a volume since a maintenance routine was also missing from the skin. As advice goes to new mothers and those with children, you are the emblem of classic beauty, you do not need exaggerated beauty. Before the treatment, always inform yourself and obtain information on the process, side effects, and products and find an injector experienced and professional. Find professional clinics that prioritize safety and efficiency. Finally, don't be influenced by cheap prices. Your life is worth more," she concludes.

# Kaonë... arti i modës

Fokusi kryesor është të krijojë veshje të veçanta për individë të veçantë. Ajo ka arritur të ndikojnë në modën urbane në Kosovë duke shpërthyer stereotipet gjinore dhe duke inkurajuar një shpirt krijues dhe lirinë e shprehjes nëpërmjet veshjeve.



**J**u sjellim një nga dizjeneret më të njohura dhe unike të Kosovës, Kaonë Duriqi, një histori e suksesit, me një frymë të re në botën e modës. E nisi rrugëtimin e saj në Prishtinë, me krijimet e saj në skenën lokale, një markë e veçantë që zgjidhte sfidën e “nuk kam çfarë të vesh” për të rinjtë. Ajo inkurajon një stil jetese të ndërgjegjshme dhe përkrah krijuesit lokal me një vullnet të vazhdueshëm për inovacion dhe shprehje artistike nëpërmjet veshjeve. Nga atëherë, Kaonë ka shpërthyer në skenën e modës në Kosovë me një qasje unike ndaj krijimtarisë dhe bukurisë. Çdo veshje e prodhuar nga Kaonë është një art i punuar me kujdes dhe një shprehje e vërtetë e individualitetit.

Fokusi kryesor është të krijojë veshje të veçanta për individë të veçantë. Ajo ka arritur të ndikojnë në modën urbane në Kosovë duke shpërthyer stereotipet gjinore dhe duke inkurajuar një shpirt krijues dhe lirinë e shprehjes nëpërmjet veshjeve. Historia e suksesit të saj filloi me bashkëpunime me artistë të ndryshëm lokal dhe shumë intervista. Një nga fustanet e saj u vesh në tepihin e kuq të “Oscars” nga aktorja, Nikki Novak, duke qenë kështu dizajnerja e pare në Kosovë që arriti të dërgojë veshje në këtë event gjigant. Por edhe çmimin në konferencën e “Wom-

# Kaonë... The Art of Fashion

She has managed to influence urban fashion in Kosovo by exploding gender stereotypes and encouraging a creative spirit and freedom of expression through clothing.

**W**e introduce you to one of the most famous and unique designers in Kosovo, Kaonë Duriqi, a success story that brings a new spirit to the world of fashion. She started her journey in Pristina bringing her creativity to the local scene, a special brand that solved the “I have nothing to wear” challenge for young people. She encourages a conscious lifestyle and supports local creatives with a constant push for innovation and artistic expression through clothing. Since then, Kaonë has burst onto the fashion scene in Kosovo with a unique approach to creativity and beauty. Each piece produced by Kaonë is carefully crafted art and a true expression of individuality. The main goal is to create special clothes for special people.

She has managed to influence urban fashion in Kosovo by exploding gender stereotypes and encouraging a creative spirit and freedom of expression through clothing. Her success story began with collaborations with various local artists and many interviews. One of her dresses was worn on the Oscars red carpet by the well-known actress and correspondent, Nikki Novak, in 2017, thus being the first designer in Kosovo who managed to send clothes to this giant event. But also the award at the





en Excellence Conference" në Des Moines, Iowa, USA, një njohje të merituar për kontributin e jashtëzakonshëm në modë, duke vënë në dukje angazhimin e saj në përkrahje e suksesit të grave. Kaonë mori pjesë me sukses edhe në konkursin "Muza" në Tiranë, projekt i cili përfshin aktivizimin e të rinjve pasionant e profesionistë në rijetëzimin e elementeve etnografikë në fushën e fashion-dizajnit.

Kaonë Duriqi vazhdon të jetë një dizajnere mode që ka një vizion të qëndrueshëm dhe kreativ për tu ndërtuar në bazë të vlerave të shëndetshme për planetin tonë. Ajo dëshiron të krijojë veshje të veçanta duke përdorur materiale të reja, duke mbledhur dantella dhe ndërthurje të ndryshme, dhe duke shmangur hedhjen e tyre.

Fokusi i saj është të jetë një markë e qëndrueshme, duke përballuar sfidat e industrisë së modës së shpejtë, e cila ka pasoja të dëmshme për tokën tonë. Përmes përpjekjeve të Kaonës, ajo synon të krijojë një alternative më të qëndrueshme, duke shpërthyer në skenën e modës me një vizion të re për të përmirësuar industrinë dhe të ndërtuar një rrugë tjetër drejt një bote mode më të ndërgjegjshme dhe miqësore ndaj mjedisit. Kështu, me një përkushtim të vazhdueshëm ndaj qëndrueshmërisë në modë, ka certifikuar koleksionin e saj si "sustainable", i cili u shfaq në një dyqan ekskluziv në "The Friend of the Earth" i vendosur në zemër të Milanos, në "Galleria Passarella". Kjo certifikatë dëshmon hapat e mëtejshëm të Kaonës drejt një mode të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisit.

Kaonë vazhdon të jetë një dizajnere mode që ka një vizion të qëndrueshëm dhe kreativ për tu ndërtuar në bazë të vlerave të shëndetshme për planetin tonë. Ajo dëshiron të krijojë veshje të veçanta duke përdorur materiale të reja, duke mbledhur dantella dhe ndërthurje të ndryshme, dhe duke shmangur hedhjen e tyre. Fokusi i saj është të jetë një markë e qëndrueshme, duke përballuar sfidat e industrisë së modës së shpejtë, e cila ka pasoja të dëmshme për tokën tonë. Përmes përpjekjeve të Kaonës, ajo synon të krijojë një alternative më të qëndrueshme, duke shpërthyer në skenën e modës me një vizion të re për të përmirësuar industrinë dhe të ndërtuar një rrugë tjetër drejt një bote mode më të ndërgjegjshme dhe miqësore ndaj mjedisit.

Kaonë ka arritur të kapërcejë kufijtë dhe të vendosë një pranverë të re në botën e modës ndërkombëtare, ku së fundmi shkëlqeu në "Milan Fashion Week", duke prezantuar koleksionin e saj në pasarelë. Sukseset e saj në "Milan Fashion Week" shënon një moment vendimtar në karrierën e saj dhe vë në dukje se ajo po bën një ndikim të thellë në të ardhmen e modës, duke promovuar një qasje të re ndaj dizajnit dhe shfrytëzimit të burimeve të riciklueshme.

"Women Excellence Conference" in Des Moines, Iowa, USA, which is a well-deserved recognition for her extraordinary contribution to the field of fashion and also points out her commitment to supporting and promoting the success of women. Kaonë also successfully participated in the "Muza" Competition in Tirana, a project that includes the activation of passionate young people and professionals in the revival of ethnographic elements in the field of fashion design. Kaone's participation and success in this event highlight not only her professionalism and creativity but also her value and impact on the fashion scene at the country level.

Kaonë Duriqi continues to be a fashion designer who has a sustainable and creative vision to build based on healthy values for our planet. She wants to create unique garments using new materials, collecting different laces and interweaves, and avoiding throwing them away. Its focus is to be a sustainable brand, facing the challenges of the fast fashion industry, which has harmful consequences for our earth. Through Kaona's efforts, she aims to create a more sustainable alternative, bursting onto the fashion scene with a new vision to improve the industry and build another path towards a more conscious and eco-friendly fashion world. Thus, with a continuous commitment to sustainability in fashion, it has certified its collection as "sustainable", which was displayed in an exclusive store in "The Friend of the Earth" located in the heart of Milan, in "Galleria Passarella"... This certificate proves Kaona's further steps towards sustainable and environmentally friendly fashion.

Kaonë has managed to overcome the boundaries and establish a new spring in the world of international fashion, where she recently shone at "Milan Fashion Week", presenting her collection on the catwalk. Her success at Milan Fashion Week marks a turning point in her career and shows that she is making a profound impact on the future of fashion, promoting a new approach to design and the use of recyclable resources.

**Kaonë Duriqi vazhdon të jetë një dizajnere mode që ka një vizion të qëndrueshëm dhe kreativ për tu ndërtuar në bazë të vlerave të shëndetshme për planetin tonë.**



**Kaonë Duriqi continues to be a fashion designer who has a sustainable and creative vision to build based on healthy values for our planet.**

# Me fëmijët artistë!

## With the artist children!



FOTO: ILIRIA NEZIRI



